AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

ANALIZE

E

TREGUT

TE SHERBIMEVE CELULARE

Tregjet me shumice te terminimit te thirrjeve ne rrjete publike telefonike individuale te levizshme

Dokument për Këshillim Publik

Dhjetor, 2016

(MIRATUAR ME VKD NR.2699, DATE 1.12.2016)

INDEKSI I PERMBAJTJES

I. PERMBLEDHJE **4**

II.HYRJE **10**

II.1 KUADRI LIGJOR DHE RREGULLATOR PER PERCAKTIMIN E SIPERMARRESVE ME FNT 10
Objektivat e Ligjit dhe kuadri rregullator *10*
Procesi i Këshillimit Publik *11*
Analiza e tregut nga autoriteti rregullator dhe bashkepunimi me Autoritetin e Konkurences *12*
Perkufizimi i tregut perkates *13*
Fuqia e Ndjeshme ne Treg dhe masat rregulluese *15*
II.2 ANALIZA E TREGUT CELULAR 2014 16

III. TREGU ME PAKICE I SHERBIMEVE CELULARE **21**

III.1. OFRUESIT E RRJETEVE/SHËRBIMEVE CELULARE 21
III.2 PERDORIMI I SHERBIMEVE CELULARE 26
Ecuria e numrit te përdoruesve celularë *26*
Struktura e perdoruesve *29*
Sherbime te reja (3G/4G) *30*
III.3. TRAFIKU TELEFONIK DHE STRUKTURA E THIRRJEVE 32
III.4 PËRDORIMI MESATAR MUJOR I SHËRBIMEVE CELULARE 34
III.5. TARIFAT CELULARE 36
ARPM dhe ARPU *36*
Tarifat e thirrjeve on-net/off-net *38*
Tarifat per sherbimet e aksesit broadband *43*
Tarifat me Parapagim v Kontrate (paspagim) *44*
Tarifat standarde per njesi komunikimi (pay as you go) *45*
Tarifat e sherbimeve roaming nderkombetar *47*
III.6. PERFORMANCA FINANCIARE E KOMPANIVE CELULARE 51
Të ardhurat *51*
Fitimet *53*
Investimet *53*
III.7. PJESET E TREGUT 57
III.8. TENDENCA NDERKOMBETARE TE TREGJEVE CELULARE 60
Propozimi i KE per ndryshimin e kuadrit rregullator *60*
Efekti i OTT dhe sherbimet e integruara ne paketa (bundles) *61*
Struktura e tregut ne vende te BE dhe rajonit SEE *62*
Tendenca e ARPU ne vende te BE dhe Shqiperi *63*
III.9. PERFUNDIM PER TREGUN ME PAKICE TE SHERBIMEVE CELULARE 64

IV. TERMINIMI I THIRRJEVE NË RRJETET CELULARE **67**

IV.1. PERKUFIZIMI I TREGUT TE TERMINIMIT TE THIRRJEVE NE RRJETET CELULARE 67
IV.2. ANALIZA PER FUQI TE NDJESHME NE TREG 69
IV.3. MASAT RREGULLUESE 74

V. PERFUNDIM **77**

ANEKS 1. PYETJET E KESHILLIMIT PUBLIK **81**

INDEKSI I TABELAVE DHE FIGURAVE

TABELA III.1. SPEKTRI I FREKUENCAVE TE ALOKUARA OPERATOREVE CELULARE (NENTOR 2016) .. 23
TABELA III.2: TREGUES KRYESORË TË VOLUMIT TË SHËRBIMEVE CELULARE 2011-2015 24
FIGURA III.1: NUMRI I PËRDORUESVE CELULARË AKTIVË DHE KARTA SIM 2010-2015 26
FIGURA III.2. NUMRI I PËRDORUESVE CELULARË SIPAS KARTAVE SIM 2000-2015 27
FIGURA III.3: NUMRI I PËRDORUESVE CELULARË AKTIVE 2010-2015 27
FIGURA III.4: NUMRI I PËRDORUESVE CELULARË AKTIVE TIV_2014-TIII_2016 28
FIGURA III.5: NORMA E PENETRIMIT TE SHERBIMEVE CELULARE SHQIPERI 2015 V BE 2014 28
TABELA III.3: STRUKTURA E PËRDORUESVE CELULARË KONTRATË/PARAPAGIM (2015) 29
FIGURA III.6: STRUKTURA E PËRDORUESVE AKTIVË 2010-2016_QIII 30
FIGURA III.7 NUMRI I PËRDORUESVE AKTIVE TË AKSESIT BROADBAND NGA RRJETE CELULARE 31
FIGURA III.8: STRUKTURA E THIRRJEVE DALESE CELULARE SIPAS DESTINACIONIT 32
FIGURE III.9 STRUKTURA E THIRRJEVE CELULARE (JANAR 2014-SHTATOR 2016) 33
FIGURA III.10: ECURIA E SASISË SË TRAFIKUT ON-NET DHE OFF-NET JANAR 2014-DHJETOR 2015 34
TABELA III.4: PËRDORIMI MESATAR I SHËRBIMEVE CELULARE 2008-2013 35
TABELA III.5: ECURIA E ARPM DHE ARPU 2010-2015 37
FIGURA III.11. ARPU NË VENDET E BE DHE SHQIPËRI (2014/2015) 37
FIGURE III.12 ECURIA E ARPU DHE THIRRJE PER PERDORUES 38
TABELA III.6. NDRYSHIMET NË TARIFAT E THIRRJEVE ME PARAPAGIM (VODAFONE CLUB) 39
TABELA III.7: SHEMBUJ TE NDRYSHIMEVE TE OFERTAVE MUJORE TE VODAFONE (2014-2016) 39
TABELA III.8. SHEMBUJ TE NDRYSHIMEVE TE OFERTAVE TE VODAFONE (2014-2016) 40
TABELA III.9. NDRYSHIME NË PLANE TARIFORE ME KONTRATË VODAFONE ALBANIA 40
TABELA III.10. PAKETA STANDARTE DITORE 41
TABELA III.11. PAKETA STANDARTE 28/30 DITORE 800 LEKE 41
FIGURA III.13. INSTRUMENT KRAHASIMI ON-LINE I TARIFAVE TE TELEKOM ALBANIA 42
TABELA III.12. TARIFA ME PARAPAGIM V KONTRATE VODAFONE 44
TABELA III.13. TARIFA ME PARAPAGIM V KONTRATE TELEKOM ALBANIA 44
TABELA III.14.TARIFAT PER NJESI TE SHËRBIMEVE PËR PERDORUESIT ME PARAPAGIM 45
TABELA III.15.TARIFAT PER NJESI TE SHËRBIMEVE PËR PERDORUESIT ME KONTRATE 45
TABELA III.16. TARIFA TE ROAMINGUT NDERKOMBETARE 47
TABELA III.18. TARIFA TE ROAMINGUT NDERKOMBETARE JASHTE OFERTAVE/PAKETAVE 49
FIGURA III.14: TE ARDHURAT TOTALE TE OPERATOREVE CELULARE 2004-2015 51
FIGURA III.15: TE ARDHURAT NGA SHERBIMET ME PAKICE 2011-2015 52
FIGURA III.16: TE ARDHURAT NGA SHERBIMET ME SHUMICE 2011-2015 52
FIGURA III.17: ECURIA E FITIMEVE NETO TE SIPERMARRESVE TE RRJETEVE CELULARE (2010-2015) . 53
FIGURA III.18: ECURIA E INVESTIMEVE TE SIPERMARRESVE NE RRJETE CELULARE (2010-2015) 54
FIGURA III.19: ARPU RETAIL SIPAS OPERATOREVE 2011-2015 55
FIGURA III.20: ARPU TOTAL SIPAS OPERATOREVE 2011-2015 55
TABELA III.19. PJESET E TREGUT TE OPERATOREVE CELULARE 2010-QIII_2016 57
TABELA III.16: PJESET E TREGUT NE PAJTIMTARE NE VENDET E BE (2015/2016) 62
FIGURA III.21: TENDENCA E ARPU NE BE DHE SHQIPERI 2010-2015 64
FIGURA IV.1: TARIFAT Ë TERMINIMIT NË VENDET E BE DHE RAJONIT DHE SHQIPËRI (2008-2016) 72

I. PERMBLEDHJE

Ky dokument permban analizen e tregut me shumice te terminimit te thirrjeve ne rrjetet celulare si dhe te tregut me pakice te sherbimeve celulare. Dokumenti permban nje rishikim te perfundimeve te analizes se fundit te tregut celular te kryer ne vitin 2014 dhe masave rregulluese perkatese per FNT. Dokumenti i analizes se tregut trajton zhvillimet historike ne treg dhe pritshmerite e AKEP per te ardhmen e afert dhe te mesme dhe masat rregulluese perkatese per FNT ne tregjet perkates te analizuar.

Ligji nr.9918, date 19.05.2008 ”Per Komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise”, i ndryshuar, ne nenin 1 te tij, percakton se qëllimi i ligjit është që nëpërmjet parimit të asnjanësisë teknologjike të promovojë konkurrencë dhe infrastrukturë efiçente në komunikimet elektronike dhe të garantojë shërbimet e duhura dhe të përshtatshme në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ligji Nr.9918 parashikon ne Nenin 35 te tij detyrimin per zhvillimin e procedures se keshillimit me palet e interesit per analizen e tregut duke percaktuar edhe kohezgjatjen minimale te periudhes se keshillimit publik prej 60 ditesh. Njekohesisht neni 36 percakton se AKEP vendos, ndryshon mban ose heq detyrime per FNT pas keshillimit me palet e interesuara.

Ne baze te percaktimeve te Ligjit 9918, ky dokument nxirret per keshillim publik me palet e interesuara per nje periudhe 2 mujore nga data e publikimit ne faqen web te AKEP. Ky dokument i nxjerre per keshillim publik permban:

- perkufizimin e tregjeve perkatese te analizuar
- analize e konkurrences ne tregjet perkates dhe vleresimin nese ka operatore me fuqi te ndjeshme ne treg (FNT)
- masat rregulluese te propozuara per sipermarresit e vleresuar me FNT

Ne lidhje me masen rregulluese te kontrollit te tarifave te sipermarresve te propozuar per status me FNT, AKEP do te zhvilloje nje proces te vecante keshillimi publik, ne perputhje me percaktimet e nenit 57 e ne vijim te Ligjit 9918, per te percaktuar metoden e kontrollit te tarifave te sipermarresve me FNT ne keto tregje perkates. Ky proces keshillimi publik per rregullimin e tarifave te sipermarrsit/sipermarresve me FNT zakonisht eshte kryer ne te njejten kohe me keshillimin per dokumentin e analizes se tregut dhe masave rregulluese per FNT. Megjithate, AKEP edhe me pare ka kryer procese te vecanta keshillimi publik ne lidhje me specifikime te masave rregullatore si rregullimi i tarifave, orientimi ne kosto etj., te cilat nuk kane prekur perfundimet e analizave te tregut dhe masat rregulluese, por vetem metoda/specifikime te masave rregulluese.

Dokumenti i analizes eshte strukturuar si me poshte:

- Kapitulli I, Permbledhje, permban nje pershkrim dhe permbledhje te gjetjeve kryesore te dokumentit te analizes;
- Kapitulli II, Hyrje, pershkruan bazen ligjore dhe nen-ligjore per analizen e tregut dhe perfundimet e analizes se meparshme te tregut celulare ne vitin 2014;

- Kapitulli III përmban zhvillimet në tregun me pakicë dhe analizë e konkurrencës së këtij tregu;
- Ne Kapitullin IV kryhet Analiza e tregut te terminimit të thirrjeve për përkufizimin e tregjeve përkatëse, FNT dhe masat rregulluese per FNT
- Kapitulli V permban perfundimet kryesore
- Aneks 1 permban pyetjet e keshillimit publik per kete dokument.

Bazuar ne percaktimet e Ligjit 9918 dhe Rregullores se Analizes se Tregut, AKEP ne pergatitjen e dokumentit ka marre ne konsiderate dhe rekomandimet dhe Udhezimet e Komisionit Europian (KE) dhe BEREC (Grupi i Rregullatoreve Europiane), si dhe ka bere krahasime te zhvillimeve te tregut celular ne Shqiperi me zhvillimet dhe tregues te tregut ne vendet e BE.

Analiza e fundit e tregut celular u krye ne vitin 2014, dhe AKEP ne perfundim te procedures me Vendimet nr.2522-2526, miratoi dokumentin final te analizes se tregut dhe percaktoi kater sipermarresit e rrjeteve celulare me FNT (fuqi e Ndjeshme ne Treg) per terminimin e thirrjeve ne rrjetet individuale celulare si dhe masat rregulluese perkatates per statusin e FNT. Bazuar ne rekomandimet e Autoritetit te Konkurrences dhe problematiken e evidentuar te diskriminimit ne tarifat e thirrjeve brenda dhe jashte rrjetit celular (on-net/off-net), AKEP ne masat rregulluese per FNT perfshiu dhe detyrimin per mos-diskriminim ne tarifat e thirrjeve on-net dhe off-net.

Ky dokument analize trajton se pari zhvillimet e ndodhura ne tregun me pakice te sherbimeve celulare ne terma te perdorimit te sherbimeve, ecurise se struktures se thirrjeve celulare, tarifave te sherbimeve celulare per perdoruesit, treguesve kryesore financiare te sipermarresve dhe pjeset e tregut. Ne keto zhvillime AKEP ka perfshire dhe efektin e zbatimit te mases rregulluese te mos-diskriminimit ne strukturen e thirrjeve dhe tarifave celulare. Zhvillimet dhe tendencat e tregut me pakice celular ne Shqiperi krahasohen dhe me zhvillime dhe tendencat e tregut celular ne vendet e BE dhe me gjere.

Zhvillimet dhe tendencat e tregut me pakice te sherbimeve celulare

Numri i përdoruesve celularë aktivë në fund të vitit 2015 arriti në 3.4 milion, krahasuar me 3.36 milionë në fund të vitit 2014, një rritje vjetore kjo e moderuar prej 1.2%. Kjo normë ndryshon sipas operatorëve dhe ka vlera pozitive dhe negative, për Telekom Albania dhe Plus është rënëse me 2.8% dhe 15.8 % dhe për Vodafone dhe Albtelecom është rritëse me 4 % dhe 12.2%.

Struktura e perdoruesve celulare sipas menyres se pagimit per sherbimet, me parapagim dhe me paspagim) eshte e fokusuar ne perdoruesit me parapagim. Pas nje reduktimi te ketij raporti ne vitet 2011-2012, ne dy vitet e fundit ky raport eshte rritur perseri duke arritur ne 93% ne vitin 2015, dhe ne 95% ne T-III 2016. Ndryshimi i strukturës së përdoruesve celularë vlersohet të ketë ardhur nga politikat tarifore të operatorëve celularë. Prezenca e ofertave tarifore shumë atraktive për përdoruesit me parapagim si dhe eliminimi i grupeve të mbyllura për përdoruesit me kontratë kanë ndikuar në reduktimin e peshës së përdoruesve me paspagim.

Nje nder zhvillimet me te rendesishme gjate 2 viteve te fundit ishte fillimi i ofrimit te sherbimeve celulare ne rrjetet e gjenerates se katert (4G) duke perdorur teknologjine LTE (Long Term Evolution) ne vitin 2015 nga Vodafone, Telekom Albania dhe Albtelecom. Kjo u mundesua nga heqja e kufizimeve teknologjike per perdorimin e spektrit ne frekuencate alokuara per te kater operatoret celulare si dhe alokimi i brezave te rinj te frekuencave gjate ketyre viteve.

ARPM dhe ARPU kanë vazhduar tendencë rënëse dhe për vitin 2015 vlerat e tyre janë reduktuar me 10% dhe 6% respektivisht. Në vitin 2015 një përdorues celular ka paguar mesatarisht 2.83 lek/minutë (me TVSH) për thirrjet telefonike dhe ka shpenzuar mesatarisht 513 lek/muaj (me TVSH) për shërbime celulare.

Niveli i këtyre treguesve në Shqipëri është shumë më i ulët se niveli mesatar në vendet e BE dhe ndër më të ulëtit në rajon. ARPM për Shqipërine ishte në nivelin rreth 1.9 eurocent në 2014 dhe rreth 1.7 eurocent në 2015. ARPU në vitin 2015 në Shqiperi ishte 36.7 euro/vit, që është 23% më e ulët se Letonia me nivelin më të ulët në BE me 47 euro. Niveli mesatar i ARPU në BE në 2013 ishte 162.6 euro apo rreth 4.4 herë më e lartë se ARPU e Shqipërisë në 2015.

Zbatimi i detyrimeve te mos-diskriminimit në tarifat e thirrjeve on-net/off-net të përcaktuara me Vendimet e Analizës së tregut 2014 kane sjelle ndryshime të rëndësishme në planet tarifore të operatorëve celularë:

- përfshirjen e sasive të barabarta të minutave brenda rrjetit dhe drejt rrjeteve celulare apo të thirrjeve brenda dhe jashtë rrjetit (pa dallim destinacioni) në pagesat fikse të planeve tarifore me kontratë dhe me parapagim,
- reduktim të ndjeshëm të numrit të ofertave të përkohshme promocionale dhe rritje të numrit të paketave standarde me përfitime më të mëdha për përdoruesit celularë.

Këto ndryshime nga të katër operatorët celularë kanë çuar në rritje të përfitimeve të përdoruesve fundorë, pasi sasia e minutave të përfshira në pagesat fikse është e mjaftueshme dhe duke filluar nga pagesa shumë të ulëta fikse. Ofertat/paketat tarifore mund të mos kenë më thirrje 'pa limit' brenda rrjetit/grupit, por ato kanë sasi të konsiderueshme thirrjesh (qindra deri në mijëra minuta brenda dhe jashtë rrjetit) sa që praktisht në shumë raste mund të konsiderohen pa limit. Pra përdorusit celularë me të njëjtën kosto (pagesë) kanë përfituar sasi të konsiderueshme thirrjesh jashtë rrjetit celular (drejt rrjeteve të tjera celulare). Efektet e këtyre ndryshimeve janë vënë re në sasinë e thirrjeve dhe strukturën e thirrjeve të përdoruesve të katër operatorëve celularë.

Nga te dhenat e ecurisë se strukturës së thirrjeve të përdoruesve celularë sipas destinacionit të thirrjeve në periudhën Janar 2014-Shtator 2016 vihen re ndryshime te mëdha në strukturën e thirrjeve dhe tendencat e rritjes së peshës së thirrjeve off-net (drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare) dhe reduktimin e peshës së thirrjeve brenda rrjetit (on-net). Pesha e thirrjeve off-net është rritur nga 5% në Janar 2014 në 39% në Shtator 2016. Në të njëtën periudhë pesha e thirrjeve on-net është reduktuar nga 90% në Janar 2014 në 58% në Shtator 2016. Ndryshimet më të ndjeshme të strukturës së thirrjeve janë vënë re në Korrik 2015 e në vijim, që përkon me afatin e fillimit të aplikimit të detyrimit të mos-diskriminimit në rrjetet e katër operatorëve celularë.

Të katër operatorët celularë kanë pasur ndryshime të ndjeshme në strukturën e thirrjeve dalëse të përdoruesve të tyre. Raporti i thirrjeve on-net/off-net të operatorit më të madh celular, Vodafone Albania, ka ndryshuar nga 97%v3% në Janar 2014 në 70% v 30% në Shtator 2016. Për Telekom Albania ky raport ka pësuar ndryshime edhe më të mëdha: nga 96% v 4% në Janar 2014 në 59% v 41% në Shtator 2016.

Të ardhurat e operatorëve celularë në 2015 patën një rritje të moderuar prej 1%, nga 32.7 miliard lek në 2014 në 33.1miliard lek në 2015. Rritjen më të madhe e pati Plus me rreth 20%, dhe një rritje të moderuar prej 1% e pati Telekom Albania. Albtelecom ka qëndruar në nivelin e një viti më parë, ndersa Vodafone pati një renie me 1%. Pjesët e tregut në të ardhura kanë pësuar ndryshime të vogla, Vodafone ka pësuar një rënie prej 1 pikë përqindje dhe Plus ka rritje me po 1 pikë përqindje.

Megjithe ndryshimet e ndjeshme ne tarifat dhe trafikun off-net dhe on-net, si dhe reduktimet e ndjeshme te tarifave te terminimit, te imponuara nga masat rregulluese te AKEP, pjeset e tregut te operatoreve nuk kane pesuar ndryshime te ndjeshme ne keto dy vite. Plus vihet re se ka humbur pjese tregu ne disa tregues si numer perdoruesish dhe Vodafone vazhdon te kete pjesen me te madhe te tregut per shumicen e treguesve. Pjeset e tregut te Vodafone jane rreth nivelit 50% per shume tregues, pervec segmentit te perdoruesve me kontrate, qe ka nje perqendrim me te ulet se te gjithe treguesit e tjere.

Axhenda digitale e KE dhe propozimet e fundit per rishkimin e kuadrit rregullator te komunikimeve elektronike vene ne dukje nevojen per investime shtese ne rrjete fikse me fibra optike si dhe ne rrjetet celulare duke alokuar frekuenca ne brezin 700 MHz per keto rrjete, per te mundesuar zhvillimin e rrjeteve celulare 5G, te cilat do te rrisin mbulimin dhe shpejtesine e aksesit ne rrjete broadband.

Rritja e perdorimit dhe cilesise se sherbimit te aksesit broadband ne rrjetet celulare 3G/4G ka cuar ne rritjen e perdorimit te sherbimeve te aplikacioneve OTT (Over The Top). Zhvillimet e aksesit broadband ne rrjete celulare, telefonave smart, OTT kane cuar ne rritje te zevendesueshmerise se sherbimeve zanore dhe SMS nga rrjete celulare me sherbime nga keto aplikacione si dhe kerkese me te larte per kapaciette transmetimi te dhenash ne rrjetet celulare dhe rrjedhimisht ne investime me te medha nga operatoret e rrjeteve celulare ne 4G dhe me vone dhe ne 5G. Efektet zevendesuese kane filluar te ndihen keto vite te fundit edhe ne Shqiperi per shkak te rritjes se ndjeshme te perdorimit dhe cilesise se aksesit broadband te mundesuar nga rrjetet 3G dhe sidomos 4G dhe nga rritja e perdorimit te aparateve celulare smart.

AKEP vlereson se ky faktor con ne rritje te konkurrences potenciale ne tregun celulare me pakice si dhe njekohesisht ne nevoje per investime me te medha ne rrjete broadband celular per te perballuar kerkesen ne rritje per keto sherbime, perfshire mundesimin e aksesit ne brezat 800 MHz per 4G dhe me vone dhe 700 MHz per 5G.

Ecuria e tregut me pakice ne keto dy vite tregon per rritje te konkurrences dhe perfitimeve te perdorusve nga sherbimet celulare. AKEP pret qe keto perfitime te vijojne te rriten edhe ne vitet ne vijim dhe te rritet perdorimi i sherbimeve te reja te aksesit broadband nepe rmjet 4G.

Analiza e tregut te terminimit te thirrjeve ne rrjetet celulare

Ne analizen e faktoreve te marre ne konsiderate per fuqine e ndjeshme ne tregjet perkatese, rezulton se nuk ka ndryshime nga analizat e meparshme te tregut dhe se ne te ardhmen e afert nuk pritet qe te ndodhin ndryshime qe te cojne ne ndryshim te kritereve per FNT:

- Secili prej operatoreve Telekom Albania, Vodafone Albania, Albtelecom (Eagle Mobile) dhe Plus Communication zoteron 100 % te tregut te terminimit te thirrjeve ne rrjetet e tyre;

- Operatoret celulare nuk perballen me kercenimin e hyrjes ne tregjet e tyre te terminimit te operatoreve te tjere, qe do te ishin te afte te kryenin edhe terminimin e thirrjeve ne keto rrjete;
- Operatoret celulare ndeshen me fuqi te ulet kundervepruese nga operatoret e tjere te telefonise se levizshme dhe te telefonise fikse;
- Ne mungese te nderhyrjes rregullatore, cdo operator celular do te jete ne gjendje t'ju impononte operatoreve vendas tarifa te larta per terminimin e thirrjeve ne rrjetin celular qe zoteron.
- Kriteret e marra ne shqyrtim nuk kane ndryshuar dhe nuk pritet te ndryshojne te pakten ne nje periudhe afatmesme 2-3 vjecare, ne menyre qe te eliminojne aftesine ndikuese te operatoreve ne tregjet perkates te terminimit te thirrjeve.

Duke marre ne konsiderate faktoret (argumentat) e mesiperm, AKEP vlereson se kater operatoret celulare permbushin kriteret per fuqi te ndjeshme ne tregjet perkatese te terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetet e tyre celulare:

- *Sipermarresi Telekom Albania sh.a permbush kriteret perFNT ne tregun e terminimit te thirrjeve ne rrjetin celular Telekom Albania.*
- *Sipermarresi Vodafone Albania sh.a permbush kriteret perFNT ne tregun e terminimit te thirrjeve ne rrjetin celular Vodafone Albania.*
- *Sipermarresi Albtelecom sh.a permbush kriteret perFNT ne tregun e terminimit te thirrjeve ne rrjetin celular Albtelecom.*
- *Sipermarresi Plus Communication sh.apermbush kriteret per FNT ne tregun e terminimit te thirrjeve ne rrjetin celular Plus Communication.*

Percaktimi me FNT i operatoreve te rrjeteve celulare (MNO) aktive ne treg eshte tashme nje praktike e konsoliduar rregullatore europiane. Referuar dokumentave rregullatore te KE-se, dhe se fundmi edhe dokumentit te BEREC *BoR (16) 159, 'BEREC Report Regulatory Accounting in Practice 2016' 6 October 2016,* rezulton se te te gjithe operatoret e rrjeteve celulare aktive ne treg jane percaktuar si operatore me FNT per terminimin e thirjeve zanore ne rrjetet e tyre, dhe ne disa vende edhe MVNO-te jane percaktuar me FNT per kete sherbim.

Masat rregulluese për FNT në terminim

AKEP bazuar ne gjetjet e analizes se vitit 2014 nepermjet Vendimeve 2522-2526, date 14.11.2014, te ndryshuara me Vendimin 2542, date 13.03.2015, ka percaktuar masat rregullatore ndaj operatoreve me FNT ne tregun e terminimit te thirrjeve, ne reference te Ligjit 9918 dhe kuadrit rregullator, qe ne permbledhje jane:

1. Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 39)
2. Detyrimi i transparencës (Neni 40)
3. Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42)
4. Detyrimi për kontroll të tarifave (Neni 45)

AKEP propozon qe te te kater operatoret te vazhdojne te kene te njejtat detyrime per FNT ne terminimin e thirrjeve.

Detyrimi i mos-diskriminimit per FNT ne terminimin e thirrjeve, do te vijoje te zbatohet sipas percaktimeve te kryera ne analizen e meparshme dhe perfshin edhe detyrimin e mos-diskriminimit ne tarifat me pakice te thirrjeve on-net/off-net. AKEP gjykon se vazhdimi i zbatimit te kesaj mase eshte i nevojshem, pasi pavaresisht ndryshimeve te ndjeshme ne strukturen e thirrjeve celulare, te evidentuara ne kete dokument, ne mungese te ketij detyrimi operatoret celulare do te kishin stimulin e rikthimit ne praktikat tarifore te meparshme. Kjo theksohet akoma me shume nga fakti se megjithe ndryshimet e vena re ne strukturen e thirrjeve dhe rritjen e ndjeshme te thirrjeve off-net, pjeset e tregut ne treguesit kryesore nuk kane pesuar ndryshime te ndjeshme.

AKEP gjykon se masa e rregullimit (kontrollit) te tarifave te terminimit te kater operatoreve me FNT eshte e nevojshme, pasi ne mungese te saj secili operator, qe eshte monopolist ne ofrimin e terminimit te thirrjeve ne rrjetin e vet, do kishte stimujt per te aplikuar tarifa te larta terminimi ne dem te konkurrences dhe interesave te konsumatoreve.

Sic eshte theksuar me siper, ky dokument nxirret ne keshillim publik ne lidhje me perfundimet e AKEP per perkufizmin e tregjeve, FNT dhe masat rregulluese te propozuara per FNT. Ne lidhje me metoden e kontrollit te tarifes se terminimit te sipermarresve te propozuar per status me FNT, si dhe nivelet perkatese te tyre, AKEP do te zhvilloje nje proces te vecante keshillimi publik, ne perputhje me percaktimet e nenit 57 e ne vijim te Ligjit 9918. Ky proces do te kryhet se shpejti dhe paralelisht me keshimin publik te ketij dokumenti ne javet ne vijim.

Nga analiza rezulton se tregu me pakice celular ka sjelle rritje te perfitimeve te perdoruesve fundore nga konsumi i sherbimeve celulare ne terma te rritjes se perdorimit te sherbimeve celulare sidomos te dhena (Internet) ne rrjetet 3G/4G, tarifa me te lira dhe pa diskriminim ne thirrjet brenda dhe jashte rrjetit, rritje te krahasueshmerise/transparences se tarifave, si dhe me shume zgjedhje ne paketa sipas cmimit, sasise dhe afatit te perdorimit te paketave ne sektorin me parapagim. AKEP pret qe keto perfitime te vijojne te rriten edhe ne vitet ne vijim dhe te rritet perdorimi i sherbimeve te reja te aksesit broadband nepermjet rrjeteve 4G.

Masat e marra ne nivel me shumice per terminimin e thirrjeve vleresohet se kane pasur efekt pozitiv ne treg dhe vazhdimi i zbatimit te tyre, se bashku me masat e tjera rregulluese per operatoret celulare, vleresohet te jene te mjaftueshme per te adresuar problematikat e mundshme qe mund te shfaqen ne tregun me pakice.

Ne lidhje me problematiken e diferencave te medha ne tarifat per njesi komunikimi dhe paketave/ofertave, AKEP vlereson se megjithese tarifimi per njesi komunikimi pa aktivizuar ofertat/paketat aplikohet per sasi te vogla komunikimi, ai ka nevoje per adresim. AKEP eshte duke vleresuar menyrat e mundshme te adresimit te ketij problemi jashte statusit me FNT, pasi tregu me pakice celular nuk eshte treg i justifikushem per nderhyrje ex-ante. Nje alternative per adresimin e ketij problemi mund te jete rregullimi i tarifave per njesi komunikimi (thirrje/SMS kombetare, Internet) qe jane jashte paketave/ofertave, duke percaktuar cmime tavan (maksimale) si pjese e Sherbimit Universal.

II.Hyrje

Ky dokument i nxjerre per keshillim publik permban analizen e tregut me shumice te terminimit te thirrjeve ne rrjetet celulare si dhe te tregut me pakice te sherbimeve celulare. Dokumenti permban nje rishikim te perfundimeve te analizes se tregut celular te kryer ne vitin 2014 dhe masave rregulluese perkatese per FNT. Ne kete kapitull AKEP ka perfshire nje pershkrim te kuadrit ligjor dhe nen-ligjor per analizen e tregut si dhe te procesite te anlizes se tregut ne vitin 2014.

II.1 Kuadri ligjor dhe rregullator per percaktimin e sipermarresve me FNT

Ky seksion permban informacion ne lidhje me kuadrin ligjor dhe nen-ligjor per analizen e tregut, rolin e analizes se tregut dhe masave rregulluese, konceptin e dominances/FNT dhe lidhjet midis rregullimit ex-ante nga rregullatori sektorial dhe atij ex-post nga autoriteti i konkurrences.

Objektivat e Ligjit dhe kuadri rregullator

Ligji nr.9918, date 19.05.2008 ”Per Komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise”, i ndryshuar, (ne vijim Ligji 9918), ne nenin 1 te tij, percakton se qëllimi i ligjit është që nëpërmjet parimit të asnjanësisë teknologjike të promovojë konkurrencën dhe infrastrukturë efiçente në komunikimet elektronike dhe të garantojë shërbimet e duhura dhe të përshtatshme në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 7 i Ligjit 9918, Objektivat Rregullatore, percakton midis te tjerave se AKEP nxit konkurrencën efiçente për sigurimin e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, facilitetet shoqëruese dhe shërbimet e tjera për t’u krijuar mundësinë çdo kategorie përdoruesish të shërbimeve të komunikimeve elektronike, përfshirë edhe përdoruesit me aftësi të kufizuara, të kenë përfitime maksimale nga aksesi në shërbimet e komunikimeve elektronike, në kuptimin e zgjedhjes së çmimit dhe cilësisë.

Kapitulli VI, Rregullimi i Konkurrences, permban percaktimet per rregullimin e konkurrences ne tregun e komunikimeve elektronike, dhe perfshin ndermjet te tjerave detyrimin e AKEP per kryerjen e analizes se tregut per vleresimin e konkurrences efektive dhe percaktimin e sipermarresve me fuqi te ndjeshme ne treg. Kreu VI, permban gjithashtu kriteret e perdorura nga AKEP per vleresimin e fuqise se ndjeshme ne treg, detyrimet/masat rregulluese ne rast te gjetjes se FNT.

Pika 4 e nenit 31, parashikon detyrimin per nje rregullore per analizen e tregjeve dhe percaktimin e FNT. AKEP me vendimin Nr.747, date 17.07.2009, ka miratuar Rregulloren per Analizen e Tregjeve (ne vijim referuara si Rregullorja), dhe me Vendimin nr.2342, date 31.07.2013 ka miratuar amendime te kesaj Rregulloreje. Rregullorja percakton midis te tjerave nje liste prej 7 tregje per t’u analizuar nga AKEP per FNT, si dhe detyrimin per te kryer testin e tre kritereve per tregjet qe nuk jane pjese e listes se tregjeve te rregullores ose e Rekomandimit ne fuqi te Komisionit Europian per tregjet perkatese te dyshuara per nderhyrje ex-ante ne sektorin e komunikimeve elektronike. Lista e tregjeve te perfshira ne rregullore eshte sipas rekomandimit te

KE te vitit 2007, ndersa rekomandimi i fundit ne fuqi i KE eshte Rekomandimi 2014/710/EC i dates 9 Tetor 2014.

Ligji 9918 eshte ne linje me direktivat e KE te vitit 2003 dhe 2009 dhe metodologjia e analizes se tregjeve e percaktuar ne Ligj dhe ne Rregullore, percakton se AKEP duhet te marre ne konsiderate rekomandimet e Komisionit Europian dhe BEREC. Disa nga Rekomandimet dhe udhezimet e KE dhe BEREC (me pare ERG) te marra ne konsiderate nga AKEP ne pergatijen e ketij dokumenti jane si më poshtë:

- Udhëzimi i komisionit (europian) për analizën e tregut dhe vlerësimin e FNT (2002/C 165/03) sipas kuadrit rregullator për komunikimet elektronike, rrjetet dhe shërbimet të komunikimit elektronik (ne vijim referuar si Udhezimi i KE)[1]
- Dokumenti i rishikuar i ERG[2] per Qendrim te perbashket ne qasjen ndaj masave rregullatore te duhura ne kuadrin rregullator te komunikimeve elektronike.
- Rekomandimi i Komisionit, datë 9 Tetor 2014 për produktet dhe shërbimet përkatëse brenda sektorit të komunikimeve elektronike të rregulluara ex ante në përputhje me Direktivën 2002/21/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit në një kuadër të përgjithshëm rregullator për rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik (2014/710/EC)
- Rekomandimi i Komisionit, datë 7 Maj 2009 për trajtimin rregullator të tarifave të terminimit në rrjete celulare dhe fikse në BE.
- Dokumenta te tjere te KE dhe BEREC sipas shenimeve perkatese.

Procesi i Këshillimit Publik

Ligji Nr.9918, parashikon në Nenin 35 të tij, procedurën e këshillimit me palet e interesit për analizën e tregut duke vendosur si afat një periudhe kohore prej 60 ditesh. Njekohësisht neni 36 përcakton se AKEP vendos, ndryshon, mban ose heq detyrime për FNT pas këshillimit me palët e interesuara. Ky dokument publikohet në faqen e Internetit të AKEP dhe palet e interesuara mund të dërgojnë komente në lidhje me përfundimet dhe propozimet e AKEP duke iu referuar pyetjeve të këshillimit publik ne Aneks 1 si dhe për cdo aspekt tjeter të lidhur me këtë dokument.

Dokumenti permban perkufizimin e tregut perkates, analizen per FNT dhe masat rregulluese te propozuara per FNT si mos-diskriminimi, transparenca, etj, perfshire detyrimin e kontrollit te tarifes. Pra dokumenti i analizes se tregut i nxjerre ne keshillim publik permban pervec te tjerave propozimet e AKEP per masat rregulluese/detyrimet per FNT, te cilat do te jene pjese e vendimit/vendimeve perkatese per FNT dhe masat rregulluese ne fund te procesit te analizes se tregut pas keshillimit publik.

[1] Official Journal of the European Communities C 165/7: "*Commission guidelines on market analysis and the assessment of significant market power under the Community regulatory framework for electronic communications networks and services (2002/C 165/03)*"

[2] ERG (06) 33 "*Revised ERG Common Positionon the approach to Appropriate remedies in the ECNS regulatory framework*" Final Version May 2006.

Dokumenti permban gjithashtu detaje dhe specifikime te detyrimeve per FNT, pervec metodes dhe specifikimeve per kontrollin e tarifave. Ne lidhje me detyrimin/masen rregulluese te kontrollit te tarifave te sipermarresve te propozuar per status me FNT, AKEP do te zhvilloje nje proces te vecante keshillimi publik, ne perputhje me percaktimet e nenit 57 e ne vijim te Ligjit 9918, per te percaktuar metoden e kontrollit te tarifave te sipermarresve me FNT ne keto tregje perkates, si dhe specifikime te ketij detyrimi. Ky proces keshillimi publik per rregullimin e tarifave te sipermarrsit/sipermarresve me FNT zakonisht eshte kryer ne te njejten kohe me keshillimin per dokumentin e analizes se tregut dhe masave rregulluese per FNT. Megjithate, AKEP edhe me pare ka kryer procese te vecanta keshillimi publik ne lidhje me specifikime te masave rregullatore si rregullimi i tarifave, orientimi ne kosto etj., te cilat nuk kane prekur perfundimet e analizave te tregut dhe masat rregulluese, por vetem metoda/specifikime te masave rregulluese.

Procesi i vecante i keshillimi publik per masen rregulluese te kontrollit te tarifave, nuk kryhet per te percaktuar nese do vendoset ose jo masa e rregulluese e kontrollit te tarifave (kjo eshte pjese e analizes se tregut), por per te percaktuar metoden dhe spefikimet e rregullimit te tarifave. Kjo qasje eshte ne perputhje me nenin 57 te Ligjit 9918 si dhe nenin 2, paragrafi 2 i Rregullores per Analizen e Tregut:

Dokumenti i analizës së tregut përmban përkufizimin e detajuar të tregut përkatëse, dimensionin e produktit/shërbimit dhe gjeografik, testin e tre kritereve sipas pikës 4 të nenit 3 (nëse kjo është e nevojshme), analizën për FNT dhe detyrimet rregullatore për FNT. ***Specifikimi i detyrimeve te vecanta rregullatore mund te kryhet me akte të tjera të AKEP.***

Analiza e tregut nga autoriteti rregullator dhe bashkepunimi me Autoritetin e Konkurences

Sipas Nenit 38 të Ligjit Nr.9918, AKEP-i duhet të bashkëpunojë me Autoritetin e Konkurrencës. Gjithashtu AKEP dhe Autoriteti i Konkurrencës (AK) kanë nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi me datë 29.08.2007, ku midis të tjerave "Neni 6", parashikon bashkëpunimin midis dy autoriteteve per perkufizimin e tregut, përcaktimin e dominancës/FNT, masave rregulluese etj. Ky dokument paralelisht i dergohet edhe AK per dhenien e komenteve perkatese.

Sic percaktohet ne aktet ligjore dhe nen-ligjore te komunikimeve elektronike ne Shqiperi dhe dokumentat e KE dhe BEREC, roli i analizes se tregut eshte te percaktoje nese tregu/tregjet perkates te analizuar jane apo tentojne te shkojne drejt konkurrences efektive dhe ne rast se jo percaktimin e operatorit/operatoreve me FNT dhe masat rregulluese ne tregun/tregjet perkatese qe cojne ne konkurrence efektive. Analiza e tregut bazohet fillimisht ne nje liste te tregjeve perkatese qe jane te justifikueshem/dyshuar per nderhyrje ex-ante, dhe bazuar ne parimet/kriteret e percaktuara per gjetjen e dominances sipas parimeve te legjislacionit per konkurrencen percaktohet operatori/operatoret me FNT ne treg. Megjithese analiza e tregut rregullatori sektorial bazohet ne parimet e konkurrences, roli i saj eshte i ndryshem nga analizat e AK per dominance dhe abuzim me dominacen. Analiza e tregut e rregulatorit sektorial bazohet ne te kaluaren, por vlereson dhe perspektiven e tregut dhe mundesise per FNT ne te ardhmen dhe merr

masa ne rast se vlersohet se do kete dominance ne te ardhmen, pra nderhyrje ex-ante per te eliminuar problemet qe mund te ndodhin ne treg nga dominanca. Ndersa, AK ne rastet e vlersimit te abuzimit me dominancen merr ne konsiderate sjelljen dhe demin qe mund te kete shkaktuar dominanca e nje operatori ne treg ne te kaluaren. Pra problemet qe mund te kene ndodhur nga sjellja abuzive ne nje treg te caktuar ne te kaluaren, adresohen nga ligji dhe nderhyrjet e AK.

Udhezimi i KE per analizen e tregjeve paraqet ne menyre me te detajuar ngjashmerite dhe ndryshimet midis analizave te kryera nga rregullatori i komunikimeve elektronike ne lidhje me perkufizimin e tregut perkates dhe dominances dhe ato te kryera nga autoriteti i konkurrences per abuzim me dominance apo vleresime te bashkimeve te kompanive. Ne paragrafet 30[3] dhe 31[4] te ketij udhezimi KE citon nder te tjera se percaktimi me FNT i nje sipermarresi ne rregullimin ex-ante nuk nenkupton automatikisht se ai eshte me pozite dominuese apo qe ka abuzuar me poziten dominuese sipas legjislacionit te konkurrences, si dhe ne praktike mund te ndodhe qe dy autoritetet (rregullatore dhe i konkurrences) te kryejne procedura paralele per te adresuar probleme te ndryshme ne tregjet perkates. Megjithate, KE thekson se ne te tilla raste detyrimet ex-ante te rregullatorit per FNT synojne te permbushin objektivat e direktivave (ligjit) ndersa masat e autoritetit te konkurrences synojne te sanksionojne marreveshje ose sjellje abuzive te cilat kufizojne ose shtremberojne konkurrencen.

Perkufizimi i tregut perkates

Ne kuader te analizave te kryera nga nje rregullator per qellime te analizes se konkurrences efektive dhe percaktimit te sipermarresit/sipermarresve me FNT, analiza e nje tregu perkates fillon me shqyrtimin e produkteve dhe sherbimeve qe konsiderohen te jene pjese e te njejtit treg.

Sic eshte cituar ne Analizat e tregut te meparshme AKEP ne lidhje me perkufizimin e tregut perkates, perdor perkufizimin e dhene ne nenin 3, pika 7 te Ligjit nr.9121, date 28.7.2003 "Per Mbrojtjen e Konkurrences" i ndryshuar:

---

[3] *The designation of an undertaking as having SMP in a market identified for the purpose of ex-ante regulation does not automatically imply that this undertaking is also dominant for the purpose of Article 82 EC Treaty or similar national provisions. Moreover, the SMP designation has no bearing on whether that undertaking has committed an abuse of a dominant position within the meaning of Article 82 of the EC Treaty or national competition laws. It merely implies that, from a structural perspective, and in the short to medium term, the operator has and will have, on the relevant market identified, sufficient market power to behave to an appreciable extent independently of competitors, customers, and ultimately consumers, and this, solely for purposes of Article 14 of the framework Directive.*

[4] *In practice, it cannot be excluded that parallel procedures under ex-ante regulation and competition law may arise with respect to different kinds of problems in relevant markets (15). Competition authorities may therefore carry out their own market analysis and impose appropriate competition law remedies alongside any sector specific measures applied by NRAs. However, it must be noted that such simultaneous application of remedies by different regulators would address different problems in such markets. Ex-ante obligations imposed by NRAs on undertakings with SMP aim to fulfil the specific objectives set out in the relevant directives, whereas competition law remedies aim to sanction agreements or abusive behaviour which restrict or distort competition in the relevant market.*

***Treg perkates**- jane produktet qe vleresohen si te zevendesueshme nga konsumatoret ose klientet e tyre, per sa u perket karakteristikave, çmimit dhe funksionit te tyre dhe qe ofrohen ose kerkohen nga ndermarrjet ne nje zone gjeografike me kushte te njejta konkurrence, zone kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese.*

Ky perkufizim i Ligjit nr.9121, date 28.7.2003 "Per Mbrojtjen e Konkurrences" i ndryshuar, eshte i ngjashem dhe ne linje me perkufizmin e dhene ne Udhezimin e KE, pika 44 [5], udhezim i perdorur nga AKEP (ERT) ne te gjitha analizat e meparshme. Per kete arsye si dhe duke qene se udhezimi i KE, eshte pjese e dokumentave te KE te referuara ne Rregullore per analizen e tregut, AKEP ne kete Analize perdor te njejten metodologji per percaktimin e produkteve/sherbimeve qe jane pjese e te njejtit treg perkates, si dhe ne Analizat e tjera te tregut, sic eshte shtjelluar dhe ne paragrafet ne vijim.

Perkufizimi i tregut per nje produkt/sherbim merr parasysh efektin e zevendesueshmerise se produktit/sherbimit (ne anen e kerkeses dhe ofertes), si edhe dimensionin gjeografik. Nje instrument ndihmes qe perdoret per identifikimin e tregjeve eshte parimi i monopolistit hipotetik.

Parimi i monopolistit hipotetik

Nje produkt konsiderohet te perbeje nje treg me vete nese "monopolisti" (hipotetik) qe ofron produktin mund te rrise çmimin e ketij produkti per nje periudhe kohe jo tranzitore dhe te mos kete renie ne shitje deri ne nivelin qe kjo te jete jo- fitimprurese. Pra, rritja e çmimit duhet te jete fitimprurese dhe e qendrueshme-monopolisti te kete aftesine te mbaje çmimin mbi nivelin konkurrues.

Testi i monopolistit hipotetik kryhet per te analizuar produktet/sherbimet te cilat mund te bejne pjese ne te njejtin treg duke marre ne konsiderate efektin e zevendesueshmerise se produkteve ne anen e kerkeses dhe/ose ofertes. Nese monopolisti perballet me kufizime nga ana e kerkeses-konsumatoret do te zhvendosen drejt konsumit te nje produkti tjeter, qe do ishte zevendesues dhe, nga ana e ofruesve- ofrues te tjere do te futeshin ne kete treg per te ofruar produktin me çmim dhe perfitim te larte, atehere produktet e tjera qe jane zevendesues te ngushte te produktit te analizuar duhet te perfshihen ne kete treg.

Zevendesimi ne anen e kerkeses

Nese nje subjekt, qe eshte monopol ne ofrimin e nje produkti/sherbimi, do te rriste çmimin e ketij produkti, çfare mundesish kane konsumatoret te zevendesojne perdorimin e ketij produkti me nje tjeter ?

Produkti/sherbimi qe analizohet krahasohet me produkte te tjere, nese ato mund te zevendesohen nga ana e konsumatorit. Nese konsumatoret mund te zevendesojne produktin e ofruar nga

[5] According to settled case-law, the relevant product/service market comprises all those products or services that are sufficiently interchangeable or substitutable, not only in terms of their objective characteristics, by virtue of ëhich they are particularly suitable for satisfying the constant needs of consumers, their prices or their intended use, but also in terms of the conditions of competition and/or the structure of supply and demand on the market in question (32). Products or services ëhich are only to a small, or relative degree interchangeable ëith each other do not form part of the same market (33).NRAs should thus commence the exercise of defining the relevant product or service market by grouping together products or services that are used by consumers for the same purposes (end use).

monopolisti hipotetik me nje produkt apo produkte te tjera, keto te fundit duhet te perfshihen ne perkufizimin e tregut perkates.

Zevendesimi ne anen e ofertes

Nese monopolisti hipotetik do te rriste çmimin e produktit/sherbimit per nje periudhe kohe jo tranzitore, a do te kishte presion nga ofrues te tjere te mundshem te ketij sherbimi? Operatore te tjere, te cilet nuk e ofrojne sherbimin ne fjale, mund te zhvendosin burimet e tyre ne drejtim te ofrimit te ketij sherbimi.

Ne zevendesimin ne anen e ofertes duhet te merren parasysh vetem operatoret, te cilet mund te zhvendosin burimet e tyre drejt ofrimit te sherbimit te marre ne konsiderate, per nje kohe te shkurter dhe pa kosto te larta te pakthyeshme. Pra, operatore te rinj qe nuk jane ne treg nuk mund te merren parasysh, pasi reagimi i tyre ndaj nje rritjeje te çmimit te produktit nuk do te ishte i shpejte (ne periudhe afatshkurter) por do te kerkonte kohe per investime kapitale qe kerkojne nje periudhe afatgjate. Ofruesit e mundshem jane operatore qe ofrojne sherbime te tjera dhe lehtesisht per nje periudhe kohe te shkurter mund te prodhojne edhe produktin, çmimi i te cilit eshte rritur.

Efekti i operatoreve te rinj ne treg, qe duhet te kryejne investime kapitale, merret ne konsiderate vetem ne analizen e fuqise se ndjeshme ne treg, pra te konkurrences se mundshme qe keta operatore mund te ushtrojne.

Nje faktor tjeter qe merret ne konsiderate ne perkufizimin e tregut perkates eshte nese ekzistojne kufizime te perbashketa ne tarifim (common pricing constraints) midis klienteve, sherbimeve apo zonave te ndryshme. Kjo do te thote qe operatori te mos jete i pavarur ne tarifimin e sherbimeve te ndryshme: s'ka mundesi te rrise çmimin e nje sherbimi pa reduktuar çmimin e nje sherbimi tjeter, i cili ne vetevete nuk eshte zevendesues per sherbimin tjeter.

Fuqia e Ndjeshme ne Treg dhe masat rregulluese

Pekufizimi i FNT eshte dhene ne nenin 33 te ligjit:

Një sipërmarrës vlerësohet me fuqi të ndjeshme në treg nëse, i vetëm, apo së bashku me të tjerë, zotëron një pozitë të tillë ekonomike, që i mundëson një zgjerim të ndjeshëm, pavarësisht nga konkurrentët, klientët apo përdoruesit fundorë.

Ky perkufzimi eshte pothuajse i njejte me perkufizimin e Direktives Kuader te KE 2002, neni 14[6] (EC 2002 Framework Directive).

Neni 33 i Ligjit percakton gjithashtu kriteret kryesore qe duhet merren ne konsiderate per analizen per FNT, duke bere nje ndarje per rastet kur ne treg dyshohet per nje sipermarres me FNT, qe do te thote dominance individuale, dhe per raste kur dyshohet per me shume se nje sipermarres me FNT apo dominance e bashkuar. Perkufizimi i dominances se bashkuar i dhene ne nenin 33 eshte si vijon:

[6] *'an undertaking shall be deemed to have significant market poër if, either individually or jointly ëith others, it enjoys a position equivalent to dominance, that is to say a position of economic strength affording it the poër to behave to an appreciable extent independently of competitors customers and ultimately consumers"*

Dy ose më shumë sipërmarrës vlerësohen se kanë një pozitë zotëruese nëse edhe në mungesë të lidhjeve strukturore apo të lidhjeve të tjera, veprojnë në treg në një strukturë dhe mënyrë të tillë, e cilatë çon në një sjellje të bashkërenduar, në mënyrë të pavarur nga konkurrentët, klientët ose përdoruesit.

Per percaktimin e FNT, dominace individuale apo e bashkuar, sic theksohet dhe ne pikat 79 dhe 98 te Udhezimit te KE, kriteret e perdorur duhen marre te gjithe ne konsiderate dhe ne kombinim me njeri tjetrin dhe jo ne menyre te vecante per secilin kriter me vete, pasi evidenca e kritereve te vecante mund te mos jete percaktuese e FNT.

Analiza per FNT eshte nje analize e cila merr ne konsiderate zhvillimet e kaluara dhe njekohesisht tendencen per te ardhmen (forëard looking), pasi mungesa e konkurrences ne te kaluaren nuk do te thote qe nje treg nuk ka tendence per te qene ne konkurrence ne te ardhmen. Ne kete menyre Analiza krahas shqyrtimit te kritereve per vleresimin e konkurrences efektive ne treg ne te kaluaren, ben vleresin se si pritet te evoluoje tregu ne te ardhmen. Analiza kryhet per te shqyrtuar nese nje treg perkates vleresohet te jete ne konkurrence efektive ne nje periudhe te pakten 2 vjecare, dhe mungesa e konkurrences efektive ne nje treg perkates te justifikueshem per nderhyrje ex-ante eshte e barazvlefshme me ekzistencen e fuqise se ndjeshme ne treg, prej nje ose me shume sipermarresish.

Ekzistenca e FNT do te te thote qe ne treg ka probleme te cilat identifikohen dhe ne baze te problemeve te evidentuara, propozohet marrja masave rregulluese apo detyrimeve per tu zbatuar nga sipermarresi/sipermarresit me FNT. AKEP ne baze te nenit 34, ka detyrimin qe ne rast te gjetjes se FNT ne nje treg perkates te vendose nje disa apo te gjitha detyrimet e cilesuara ne nenet 39-45 dhe neni 56 te Ligjit. Vendosja e detyrimeve/masave rregulluese per FNT duhet te marre ne konsiderate objektivat rregullatore te percaktuar ne Ligj.

Nese nga analiza arrihet ne perfundimin se tregu perkates eshte ne konkurrence efektive, pra nuk ka FNT, atehere AKEP nuk vendos detyrime dhe ne rast se ndaj sipermarresve jane vendosur detyrime (per shkak te statusit te meparshem me FNT) atehere AKEP i heq keto detyrime duke percaktuar dhe nje afat kohor jo me te gjate se 6 muaj per berjen efektive te tyre. Ky percaktim aplikohet edhe per tregjet e analizuara, por qe nuk permbushin testin e tre kritereve per nevojen per nderhyrje ex-ante.

II.2 Analiza e tregut celular 2014

AKEP bazuar në Ligjin 9918 (nenet 31 e në vijim, të Kreut VI mbi Rregullimin e konkurrencës), Rregulloren për Analizën e Tregut[7], gjatë vitit 2014 kreu procedurën e analizës së tregut celular, në përfundim të së cilës u miratuan vendimet e mëposhtëme:

1. Vendimi nr. 2522, datë 06.11.2014, për "*Miratimin e Dokumentit: Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe tregu me pakice te sherbimeve publike në rrjetet e telefonisë së sipërmarrësit Vodafone Albania Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Vodafone Albania dhe vendosjen e masave rregulluese*"

[7]"Rregullore per Analizen e Tregut" miratuar me Vendimin nr. 747, datë 17.07.2009, të Keshillit Drejtues të AKEP, ndryshuar me VKD nr.2342, datë 31.07.2013.

2. Vendimi nr. 2524, datë 06.11.2014 për "*Përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone Albania Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Vodafone Albania dhe vendosjen e masave rregulluese*"
3. Vendimi nr. 2524, datë 06.11.2014 për "*Përcaktimin e sipërmarrësit Plus Communication Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Plus Communication dhe vendosjen e masave rregulluese*"
4. Vendimi nr. 2525, datë 06.11.2014 për "*Përcaktimin e sipërmarrësit Albanian Mobile Communications*[8] *Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Albanian Mobile Communications dhe vendosjen e masave rregulluese*"
5. Vendimi nr. 2526, datë 06.11.2014 për **"***Përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Albtelecom dhe vendosjen e masave rregulluese***"**

Dokumenti dhe vendimet e cituara u morën në përfundim të procesit të këshillimit publik, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar. Ne lidhje me detyrimet per FNT, AKEP vendosi qe te kater operatoret te vazhdojne te kene detyrimet e percaktuara ne ligjin 9918:

- Mosdiskriminimi (neni 39),
- Transparenca (neni 40),
- Dhenie Akses dhe Interkoneksion dhe perdorimi i perbashket i faciliteteve te rrjetit (neni 42),
- Kontrolli i tarifave dhe sistemi i mbajtjes se llogarive(neni 45)
- Ndarja e llogarive[9] (neni 41)

Ne lidhje me rregullimin e tarifave, AKEP percaktoi qe:

- Tarifa e terminimit e Vodafone, AMC dhe EM te reduktohet me 1.12.2014, ne nivelin 1.48 lek/minute, qe perben tarifen mesatare benchmark per vendet anetare dhe kandidate ne BE qe kane aplikuar LRIC te paster ne 2013 (te percaktuar ne dokumentin e miratuar me 13.03.2014);
- Tarifa e terminimit ne rrjetin Plus Communication te qendroje 6.52 lek/minute deri ne nej vendim tjeter te AKEP.

AKEP në analizen e tregut ne 2014 ri-konfirmoi perfundimin, se tregu me pakice celular nuk eshte me treg i justifikueshem/dyshuar per nderhyrje ex-ante duke u bazuar ne nje sere faktoresh te lidhur jo vetem me rekomandimet e KE dhe BEREC dhe pervojave ne Evrope, por edhe ne zhvillimet pozitive te ketij segmenti te sektorit te komunikimeve elektronike ne Shqiperi si rrjedhoje e rritjes se ndjeshme te konkurrences nga hyrjet e reja ne treg ne 2008-2010 dhe rregullimeve te AKEP ne nivel me shumice (2006 e ne vijim) dhe me pakice (2008-2009), te cilat sipas treguesve kryesore te sektorit kane cuar ne rritje te ndjeshme te perfitimeve te perdoruesve fundore te sherbimeve celulare: sherbime tradicionale (thirrje dhe SMS) dhe sherbime te aksesit broadband ne Internet 3G/4G.

Bazuar ne rekomandimet e AK nepermjet Vendimit nr.303, datë 16.01.2014, si dhe problematiken e evidentuar te diskriminimit te tarifave te thirrjeve on-net/off-net, AKEP ne analize 2014 i kushtoi vemendje te vecante ndikimit te ketij fenomeni ne konkurrencen afat-gjate

[8] Sot Telekom Albania sh.a
[9] Vetem per Vodafone, Telekom Albani dhe Albtelecom

ne tregun celular duke vendosur masa shtese rregulluese ne lidhje me detyrimin e mos-diskriminimit. AKEP vendosi nder te tjera qe secili sipermarrës rrjeti celular ndalohet të aplikojë tarifa në nivel me pakicë që kanë efekt diskriminues për sipërmarësit e rrjeteve të tjera celulare kombëtare:

1) *tarifat e thirrjeve drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare nuk duhet të jenë më të larta se tarifat e thirrjeve brenda rrjetit;*
2) *Sasia e minutave brenda rrjetit të përfshira në oferta/pagesë fikse të paketave tarifore nuk duhet të jetë më e madhe se sasia e minutave drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare;*
3) *Përcaktimet e pikave 1 dhe 2 më sipër aplikohen për të gjitha paketat tarifore standarte, ofertat, shportat, opsionet dhe skontot të ofruara për pajtimtarët;*

Vendimet e datës 6.11.2014 të AKEP parashikonin që detyrimet e mësipërme, se bashku me disa masa shtese ne lidhje me afatin e ofertave/promocioneve te operatoreve celulare, të jenë detyruese për operatorët celulare duke filluar aplikimin e tyre nga data 1.01.2015.

Bazuar në të drejtën e ankimit të akteve adminstrative të parashikuar në Ligjin Nr. 8584, datë 12.05.1999 të Kodit të Procedurave Administrative, i ndryshuar (Neni 137), të katër sipërmarrësit e rrjeteve celulare, Albanian Mobile Communications (sot Telekom Albania) sh.a., Albtelecom sh.a., Vodafone Albania sh.a. dhe Plus Communication sh.a , të prekur direkt dhe indirekt nga Vendimet e datës 6.11.2014, brenda afatit 30 ditor të parashikuar në Kodin e Procedurave Administrative, depozituan në AKEP, ankime administrative për Vendimet nr. 2522-2526, datë 06.11.2014.

AKEP bazuar në përcaktimet e Kodit të Procedurave Administrative, si dhe praktikave te meparshme te shqyrtimit te ankimeve administrative, kreu shqyrtimin e të katër ankimeve administrative, duke miruatuar vendimet e meposhtme me date 13.03.2015:

- Vendim nr.2542, datë 13.03.2015, për "Disa shtesa dhe ndryshime në Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 2522, 2523, 2524, 2525 dhe 2526, datë 6.11.2014". Ky Vendim, përbën shqyrtimin e përbashkët të katër ankimeve administrative dhe modifikimin e akteve të ankimuara nga sipërmarrësit.
- Vendim nr.2543, datë 13.03.2015, për "Shqyrtimin e ankimit administrativ të sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a për Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me nr.2522, 2523 dhe 2524 datë 6.11.2014"
- Vendim nr.2544, datë 13.03.2015, për "Shqyrtimin e ankimit administrativ të sipërmarrësit Albtelecom sh.a për Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 2522, 2524 dhe 2526 datë 6.11.2014
- Vendim nr.2545, datë 13.03.2015, për "Shqyrtimin e ankimit administrativ të sipërmarrësit Albanian Mobile Communications sh.a për Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me nr.2522 dhe 2525, datë 6.11.2014"
- Vendim nr.2546, datë 13.03.2015, për "Shqyrtimin e ankimit administrativ të sipërmarrësit Plus Communication sh.a për Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me nr.2522 dhe 2524, datë 6.11.2014"

Nepermjet ketyre vendimeve, AKEP vendosi ndryshimin e vendimeve te dates 6.11.2014, ku me kryesoret ishin:

- Përcaktimi i një glide-path (reduktim të përshkallëzuar) në kohë të tarifës së terminimit të Plus, duke arritur simetrine me tarifat e terminimit te thirrjeve ne rrjetet celulare te tre operatoreve te tjere ne nivelin 1.48 lek/minute me 1.01.2016;
- Përcaktimin si afat të fillimit të zbatimit të detyrimeve për mos-diskriminimin në tarifat e thirrjeve on-net/off-net, në afatet e mëposhtme:
  - *data 1.07.2015: për programet tarifore, ofertat, opsionet etj., për përdoruesit me parapagim dhe përdoruesit e rinj me kontratë, përfshirë rinovimet e kontratave ekzistuese që kryhen pas kësaj date,*
  - *data 1.01.2016: për të gjitha programet e tjera tarifore të aplikuara për përdoruesit aktualë me kontratë (kontrata me programe tarifore standarde dhe të personalizuara/specfike).*
- Heqjen e detyrimit per ndarjen e llogarive te operatoreve celulare

AKEP ka bere arsyetimin per ndryshimet e mesiperme ne Vendimin nr.2542, date 13.03.2015, ku me kryesoret jane:

- Percaktimin e nje glide-path reduktimi te pershkallezuar te tarifes se terminimit ne rrjetin Plus si edhe ne te gjitha vendimet e tjera te AKEP lidhur me orinntimin ne kosto te tarifave te terminimit ne rrjetet celulare dhe ne perputhje me rekomandimet e BEREC/ERG per afate te caktuara me limit per asimetrine;
- Implementimi efektiv i detyrimeve te mos-diskriminimit ne tarifat e thirrjeve on-net/off-net eshte i lidhur ngushtesisht me reduktimin dhe eliminimin ne asimetrine e tarifave te terminimit, pasi e kunderta krijon probleme serioze per kete mase rregulluese ne interes te konkurrences ne treg dhe perfitimeve te perdoruesve fundore ne teresi.

AKEP në vijim të percaktimeve ne pjesen arsyetuese te Vendimit 2542/2015 dhe percaktimeve ligjore për monitorim të situates ne treg, bazuar në vlerësimin e rrethanave konkrete në treg, me VKD 2664, datë 14.01.2016, njoftoi operatoret për një pezullim 90 ditor në lidhje me fillimin e aplikimit të simetrisë me datë 1.01.2016.

AKEP me Vendim nr.2676, datë 14.04.2016, miratoi mbylljen e procesit te filluar me VKD 2664 dhe miratimin e rezultateve, duke vendosur datën 1 Prill 2016 si datë për vendosjen e simetrisë së MTR për të gjithë operatorët.

<u>Proceset gjyqesore</u>

Sipermarresi Plus Communication sh.a ankimoi ne rruge gjyqesore Vendimin nr.2542, date 13.03.2015 duke kerkuar shfuqizimin e ndryshimeve te kryera nepermjet ketij vendimeve per tarifen e terminimit te thirrjeve ne rrjetin Plus dhe afatin e fillimit te aplikimit te detyrimit te mos-diskriminimit ne tarifat e thirjeve on-net dhe off-net.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr.1567 datë 1.04.2016 ka pranuar kërkesë padine e Plus Communication. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me Vendimin Nr.2459 datë 9.09.2016, ka lene ne fuqi vendimin të Gjykates Administrative të Shkallës së Parë, Tirane.

AKEP ka depozituar në Gjykatën e Lartë recurs në lidhje me Vendimin Nr.2459 datë 9.09.2016 të Gjykatës Administrative e Apelit Tiranë dhe është në pritje të sqarimeve nga Gjykata e Lartë.

Vodafone, Telekom Albania dhe Albtelecom ankimuan Vendimin 2664/2016 dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin Nr.80-2016-4342, datë 26.09.2016, pranoi kerkese padine e tre operatoreve. AKEP ka apeluar kete vendim ne Gjykaten Administrative te Apelit Tiranë dhe eshte ne pritje te vendimit te kesaj gjykate.

Plus Communication ankimoi ne rruge gjyqesore Vendimin 2676/2016 dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr. 80-2016-5079, datë 31/10/2016, pranoi kerkese padine e Plus. AKEP ka apeluar kete vendim ne Gjykaten Administrative te Apelit Tiranë dhe eshte ne pritje te vendimit te kesaj gjykate.

Sic mund te vihet re proceset gjyqesore kane krijuar dhe nje konfuzion ne lidhje me tarifat qe duhet te aplikohen per terminimin e thirrjeve ne rrjetin Plus, nga data 1.04.2015 e ne vijim. AKEP nuk ka te drejte te kryeje interpretim te vendimeve te gjyqesorit dhe ka orientuar palet ne gjetjen e zgjidhjeve sipas percaktimeve te ligjeve perkatese.

Analiza e AKEP ne kete dokument ne lidhje impaktin e masave rregullatore ne tregun me pakice celular i referohet zbatimit te detyrimeve te percaktuara sa me siper, duke qene se detyrimet per mos-dikriminimin ne tarifat on-net/off-net jane lidhur dhe me reduktimin dhe eliminimin e asimetrise ne tarifat e terminimit te thirrjeve midis operatoreve. Njekohesisht nga arsyetimi i vendimeve te gjykatave, vihet re se ceshtjet e diskutueshme lidhen me proceduren e ankimeve administrative dhe te drejten e ndryshimit te masave rregulluese/specifikave te tyre me keto procedura dhe te tjera te ndjekura nga AKEP ne vijim te analizes se tregut celulare ne vitin 2014.

III. TREGU ME PAKICE I SHERBIMEVE CELULARE

Analiza ne kete kapitull vijon me nje panorame te tregut celular dhe zhvillimeve te tij ne terma te ofruesve, perdoruesve te sherbimeve celulare dhe perfitimeve te tyre per perdorimin dhe tarifat, konkurrencen ne treg etj. Analiza permban edhe krahasim te disa treguesve kryesore te tregut ne Shqiperi me vende te tjera, BE dhe rajon. Analiza fokusohet gjithashtu ne impaktin qe kane pasur masat rregullatore per terminimin e thirrjeve te vendosura nga analiza e fundit ne tregun me pakice celular. Ne kapitullin V, AKEP paraqet konkluzionet e analizes se tregut me pakice dhe pritshmerite per kete treg ne vitet ne vijim ne presence te masave rregulluese te propozuara per tregun me shumice te terminimit te thirrjeve ne rrjetet celulare (kapitulli IV).

III.1. Ofruesit e rrjeteve/shërbimeve celulare

Bazuar ne Ligjin 9918, sipermarresit qe ofrojne rrjete dhe sherbimeve celulare jane te regjistruar se pari ne Regjistrin e Autorizimeve te Pergjithshme per keto sherbime, dhe ne rast te nevojes se perdorimit burimeve te fundme te ralla si frekuenca dhe numeracion per te ofruar keto sherbime, pajisen me autorizim individual per keto burime te fundme, sipas procedurave te ligjore dhe nen-ligjore. Në sektorin e rrjeteve dhe sherbimeve celulare ushtrojnë veprimatrinë e tyre si sipërmarrës ofrues te sherbimeve/rrjeteve celulare:

- Telekom Albania sh.a (me pare Albanian Mobile Communications sh.a)
- Vodafone Albania sh.a
- Albtelecom sh.a
- Plus Communication sh.a

Operatori Albanian Mobile Communications (AMC) është licensuar si operator publik kombetar i telefonise celulare ne vitin 1996 dhe ka funksionuar si kompani shteterore deri ne Shtator te vitit 2000, kur u krye privatizimi i 85 per qind te aksioneve[10], pjese e cila u ble nga Cosmote Group[11], operatori celular ne Greqi, e cila eshte vete pjese e grupit OTE, operatorit incumbent në Greqi. Ministria e Ekonomise Tregtise dhe Energjetikes zoteroi rreth 12.6% të aksioneve të Telekom Albania Sh.a, deri ne vitin 2008, kur u krye dhe shitja e kesaj pjese Cosmote Group. Afersisht 2.4% te aksioneve zoteroheshin nga aksionere te vegjel (punonjes te AMC ne kohen e privatizimit) te cilat me pas jane blere nga Cosmote Group. Deutsche Telekom është aksioneri më i madhe i OTE. Në Korrik 2015, Albanian Mobile Communications ndryshoi emrin në Telekom Albania.

Operatori Vodafone Albania është licensuar si operatori i dytë kombëtar i sherbimit celular në Shqiperi më 9 Qershor 2001. Aksioneret e Vodafone Albania jane Vodafone Europe B.V[12]. dhe

[10] Kontrata e shitjes se aksioneve te Telekom Albania, eshte ratifikuar ne Kuvendin e Republikes se Shqiperise me Ligjin nr. 8660, date 18.09.2000.

[11] Cosmote Mobile Telecommunications S.A. zoteron 99.76 % të Telekom Albania, sipas informacionit te marre në në www.qkr.gov.al në datën 13/07/2016

[12] Sipas informacionit te marrë në www.qkr.gov.al në datën 13/07/2016

Vodafone Panafon International Holding B.V, te cilët zoterojne secili 50 përqind te aksioneve. Në 3 Gusht 2001 Vodafone Albania filloi ofrimin e shërbimeve të saj GSM në Shqipëri.

Operatori Albtelecom është licensuar si operatori i trete kombetar i sherbimit celular ne Shqiperi me 1 Mars 2004. Licensa i eshte dhene Albtelecom si pjese e paketes se privatizimit te kësaj kompanie, proces i cili perfundoi ne vitin 2007. Operatori Eagle Mobile filloi ofrimin e sherbimeve celulare ne Mars 2008 nën emrin . Eagle Mobile sh.a ka funksionuar si kompani me vehte me 100% pronesi te Albtelecom sh.a deri me 31.01.2013, duke u perthithur me pas nga Albtelecom sh.a.[13] Pas bashkimit te dy kompanive sherbimet celulare ofrohen nga Albtelecom sh.a, duke vazhduar njekohesisht edhe perdorimin e emrit Eagle Mobile. Albtelecom sh.a ka si aksioner kryesor Cetel[14] Telekom Iletisim Sanayi Ve Ticaret me 76% të aksioneve.

Operatori Plus Communication (me pare Mobile 4 Al) është operatori i katërt celular, të cilit i'u akordua autorizimi individual nga AKEP me date 26.06.2009. Autorizimi individual iu dha konsorciumit të perfaqesuar nga Poste Telekomunikacioni i Kosoves (PTK) në bazë të Ligjit nr.10118, date 23.04.2009 "Për dhënien e së drejtës së përdorimit, për 15 vjet, në brezin e frekuencave E-GSM dhe GSM 1800, bashkimit të ofertuesve, përfaqesuar nga Postë Telekomunikacioni i Kosovës Sh.a., sipas procedurës "Tender i hapur ndërkombëtar", i datës 20.02.2009". Plus Communication filloi ofrimin e sherbimeve te telefonise se levizshme ne fund te muajit Nentor 2010.

Licensat/autorizimet fillestare te operatoreve te rrjeteve celulare kane qene per perdorim te brezave 900 dhe 1800 MHz dhe ofrim te sherbimeve celulare ne standardin GSM me afat 15 vjet nga dhenia e tyre. Prej vitit 2010 AKEP ka kryer nje numer te konsiderueshem procedurash konkurruese[15] per te alokuar sasi spektri edhe ne brezat 1900/2100 MHz (per perdorim te frekuenceve sipas standardit UMTS-sherbime 3G) dhe 2500/2600 MHz (per perdorim te frekuenceve sipas standardit LTE-4G). Ne vitin 2015 AKEP finalizoi procesin e heqjes se kufizimeve teknologjike ne perdorimin e brezave te frekuencave te operatoreve te rrjeteve celulare, duke mundesuar perdorimin e te gjithe spektrit ne dispozicion te operatoreve celulare per sherbime te gjenerates se katert (4G) apo standardi LTE. E drejta e përdorimit të spektrit pa kufizim teknologjik dhe shfrytëzimi i spektrit pa kufizime filloi nga data 01.09.2015. Shërbimet bazuar në standardet GSM (2G) dhe UMTS (3G) ofrohen nga te kater operatoret, ndersa ne standardin LTE (4G), ofrohen nga Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom (Eagle Mobile).

Me mbarimin e afateve te autorizimeve individuale per brezat 900/1800 MHz te Telekom Albania dhe Vodafone Albania te leshuara si licensa ne vitet 2000 dhe 2001, AKEP ne vitet 2015

[13]Perthithja e Eagle Mobile sh.a nga Albtelecom sh.a.sipas legjislacionit ne fuqi eshte miratuar paraprakisht nga Autoriteti i Konkurrences dhe AKEP me VKD nr. .2270, datë 13.02.2013, ka miratuar kalimin e të gjitha te drejtave dhe detyrimeve të caktuara me pare Eagle Mobile sh.a. tek sipermarresi Albtelecom sh.a.

[14] Sipas informacionit te marrë në www.qkr.gov.al në datën 13/07/2016

[15] Procedurat jane kryer sipas akteve lighjore dhe nen-ligjore ne fuqi, dhe ato kane qene konkurruese dhe te gjithe operatoret celulare kane pasur te drejte pjesemarrje. Ne disa procedura jane perjashtuar nga pjesmarrja operatoret qe kane pasur tashme te drejte perdorimi ne brezin e alokuar dhe/ose operatori qe nuk ka pasur te drejte me pare ka pasur perparesi ne fitimin e te drejtes.

dhe 2016, pas procedurave perkatese ligjore, miratoi rinovimin e ketyre Autorizimeve Individuale per nje kohezgjatje tjeter prej 15 vitesh.

Tabela e meposhtme paraqet nje permbledhje te sasise se spektrit ne dispozicion te secilit operator celulare sipas brezave te frekuencave dhe afatet e autorizimeve individuale perkatese.

TABELA III.1. SPEKTRI I FREKUENCAVE TE ALOKUARA OPERATOREVE CELULARE (NENTOR 2016) [16]

Sipermarres	Brezi i frekuencave	Sasia e Spektrit	Teknologjia	Kohezgjatja e Autorizimit Individual
Vodafone Albania	900 MHz	2x1.2 MHz	FDD	Qershor (Korrik) 2015– Qershor (Korrik) 2030
		2x7.8 MHz		Qershor 2016 – Qershor 2031
	1800 MHz	2x 9 MHz	FDD	Qershor 2016 – Qershor 2031
		2x 14.4 MHz	FDD	Prill 2015 – Prill 2030
	1900/2100 MHz	2x15 MHz	FDD	Dhjetor 2010 - Dhjetor 2025
		2x5 MHz	FDD	Nentor 2014- Nentor 2029
	1900 MHz	1x5 MHz	TDD	Dhjetor 2010 - Dhjetor 2025
	2500/2600 MHz	2x40 MHz	FDD	Maj 2015 – Maj 2030
Telekom Albania	900 MHz	2x 8 MHz	FDD	Gusht 2014 – Gusht 2028
	1800 MHz	2x 9 MHz	FDD	Gusht 2014 – Gusht 2028
		2x 12 MHz	FDD	Prill 2015 – Prill 2030
	1900/2100 MHz	2x14.8 MHz	FDD	Shtator 2011 - Shtator 2026
	1900 MHz	1x5 MHz	TDD	Shtator 2011 - Shtator 2026
	2500/2600 MHz	2x20 MHz	FDD	Maj 2015 – Maj 2030
Albtelecom	900 MHz	2x 8 MHz	FDD	Mars 2004 –Mars 2019
	1800 MHz	2x 9 MHz	FDD	Mars 2004-Mars 2019
		2x 12 MHz	FDD	Prill 2015 – Prill 2030
	1900/2100 MHz	2x14.8 MHz	FDD	Nentor 2012 - Nentor 2027
	1900 MHz	1x5 MHz	TDD	Nentor 2012 - Nentor 2027
	2500/2600 MHz	2x20 MHz	FDD	Maj 2016 – Maj 2031

[16] Tabela perfshin vetem spektrin e alokuar ne brezat 900, 1800, 1900/ 2100 dhe 2500/2600 MHz te cilat jane specifike per perdrorim nga rrjetet celulare.

PLUS	900 MHz	2x 8 MHz	FDD	Qershor 2009 - Qershor 2024
	1800 MHz	2x 8.8 MHz	FDD	Qershor 2009 - Qershor 2024
	1900/2100 MHz	2x10 MHz	FDD	Prill 2016 – Prill 2031

Tregues kryesore të përdorimit të shërbimeve celulare[17]

Numri i përdoruesve aktive të telefonisë celulare (pajtimtarë që kanë përdorur shërbime celulare në 3 muajt e fundit) në fund të vitit 2015 arriti ne 3.4 milion. Kjo përbën një rritje vjetore me 1% për të katër operatorët, ndërkohë që numri i përdoruesve të telefonisë së lëvizshme sipas kartave SIM, pati reduktim me 3%, duke arritur në 4.74 milion krahasuar me 4.88 milion në fund të vitit 2014. Norma e penetrimit (përdorues për 100 banorë) në 2015 ishte 120% sipas përdoruesve aktivë dhe 167% sipas kartave SIM. Numri i pajtimtarëve celularë që përdorin shërbimet e aksesit broadband (3G/4G) në 2015 arriti në rreth 2 milion, duke u rritur me 30%, në krahasim me një vit më parë: numri pajtimtarëve me akses broadband 3G/4G me karta USB/modem u reduktua me 25%, ndërsa numri i pajtimtarëve me akses broadband 3G/4G nga aparatet celulare u rrit me 38%. Tabela e mëposhtëme paraqet disa tregues kryesorë të volumit të shërbimeve celulare për vitet 2011-2015 dhe normën e ndryshimit vjetor të tyre.

TABELA III.2: TREGUES KRYESORË TË VOLUMIT TË SHËRBIMEVE CELULARE 2011-2015

	2011	2012	2013	2014	2015	Ndryshimi 2015/2014
Numri i perdoruesve aktive	3,108,087	3,537,285	3,685,983	3,359,654	3,400,955	**1%**
Numri i perdoruesve sipas kartave SIM aktive	5,236,349	5,619,607	5,282,350	4,881,666	4,736,175	**-3%**
Numri i pajtimtareve qe perdorin akses ne internet me GPRS/EDGE	1,205,040	1,380,584	713,559	1,426,696	1,187,793	**-17%**
Numri pajtimtareve me akses ne Internet broadband UMTS/LTE ne total:	283,249	649,713	1,231,259	1,576,877	2,049,072	**30%**
- nepermjet aparatit te telefonit celular	248,756	594,308	1,119,892	1,378,820	1,900,592	**38%**
- nepermjet USB modem (jo aparate celulare)	34,493	55,405	111,367	198,057	148,480	**-25%**
Thirrje telefonike dalesete gjeneruara nga perdoruesit (minuta)	4,874,847,563	6,053,089,264	6,769,300,966	7,301,024,035	7,381,147,348	**1%**
Numri mesazheve SMS te gjeneruara	713,946,022	1,382,610,330	1,689,200,882	1,826,346,190	1,598,702,865	**-12%**
Volumi total i te dhenave te transmetuara me GPRS/UMTS/LTE (Gbyte)	340,107	796,000	2,529,549	6,269,940	12,740,073	**103%**
Thirrje hyrese nga rrjete te tjera (Terminim thirrjesh)- minuta	977,313,997	1,046,035,623	990,247,214	1,061,412,059	1,808,593,748	**70%**
-thirrje hyrese kombetare (fiks dhe celulare te tjere)	265,191,371	290,628,294	335,122,643	596,861,301	1,388,340,601	**133%**
-thirrje hyrese nderkombetare	712,120,660	755,407,329	655,124,571	464,550,758	420,253,147	**-10%**

[17] Ecuria e treguesve kryesore të tregut celular paraqitet më e detajuar në Kapitullin ___të këtij dokumenti.

Nga të dhënat e tabelës vihet re se në periudhën 2011-2015 ka rritje të ndjeshme të përdorimit të shërbimeve të aksesit broabdand si në numër përdoruesish të këtyre shërbimeve dhe në volumin e të dhënave. Ndërkohë përdorimi i shërbimeve tradicionale të rrjeteve celulare ka tendencë rënëse ose rritje shumë më të vogël se ato të akesit broadband. Në vitin 2015 vihet re një rritje e ndjeshme e trafikut hyrës kombëtar në rrjetet celulare (efekti i masës rregulluese të mos-diskriminimit në thirrjet on-net/off-net) dhe përdorimit të shërbimeve të aksesit broadband (efekti i fillimit të ofrimit të shërbimeve 4G).

Ne vijim AKEP ka bere nje analize me te detajuar te zhvillimeve te tregut celular me pakice ne Shqiperi duke krahasuar me zhvillimet nderkombetare si dhe pritshmerite per zhvillimin e ketij tregu ne te ardhmen e afert.

Perkufizimi i tregut perkates

Bazuar ne perfundimet e analizave te meparshme te tregut celular te kryera nga AKEP si dhe ne perfundimet e arritura ne analiza/vleresime te autoriteteve te ndryshme rregullatore dhe te konkurrences, perfshire KE, tregu me pakice celular konsiderohet te perfshije te gjitha sherbimet celulare, per perdorues me parapagim dhe me paspagim, si dhe dimensioni gjeografik eshte kombetar. Per sa i perket perfundimeve te AKEP ne Analizen e tregut fiks 2015 ne lidhje me efektin zevendesues te sherbimeve te telefonise fikse me ato celulare, vlen te theksohet se ky efekt eshte i njeanshem, dhe se sherbimet e telefonise fikse apo rrjeteve fikse nuk konsiderohen si zevendesues te sherbimeve te ofruara nga rrjete celulare. Bazur ne kete perfundim analiza e tregut celular me pakice perfshin si sherbimet tradicionale te telefonise dhe mesazheve SMS dhe ato te aksesit broadband ne Internet nga rrjete celulare. Gjithsesi analiza fokusohet edhe ne segmente te vecanta te perdoruesve/sherbimeve si ato me paspagim dhe parapagim.

III.2 Perdorimi i Sherbimeve celulare

Ecuria e numrit te përdoruesve celularë

AKEP në publikimet e viteve të fundit ka raportuar numrin e përdoruesve celularë sipas dy mënyrave.

- Numri i përdoruesve sipas kartave 'SIM', i referohet numrit të kartave SIM që janë aktive[18] në rrjet celular në fund të periudhës së raportimit;
- Numri i përdoruesve aktivë, i referohet përdorues të kartave SIM që kanë përdorur shërbime celulare në 3 muajt e fundit;

Në referenca të tjera në këtë dokument, AKEP i referohet kryesisht numrit të përdoruesve celularë sipas "përdoruesve aktive", por ndërkohë në disa raste jepen edhe tregues bazuar në numrin e përdoruesve celularë sipas kartave 'SIM'. Të dhënat për numrin e përdoruesve celularë për karta SIM janë të disponueshme që prej vitit 1996, ndërsa sipas treguesit për përdorues aktivë, që prej vitit 2010.

Numri i përdoruesve celularë aktivë në fund të vitit 2015 arriti në 3.4 milion, krahasuar me 3.36 milionë në fund të vitit 2014, një rritje vjetore kjo e moderuar prej 1.2%. Kjo normë ndryshon sipas operatorëve dhe ka vlera pozitive dhe negative, për Telekom Albania dhe Plus është rënëse me 2.8% dhe 15.8 % dhe për Vodafone dhe Albtelecom është rritëse me 4 % dhe 12.2%.

FIGURA III.1: NUMRI I PËRDORUESVE CELULARË AKTIVË DHE KARTA SIM 2010-2015



	2010		2011		2012		2013		2014		2015	
	Aktivë	SIM	Aktivë	SIM	Aktivë	SIM	Aktivë	SIM	Aktivë	SIM	Aktivë	SIM
Plus	28,162	28,162	182,391	396,722	202,426	302,310	221,086	307,652	261,314	345,350	219,977	401,755
Alb(EM)	602,775	822,356	415,307	1,110,3	435,922	1,423,4	424,237	676,679	431,772	675,901	484,350	777,788
Vodafone	1,129,7	1,674,7	1,358,8	1,809,2	1,491,1	2,019,6	1,659,6	2,239,6	1,549,4	1,966,1	1,611,0	2,013,4
AMC	1,396,7	2,022,5	1,152,5	1,920,0	1,407,8	1,874,2	1,380,9	2,058,4	1,117,0	1,894,3	1,085,5	1,543,1

Në fund të vitit 2015, numri i përdoruesve të telefonisë së lëvizshme sipas kartave SIM, arriti në 4.74 milion krahasuar me 4.88 milion në fund të vitit 2014. Ndryshimi përbën një rënie vjetore prej 3%, dhe ai varion sipas operatorëve: Telekom Albania ka pësuar rënie me 18.5%, Vodafone, Albtelecom dhe Plus kanë rritje me 2.4, 15.1 dhe 16.3 %. Në vitin 2013 Albtelecom(EM) pati një reduktim të madh të këtij treguesi, për shkak të ndryshimit të mënyrës së raportimit të numrit të

[18]Secili operator ka politikat e veta se kur një kartë SIM (me parapagim) është aktive (që mund të kryejëkomunikim) në varësi të kohës së rimbushjes apo përdorimit të fundit të saj.

kartave SIM nga vetë Albtelecom[19]. Figura III.2 paraqet ecurinë e numrit të përdoruesve celularë sipas kartave SIM në periudhën 2000-2015, Figura III.3, paraqet numrin e përdoruesve aktive në përiudhën 2010-2015. Proporcioni i përdoruesve aktive ndaj kartave SIM aktive është në nivel 72% për të katër operatorët së bashku, duke variuar nga 55% për Plus në 80% për Vodafone. Ndryshimin më të madh të këtij proporcioni e ka Plus, nga 76% në fund të 2014 në 55% në fund të 2015 dhe Telekom Albania, por me krah të kundert, nga 59% në fund të vitit 2014 në 70% në fund të vitit 2015. Në lidhje me këtë tregues dy operatorët e tjere kanë pasur levizje te moderuara me nga 1 dhe 2 pikë përqindje ndryshim.

FIGURA III.2. NUMRI I PËRDORUESVE CELULARË SIPAS KARTAVE SIM 2000-2015



FIGURA III.3: NUMRI I PËRDORUESVE CELULARË AKTIVE 2010-2015



[19] EM deri në fund të vitit 2012 ka raportuar për këtë tregues vlerën kumulative te kartave SIM të shitura që prej fillimit të aktivitetit të tij deri në fund të periudhës përkatëse, ndërsa duke filluar nga gjashtëmujori i parë 2013, EM ka rivlerësuar numrin e pajtimtarëve duke i'u referuarvetëm kartave SIM aktive në fund të periudhës përkatëse.

Treguesit me te fundit te Tremujorit te III 2016, tregojne se numri i perdorusve celulare ka pasur rritje me 8% te perdorusve active dhe me 5.4% sipas kartave SIM ne krahasim me Tremujorin III 2015. Serite kohore tremujore evdentojne rritje me te madhe ne Tremujorin e III-te qe perkon me pikun te vizitoreve (turiste dhe emigrante) ne Shqiperi.

FIGURA III.4: NUMRI I PËRDORUESVE CELULARË AKTIVE TIV_2014-TIII_2016



	QIV_2014	QI_2015	QII_2015	QIII_2015	QIV_2015	QI_2016	QII_2016	QIII_2016
Plus	261,314	265,946	269,618	276,139	219,977	175,004	165,531	160,895
Albtelecom	431,772	452,792	481,345	513,627	484,350	465,326	448,479	494,001
Vodafone	1,549,498	1,501,585	1,558,945	1,696,767	1,611,086	1,618,087	1,675,744	1,933,605
Telekom	1,117,070	967,807	1,001,242	1,104,840	1,085,542	1,055,073	1,089,623	1,288,820
Total	3,359,654	3,188,130	3,311,150	3,591,373	3,400,955	3,313,490	3,379,377	3,877,321

Penetrimi i sherbimeve celulare

Norma e penetrimit (përdorues për 100 banorë) në 2015 ishte rreth 120% sipas përdoruesve aktivë dhe 167% sipas kartave SIM. N.q.s i referohemi përkufizimit te KE[20], penetrimi për vitin 2015 rezulton të jëtë 172%, një vlerë kjo më e lartë se mesatarja e EU28 në vitin 2014.

FIGURA III.5: NORMA E PENETRIMIT TE SHERBIMEVE CELULARE SHQIPERI 2015 V BE 2014



Burimi:KE- Digital Agenda, dhe AKEP

[20] http://digital-agenda-data.eu (Definition: Number of active SIM cards divided by population. It includes both voice and data services, installed in telephones, modem, usb keys or other devices)

Struktura e perdoruesve

Tabela e mëposhtëme paraqet peshën që zënë përdoruesit me kontratë në numrin total të përdoruesve, aktivë dhe sipas kartave SIM. Sikurse mund të vihet re përdoruesit me kontratë përbëjnë 5% të numrit total të përdoruesve aktivë celularë dhe 7 % të numrit të përdoruesve sipas kartave SIM. Midis operatorëve ka diferenca të mëdha. Vodafone dhe Telekom Albania me numrin më të madh të përdoruesve celularë, kanë vetëm 4-5% përdorues me kontratë dhe 95-96% me parapagim. Dy operatorët më të vegjël kanë pasur një proporcion më të madh të përdoruesve me kontratë në vitin 2013, p.sh. Plus për përdoruesit aktivë ka 44% me kontratë dhe 56% me parapagim, ndërsa në 2015 kjo diferencë është thelluar, duke shkuar në raportin 10 % me kontratë dhe 90% me parapagim. Për vitin 2015 kjo strukture ka pasur tendenca të dukshme e orientuar drejt segmentit me parapagim për të katërt operatoret, nisur kjo nga ndryshimet që kanë pësuar Telekom Albania, Albtelecom dhe Plus, ne harkun kohor 2013-2015.

TABELA III.3: STRUKTURA E PËRDORUESVE CELULARË KONTRATË/PARAPAGIM (2015)

	Telekom Albania	Vodafone	Albtelecom	Plus	Total
	Kontratë/parapagim	Kontratë/parapagim	Kontratë/parapagim	Kontratë/parapagim	Kontratë/parapagim
Përdorues Aktiv	5% / 95%	5% / 95%	15% / 85%	10% / 90%	7% / 93%
SIM	4 %/ 96%	4% / 96%	9 % / 91%	5% / 95%	5% / 95%

Burimi: Perllogaritje te stafit te AKEP bazuar ne te dhenat periodike te raportuara nga operatoret

Figura e meposhtme parqet ecurine e stukturës se perdoruesve celulare sipas menyres se pagimit per sherbimet, me parapagim dhe me pas-pagim) në periudhen 2010-2015 dhe tremujorin e trete 2016. Nga figura mund te vihet re se proporcioni me i madhe i perdoruesve jane me parapagim. Pas nje reduktimi te ketij proporcioni ne vitet 2011-2012, ne dy vitet e fundit ky raport eshte rritur perseri duke arritur ne 93% ne vitin 2015 dhe 95% ne Tremujorin III 2016. Nga krahasimi i te dhenave per raportin e perdoruesve me paspagim/parapagim per vitet 2013 dhe 2015 vihet re se:

- Plus ka ndryshimin me te madh te ketij raporti nga 44%/56% ne 10%/90%;
- Telekom Albania nga 13%/87 % shkoi në 5%/95 %
- Albtelecom nga 24%/76% shkoi në 15 / 85%.
- Vodafone ka ndryshim te vogel vetem me 2 pike perqindje.

FIGURA III.6: STRUKTURA E PËRDORUESVE AKTIVË 2010-2016_QIII



Burimi: Perllogaritje te stafit te AKEP bazuar ne te dhenat periodike te raportuara nga operatoret

Ndryshimi i strukturës së përdoruesve celularë vlersohet të ketë ardhur nga politikat tarifore të operatorëve celularë. Prezenca e ofertave tarifore shumë atraktive për përdoruesit me parapagim si dhe eliminimi i grupeve të mbyllura për përdoruesit me kontratë kanë ndikuar në reduktimin e peshës së përdoruesve me paspagim.

Sherbime te reja (3G/4G)

Shërbimet e aksesit broadband nga rrjete celulare jane sherbime relativisht te reja ne Shqiperi. Keto sherbime filluan te ofrohen ne standardin 3G ne vitin 2011, pas pajisjes se Vodafone (Dhjetor 2010) dhe Telekom Albania (Shtator 2011) me autorizime individuale per brezat 1900/2100 MHz. Albtelecom (EM) u pajis me autorizim individual per brezin 1900/2100 MHz ne Dhjetor 2012, ndersa Plus Communication ne vitin 2016. Sherbimet ne standardin 4G filluan te ofrohen ne Tremujorin III 2015, pas heqjes se kufizimeve te perdorimit te frekuencave per operatoret celulare dhe dhenies se autorizimeve ne brezin 2500/2600 MHz.

Numri i pajtimtarëve [21]me akses broadband celular në fund të vitit 2015 arriti në rreth 2 milion nga 1.5 milion në fund të 2014, që përbën rritje të konsiderueshme të numrit apo rritje me 30%. Ashtu si edhe në matjen e përdoruesve të zërit edhe për broadband, AKEP i mat në dy mënyra: 1) Përdorues që kanë përdorur aksesin broadband në Internet gjatë një viti; 2)Përdorues aktivë, që kanë përdorur aksesin broadband tre muajt e fundit.

Numri i përdoruesve aktivë (përdorim 3 muajt e fundit) të shërbimeve me akses broadband nga rrjetet celulare (3G/4G nga aparateve celulare dhe me karta USB/modem) në vitin 2015 ishte rreth 1.3 milion apo 43% më shumë se në vitin 2014. Përdorimi i aksesit broadband nga rrjetet 3G/4G është rritur me 49% për aksesin nëpërmjet aparateve celulare dhe me vetëm 1% nëpërmjet aparatve të tjerë me USB/Modem. Penetrimi per popullsi i perdoruesve aktive

[21]Numri i pajtimtareve (aktive ose jo) qe kane perdorur aksesin broadband(3G/4G) ne Internet te pakten nje here gjate vitit.

celulare te aksesit broandband nga rrjetet 3G dhe 4G arriti në 46% ne fundvitin 2015 krahasuar me 35% në fundvitin 2014. Të katërt operatorët me rrjete 3G/4G kanë pasur rritje të numrit të përdoruesve aktive të shërbimeve akses broadband nëpërmjet aparatave celulare. Vodafone dhe Albtelecom kanë pasur reduktim të numrit të përdoruesve me karta USB/modem, ndërsa Telekom Albania ka pasur rritje të këtij treguesi.

TABELA IV.3: NUMRI I PAJTIMTARËVE ME AKSES BROADBAND 3G/4G

	Telekom Albania		Vodafone		Albtelecom(EM)		Plus	Total	
	Aparat celular	USB/ Modem	Aparat celular	USB/ Modem	Aparat celular	USB/ Modem	Aparat celular+ USB/Modem	Aparat celular	USB/ Modem
2011	46,000	9,000	202,756	25,493				248,756	34,493
2012	222,882	17,833	371,426	37,572				594,308	55,405
2013	279,428	32,138	568,207	66,086	272,257	13,143		1,119,892	111,367
2014	163,797	61,549	503,855	46,341	119,998	12,435		787,650	120,325
2015	278,886	97,087	686,805	20,075	209,650	4,778		1,175,341	121,940
2016_QIII	351,456	102,902	1,025,687	19,067	261,628	2,517	69,974	1,708,745	124,486
Ndryshimi 2015/2014	70%	58%	36%	-57%	75%	-62%		49%	1%

Të dhenat periodike sipas tremujorëve tregojnë se ne Tremujorin III 2015 pati nje rritje te ndjeshme te përdoruesve të aksesit broadband në rrjete celulare qe perkon me fillimin ofrimit te shërbimeve me rrjete 4G. Megjathate edhe Tremujori III 2016 paraqet nje rritje te ndjeshme krahasuar me periudhat e meparshme, duke evidentuar efektin sezonal te ketij tremujori qe perkon me sezonin turistik dhe kthimin e perkohshem te emigranteve ne Shqiperi.

FIGURA III.7 NUMRI I PËRDORUESVE AKTIVE TË AKSESIT BROADBAND NGA RRJETE CELULARE



Rritja e përdorimit të aksesit broadband nga rrjetet celulare 3G/4G në vitet e fundit vihet re sidomos në rritjen e volumit të të dhënave të transmetuara në rrjetet celulare. Ne vitin 2014 rritja vjetore e trafikut të të dhënave në rrjetet celulare ishte 148%, dhe kjo tendencë vazhdoi edhe në vitin 2015 ku rritja vjetore ishte 103 %.

III.3. Trafiku telefonik dhe struktura e thirrjeve

Trafiku i gjeneruar nga rrjetet celulare gjatë vitit 2015 arriti ne rreth 7.4 miliard minuta, e cila perben nje rritje të vogël me rreth 1.5 % në krahasim me vitin 2014. Megjithëse sasia totale e thirrjeve nuk pati ndryshim të madh, struktura e trafikut dales pesoi ndryshime të ndjeshme. Në vitin 2015 thirrjet brenda rrjetit u reduktuan me 16% ndërsa thirrjet drejt rrjeteve të tjera celulare (off-net) u rritën me 2.4 herë në krahasim me vitin 2014. Rritje te ndjeshme patën dhe thirrjet drejt rrjeteve fikse dhe thirrjet nderkombëtare me 37-41%. Këto ndryshime kanë sjellë dhe ndryshim të strukturës së trafikut dalës gjatë vitit 2014 sic mund të vihet re nga grafiku i mëposhtëm.

FIGURA III.8: STRUKTURA E THIRRJEVE DALESE CELULARE SIPAS DESTINACIONIT



Pesha e thirrjeve brenda rrjetit ndaj totalit të thirrjeve dalëse në vitin 2015 u reduktua në 69% krahasuar me 84% në 2014. Pesha e këtyre thirrjeve për Vodafone dhe Telekom Albania në 2015 ishte 75-77% krahasuar me 87-88% në 2014. Edhe tek Albtelecom dhe Plus është venë re reduktim i peshës së këtyre thirrjeve nga 58-67% në 2014 në 40-41% në 2015. Sasia e thirrjeve drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare pati rritjen më të madhe në 2015 dhe pesha e tyre në totalin e thirrjeve dalëse celulare në 2015 arriti në 18% krahasur me 8% në 2014. Thirrjet ndërkombëtare kanë pasur rritje të ndjeshme në 2015 dhe pesha e tyre arriti në 12% krahasuar me 8% në 2014. Sasia e thirrjeve drejt rrjeteve fikse pati rritje të ndjeshme në 2015, por që nuk ka ndikuar në peshën e tyre në totalin e thirrjeve dalëse, e cila vazhdon të jetë 1%.

Figura e mëposhtëme paraqet ecurinë e strukturës së thirrjeve të përdoruesve celularë sipas destinacionit të thirrjeve në baze mujore ne periudhën Janar 2014-Shtator 2016. Nga të dhënat vihet re ndryshimet e mëdha në strukturën e thirrjeve dhe tendencat e rritjes së peshës së thirrjeve off-net (drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare) dhe reduktimin e peshës së thirrjeve brenda rrjetit (on-net). Pesha e thirrjeve off-net është rritur nga 5% në Janar 2014 në 39% në Shtator 2016. Në të njëtën periudhë pesha e thirrjeve on-net është reduktuar nga 90% në Janar 2014 në 58% në Shator 2016.

FIGURE III.9 STRUKTURA E THIRRJEVE CELULARE (JANAR 2014-SHTATOR 2016)



Ndryshimet më të ndjeshme të strukturës së thirrjeve janë vënë re në Korrik 2015 e në vijim, që përkon me afatin e fillimit të aplikimit të detyrimit të mos-diskriminimit në rrjetet e katër operatorëve celularë. Gjatë vitit 2015 është vënë re gjithashtu luahtaje të mëdha të sasisë dhe proporcionit të thirrjeve dalëse ndërkombëtare nga rrjetete celulare. Sasia dhe proporcioni i thirrjeve ndërkombëare është rritur ndjeshëm në gjashtëmujorin e parë 2015 për shkak të ofertave të operatorëve për këta lloj thirrjesh. Megjithatë në muajt Gusht e në vijim operatorët celularë kanë reduktuar ndjeshëm ofertat për thirrjet ndërkombëtare për shkak të rritjes së kostove të terminimit të këtyre thirrjeve në vendet e tjera (rritje e tarifave të terminimit nga operatorët e vendeve të huaja për thirrjet hyrëse ndërkombëtare që vijnë nga vendet jashtë BE).

Të katër operatorët celularë kanë pasur ndryshime të ndjeshme në strukturën e thirrjeve dalëse të përdoruesve të tyre. Raporti i thirrjeve on-net/off-net të operatorit më të madh celular, Vodafone Albania, ka ndryshuar nga 97%v3% në Janar 2014 në 70% v 30% në Shtator 2016. Për Telekom Albania ky raport ka pësuar ndryshime edhe më të mëdha: nga 96%v 4% në Janar 2014 në 59% v 41% në Shtator 2016.

Figura e mëposhtëme paraqet ecurinë e trafikut të thirrjeve brenda rrjetit (on-net) dhe drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare (off-net) në periudhën Janar 2014-Dhjetor 2015. Nga të dhënat mund të vihet re sa sasia e thirrjeve off-net e operatorëve celularë është rritur 5.5 herë gjatë kësaj periudhe: nga rreth 30 milion minuta në muaj në rreth 167 milion minuta në muaj. Në të njëtën periudhe sasia e thirrjeve on-net është reduktuar ndjeshëm me 29%: nga 520 milion minuta në muaj 368 milion minuta në muaj. Nga figura mund të vihet re se ndryshimet më të mëdha të sasive të trafikut on-net dhe off-net janë në periudhën Korrik-Dhjetor 2015: trafiku off-net është rritur me 65%, ndërsa trafiku on-net është reduktuar me 21%.

FIGURA III.10: ECURIA E SASISË SË TRAFIKUT ON-NET DHE OFF-NET JANAR 2014-DHJETOR 2015



Rritja e ndjeshme e sasisë së trafikut off-net dhe reduktimet e tarifave të terminimit kanë cuar dhe në ndryshime të ndjeshme të të ardhurave/pagesave neto midis operatorëve celularë për trafikun e terminuar në rrjetet e tyre, të cilat kanë rritur aftësitë konkurruese të dy operatorëve më të vegjel dhe të rinj në treg, Plus dhe Albtelecom (EM).

III.4 Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve celulare

Në vijim është dhënë një tabelë me të dhëna për përdorimin mesatar mujor për përdorues celularë në 2008-2015, sipas dy treguesve të përdoruesve: përdorues aktiv dhe karta SIM. Përdorimi mesatar mujor për përdorues është llogaritur sipas thirrjeve dalëse (thirrje që gjenerohen nga një përdorues) dhe thirrjeve hyrëse (thirrjet e marra nga një përdorues), të matura në minuta. Si edhe në analizat pararendëse këto tregues kanë të njëtin përkufizim, ndaj për më shumë detaje mund t`i referoheni analizën se 2014 (faqe30).

Gjatë vitit 2015, një përdorues celular aktiv (që ka kryer komunikim në 3 muajt e fundit) ka kryer mesatarisht 182 minuta thirrje dalëse, ka marrë mesatarisht 171 minuta thirrje hyrëse dhe ka dërguar 39 mesazhe SMS në muaj. Këto vlera përdorimi janë më të vogla nëse si numër përdoruesish celular i referohemi numrit të kartave SIM, 128 minuta dalëse, 120 minuta hyrëse dhe 28 SMS në muaj. Sasia e thirrjeve në minuta të gjeneruara (dalëse) mesatarisht gjatë një muaji në vitin 2015 është rritur me 6% në krahasim me 2014 dhe 17 % krahasuar me 2013

referuar një përdoruesi aktiv, ndërsa referuar SIM karta kjo sasi është rritur me 7% ne krahasim me 2014 dhe 24% në krahasim me 2013. Përdorimi i mesazheve SMS ka pasur reduktim me 7-9% për përdoruesit e kartave SIM dhe përdoruesit aktive celulare ne krahasim me 2014 dhe po të marrim si baze referimi 2013 ka pasur ndryshim 0-8%.

TABELA III.4: PËRDORIMI MESATAR I SHËRBIMEVE CELULARE 2008-2013[22]

	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Ndryshimi 2015/2013
Përdorues Aktiv									
Thirrje dalëse në muaj	N/A	N/A	N/A	130	152	156	173	182	17%
Thirrje të marra (hyrëse) në muaj	N/A	N/A	N/A	147	168	167	168	171	2%
MOU*	N/A	N/A	N/A	**277**	**319**	**324**	**341**	**353**	9%
SMS (dalëse) në muaj	N/A	N/A	N/A	19	35	39	**43**	**39**	0%
Përdorues Karta SIM									
Thirrje dalëse në muaj	26	53	80	83	93	103	**120**	128	24%
Thirrje të marra (hyrëse) në muaj	47	67	91	94	103	111	**117**	120	8%
MOU*	**73**	**120**	**171**	**177**	**195**	**214**	**237**	**248**	**16%**
SMS (dalëse) në muaj	12	14	10	12	21	26	**30**	28	8%
Perdomi mesatar i te dhenave (data) ne muaj				**102**	**146**	**230**	**357**	**541**	135%

Burimi: Perllogaritje te stafit te AKEP bazuar ne te dhenat periodike te raportuara nga operatoret

Siç mund të vihet re nga tabela ne periudhen 2011- 2015 dhe figura mëposhtë u vu re një rritje e përdorimit të shërbimeve të zërit (voice tradicional) kundrejt një ulje të ARPM[23] dhe ARPU. Tregues me tendencë rënëse është përdorimi i SMS, i cili në krahasim më 2014 ka një rënie më 9%, duke zbritur në vlerën e vitit 2013, pasojë kjo e rritjes se përdorimit të aksesit broadband dhe zëvendesimit të përdorimit të SMS tradiocionale me mesazhe të dërguara nga aplikacione OTT si WhatsUp, Viber etj. AKEP gjykon se minutat reale të përdorimit mesatar janë më afër treguesve të matur me përdorues aktivë, pasi një numër i konsiderueshëm pajtimtarësh të kartave SIM janë vetëm përdorues sezonalë apo sporadikë (emigrantë, vizitorët që përdorin karta SIM të operatorëve celularë Shqiptarë gjatë qëndrimit të përkohshëm apo vizitave në Shqipëri).

Rreshti i fundit i tabeles se mesiperme tregon ecurine e perdorimit mesatar te te dhenave ne rrjetet 3G/4G, ku vihet re se ky tregues eshte me rritje te qendrueshme vjetore prej 42-58% ne periudhen 2011-2015. Ne vitin 2015 nje perdorues aksesi ne internet celulare ka perdorur 541

[22] Mund të ekzistojë një mospërputhje e vogël ndërmjet shumës së përbërësve dhe totalit të paraqitur në tabela, për shkak të rrumbullakimeve.

[23] ARPU (Average Revenue Per Users-E Ardhura Mesatare Për Përdorues): E ardhura mesatare për përdorues e matur si raporti i të ardhurave ne retail të operatorëve me numrin mesatar të përdoruesve (aktive) gjatë një viti.

ARPM (Average Revenue Per Minute-E Ardhura Mesatare Për Minutë): Treguesi i ARPM llogaritet nga AKEP ne baze te te dhenave qe dergojne operatoret per te ardhurat dhe thirrjet telefonike. Per shkak te ofertave/shportave qe kane nje pagese fikse dhe perfshijne pervec thirrjeve edhe SMS dhe kapacitet Internet, vlerat e ketij treguesi mund te mos pasqyrojne sakte te ardhuren mesatare retail per nje minute thirrje, megjithate ai eshte nje tregues i perafert dhe mund te konsiderohet vlera maksimale kur si te ardhura perdoren te ardhurat totale retail

MB/muaj, qe perben rritje me 52% ne krahasim me vitin 2014 dhe 135% ne krahasim me vitin 2014.

III.5. Tarifat celulare

Operatoret celulare ofrojne nje sere sherbimesh dhe paketash tarifore dhe shpesh eshte e veshtire krahasimi i tarifave per sherbime te vecanta dhe/ose per njesi per shkak te rritjes se perdorimit te shportave (bundles) me nje sherbime ose me shume sherbime (paketa te integruara). Si edhe ne dokumentat e tjere te AKEP, ecuria e tarifave me pakice te tregut celular analizohet ne dy drejtime kryesore:

- Te ardhura mesatare per minute/perdorues (ARPM/ARPU);
- Tarifat nominale me pakice te operatoreve.

Ne seskionet ne vijim AKEP ka analizuar fillimisht ecurine e treguesve te ARPM dhe ARPU, dhe me pas te tarifave nominale te operatoreve celulare duke u fokusuar ne ndryshimet e kryera nga operatoret celulare ne zbatim te detyrimeve te mos-diskriminimit ne tarifat e thirrjeve on-net dhe off-net, tarifat e sherbimeve te aksesit broadband, krahsime te tarifave te segmenteve te parapagim dhe paspagim dhe tarifat per njesi komunikimi.

ARPM dhe ARPU

Treguesit e ARPU (Average Revenue Per User) dhe ARPM (Average revenue Per Minute) masin të ardhurat mesatare të operatorëve për përdorues dhe për minutë, por qe njekohesisht mund te interpretohen si shpenzime mesatare te perdoruesve celulare, dhe per kete arsye perdoren edhe si tregues agregate te ecurise se tarifave te sherbimeve celuare. Ne prezence te perdorimit te larte te paketave/ofertave dhe shportave te integruara te sherbimeve me sasi te medha sherbimesh te persfhira ne pagesat fikse, per perdorues me parapagim dhe me kontrate, ARPM dhe ARPU jane tregues te mire te tarifave dhe shpenzimeve mesatare efektive qe paguajne realisht perdoruesit celulare.

ARPM[24] apo e ardhura mesatare për minutë matet si raporti i te ardhurave nga sherbimet me pakice me numrin mesatar te perdoruesve gjate periudhes perkatese dhe perdoret si perafrues i cmimit që një përdorues celular paguan mesatarisht për një minutë thirrje telefonike. ARPU e matur si raporti i të ardhurave nga sherbimet me pakice të operatorëve me numrin mesatar të përdoruesve (aktive) gjatë një viti dhe tregon sa lek shpenzon mesatarisht një përdorues celular për shërbime celulare në vit apo në muaj. Vlerat e këtyre treguesve për periudhën 2010-2015 janë dhënë në tabelën e mëposhtëme.

[24] Treguesi i ARPM llogaritet nga AKEP ne baze te te dhenave qe dergojne operatoret per te ardhurat dhe thirrjet telefonike. Per shkak te ofertave/shportave qe kane nje pagese fikse dhe perfshijne pervec thirrjeve edhe SMS dhe kapacitet Internet, vlerat e ketij treguesi mund te mos pasqyrojne sakte te ardhuren mesatare retail per nje minute thirrje, megjithate ai eshte nje tregues i perafert dhe mund te konsiderohet vlera maksimale kur si te ardhura perdoren te ardhurat totale retail.

TABELA III.5: ECURIA E ARPM DHE ARPU 2010-2015

	ARPM (Lek/minute)	ARPU (Lek/vit)	ARPM Ndryshimi vjetor (%)	ARPU Ndryshimi Vjetor (%)
2010	6.49	8,594		
2011	5.35	8,319	-18%	-3%
2012	3.92	7,132	-27%	-14%
2013	3.13	5,863	-20%	-18%
2014	2.63	5,447	-16%	-7%
2015	2.36	5,125	-10%	-6%

Shënim: Vlerat pa TVSH

Nga tabela vihet re se ARPM dhe ARPU kanë tendencë rënëse dhe për vitin 2015 vlerat e tyre janë reduktuar me 10% dhe 6% respektivisht. Në vitin 2015 një përdorues celular ka paguar mesatarisht 2.83 lek/minutë (me TVSH) për thirrjet telefonike dhe ka shpenzuar mesatarisht 513 lek/muaj (me TVSH) për shërbime celulare.

Niveli i këtyre treguesve në Shqipëri është shumë më i ulët se niveli mesatar në vendet e BE dhe ndër më të ulëtit në rajon. ARPU në vitin 2015 në Shqiperi ishte 36.6 euro/vit, që është 23% më e ulët se Letonia me nivelin më të ulët në BE me 46 euro. Niveli mesatar i ARPU në BE në 2014 ishte 162.2 euro apo rreth 4.4 herë më e lartë se ARPU e Shqipërisë në 2015. ARPM për Shqipërine ishte në nivelin rreth 1.9 eurocent në 2014 dhe rreth 1.7 eurocent në 2015. Te dhenat me te fundit per ARPM e vendeve te BE jane te disponueshme per vitin 2011 dhe krahasimi tregon se ARPM ka tendence te ngjahsme me ARPU, dhe raporti i ARPM se Shqiperise me mestaren e BE eshte i ngjashem me ate te ARPU.

FIGURA III.11. ARPU NË VENDET E BE DHE SHQIPËRI (2014/2015)



Burimi: KE, Digital Agenda Scoreboard dhe AKEP

Figura e meposhteme paraqet ecurine e ARPU (lek/muaj pa TVSH) si dhe te perdorimit mesatar te thirrjeve dalese (minuta/muaj) ne periudhen 2011-2015. Figura tregon per nje renie te qendrueshme te shpenzimeve mesatare (ARPU) te perdoruesve celulare si dhe nje rritje te qendrueshme te minutave mesatare te perdorimit te sherbimeve te telefonise celulare.

FIGURE III.12 ECURIA E ARPU DHE THIRRJE PER PERDORUES



	2011	2012	2013	2014	2015
ARPU	693	594	489	454	427
Thirrje dalese	130	152	156	173	182

Tendencat renese te shpenzimeve mesatare te perdoruesve celulare te shoqeruara me rritje te perdorimit mesatar te sherbimeve celulare, thirrje telefonike dhe perdorim te dhenash (data), tregojne per rritje te perfitimeve te perdoruesve celulare nga konsumi i sherbimeve tradicionale dhe te reja te rrjeteve celulare.

Tarifat e thirrjeve on-net/off-net

Implementimi i masave rregullatore te percaktuara nga AKEP ne Vendimet e Nentor 2014/Mars 2015 si dhe ne udhezimet perkatese te Qershor 2015për mos diskriminim të tarifave on-net/off-net u krye në dy faza:

- Faze e pare, u aplikua për programet tarifore/ofertat/opsionet për përdoruesit me parapagim dhe përdoruesit e rinj me kontratë, përfshirë rinovimet e kontratave ekzistuese që u kryen pas datës 1 Korrik 2015;
- Faza e dyte filloi me 1.01.2016, duke u aplikuar per përdoruesit me kontrata specifike/te personalizuara apo kontrata qe kishin afat maturimi pertej dates 1.01.2016.

Nga monitorimi i vazhdueshem i publikimit te tarifave ne faqet e internetit te operatoreve sipas masave rregulluese dhe rregullores mbi publikimin e informacionit për tarifat e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike rezulton se:

- Programet tarifore/ofertat/opsionet e kater operatoreve celulare treg nga te kater operatoret me detyrimin e mos-diskriminimit midis tarifave te thirrjeve off-net dhe on-net;
- Ne faqet e tyre te internetit u publikuan programet tarifore, ofertat, opsionet etj., për përdoruesit me parapagim dhe përdoruesit me kontratë, sipas detyrimit te siperpermendur;
- Te gjitha produktet qe nuk plotesonin detyrimin duke filluar nga data 01.07.2015 u hoqën nga tregu.

Nepermjet ketij detyrimi u thjeshtua informacioni per pajtimtaret ne lidhje me permbajtjen e programeve/ofertave/opsioneve dhe mundesia per te krahasuar keto te fundit midis operatoreve dhe midis njera-tjetres. U ul numri i ofertave sezonale, i cili në Qershor 2014 shkontë në 13-20 për operator, duke kaluar në paketa standarte. Njesitë e komunikimit te perfshira ne pagesa fikse u konvertuan nga minuta brenda rrjetit, në minuta kombetare ose ne sasi te barabarta mintash brenda dhe jashte rrjetit celular, duke mos prekur interesin e konsumatorit madje duke rritur perfitimet e tyre.

Më poshtë janë dhënë disa shembuj të ndryshimeve të kryera për zbatimin e detyrimeve të mos-diskriminimit në tarifat on-net/off-net në planet tarifore të operatorit më të madh celular Vodafone Albania, që ishte dhe objekt i hetimit të thelluar nga Autoriteti i Konkurrencës në periudhën 2012-2014.

TABELA III.6. NDRYSHIMET NË TARIFAT E THIRRJEVE ME PARAPAGIM (VODAFONE CLUB)

	2014	2015	Ndryshimi 2015/2014
Thirrje drejt Vodafone Club	39	N/A	
Drejt Vodafone	54	39	-28%
Drejt rrjeteve te tjera celulare	39	29	-26%
Drejt rrjeteve Fiks	39	29	-26%

Tarifat në Lekë/minutë me TVSH

Siç mund të vihet re tarifat e thirrjeve off-net te Vodafone per programin tarifor te cituar janë reduktuar me 26% në vitin 2015. Vodafone tashmë aplikon vetëm një plan tarifor standard me parapagesë, Vodafone Club, dhe ka hequr planet e tjera tarifore standarde me parapagesë. Gjithashtu ofertat e përkohshme (ose me afat të pacaktuar) për përdoruesit me parapagim janë ndryshuar në paketa standarde për këtë kategori përdoruesish, si në shembujt e dhene ne tabelat ne vijim per ofertat/paketat ditore, javore, etj.

TABELA III.7: SHEMBUJ TE NDRYSHIMEVE TE OFERTAVE MUJORE TE VODAFONE (2014-2016)[25]

	Club Mix		Club Superiore		Club Extra	
Përmbajtja e Paketes	**2014**	**2015/2016**	**2014**	**2015/2016**	**2014**	**2015/2016**
	Oferte	*Pakete Standarde*	*Oferte*	*Pakete Standarde*	*Oferte*	*Pakete Standarde*
Afati i vlefshmerise (dite)	*30*	*30/28*	*30*	*30/28*	*30*	*30/28*
Cmimi (leke)	1000	1000	*1,200*	*1,200*	*1,600*	*1,600*
Minuta on net	3000 (MB/SMS on net/minuta Vodafone Club)	3000 (MB/SMS on net/Minuta Kombetare)	*800*	*2000*	*6000 Minuta/SMS On-net*	*2500*

[25] Per lehtesi krahasimi ne tabelenuk jane perfshire SMS-te (kombetare/nderkombetare)

Minuta off net	0		*0*		*0*	
Minuta kombetare*	40	30	*400*		*200*	
Minuta Nderkombetare		0		*300/20*		*440/60*
Volumi Internet (MB)	3000 (MB/SMS on net/minuta Vodafone Club)	3000 (MB/SMS on net/Kombetare)	*2048*	*Pa limit** (2048)*	*3072*	*Pa limit** (3072)*

*Minuta kombetare perfshijne minuta brenda on-net, off-net dhe drejt rrjeteve fikse kombetare.
** Pas konsumit prej 2 ose 3GB perdoruesi vazhdon të kete internet pa limit, por me shpejtësi të reduktuar deri në **256 kbps**.

TABELA III.8. SHEMBUJ TE NDRYSHIMEVE TE OFERTAVE TE VODAFONE (2014-2016)[26]

	2014	2015/2016	2014	2015/2016
Emërtimi	Ofertë Ditore	Paketë Ditore Standarde	Oferta Javore 1/2	Paketë kombinuar Interneti/Club Javore Standarde
Çmimi (lekë)	70	70	300	300
Minuta on net	600	100	100/1200	300
Minuta Kombëtare	15		10/0	
SMS on-net	600	100	100/600	3000
SMS kombetare			0	30
Internet	100	100	1024/100	1024/300

Tabela e meposhteme paraqet shembuj te ndryshimeve te kryera në dy programe tarifore me kontratë nga Vodafone, ku vihet re se janë hequr minutat pa limit brenda rrjetit dhe janë zëvendësuar me mijëra minuta kombëtare (on-net, off-net dhe drejt fiks).

TABELA III.9. NDRYSHIME NË PLANE TARIFORE ME KONTRATË VODAFONE ALBANIA

	Vodafone RED 1		**Vodafone RED 2**	
	2014	2015	2014	2015
Pajtimi Mujor	4,800	4800	7,800	7800
Minuta on net	pa limit	4000	pa limit	6000
Minuta Kombëtare	250	Minuta	500	Minuta
Minuta Ndërkombëtare*	Opsionale	200	Opsionale	300
Tarifa e Thirrjeve drejt rrjeteve celulare	33.62	18.00	33.62	18.00
SMS on net	Pa limit	Pa limit	Pa limit	Pa limit
SMS kombetare	300	300	500	500
Internet	1 GB	Pa limit*	1.5 GB	Pa limit*

[26] Per lehtesi krahasimi ne tabelenuk jane perfshire SMS-te (kombetare/nderkombetare)

Tabelat e mësipërme paraqesin një pjesë të ndryshimeve të kryera nga Vodafone Albania, ndërkohë që ndryshime të tilla janë kryer për të gjitha planet tarifore të tjera ketij operatori si dhe nga të tre operatorët e tjerë celularë per programet perkatese tarifore.

Transparenca dhe lehtesia e krahasimit

Nje nder problemet e evidentuara ne analizen e tregut 2014 ishte numri i madh i ofertave nga secili operator, te cilat conin ne konfuzion dhe veshtiresi ne krahasimin e tyre nga perdoruesit, si dhe ne kosto shtese te paparashikuara nga konsumi i thirrjeve off-net, jo te perfshira ne pageat fikse. Ndryshimet e kryera nga operatoret celulare ne zbatim te detyrimeve te mos-diskriminimit te tarifave te thirrjeve on-net/off-net, pervec eliminimit te diskriminimit ne keto tarifa kane cuar ne renie te ndjeshme te numrit te ofertave/paketave per secilin operator (krahasuar me numrin teper te larte para dy viteve), duke cuar ne rritje te transparences dhe lehtesise se krahasimit te paketave te ndryshme tarifore nga ana e perdoruesve celulare. Tendenca e konsumit e drejt paketave bundle me sherbime te integruara thirrje telefonike kombetare, SMS dhe akses ne Internet e shoqeruar me ndryshimet e cituara ka cuar ne krahasim me te lehte te paketave te nje operatori dhe ato midis operatorev te ndryshem dhe kontroll me te lehte te shpenzimeve nga perdoruesit celulare. Tendenca e operatoreve celulare ne ofrimin e paketave per perdoruesit me parapagim eshte ofrimi i tyre ne baze konsumi 1 ditor, javor dhe mujor (30 ditor) ose 4 javor/28 ditore, duke perfshire ne shumicen e pervec thirrjeve telefonike dhe SMS edhe akses ne Internet. Tabelat e meposhteme paraqesin disa nga paketat tarifore standard te operatoreve per konsum ditor dhe 28/30 ditor te cilat jane lehtesisht te krahasueshme ne baze te cmimit dhe njesive te konsumit te perfshira ne paketa.

TABELA III.10. PAKETA STANDARTE DITORE

	Albtelecom	Telekom Albania	Vodafone
	Paketa Ditore	Paketa Ditore	Club Ditore
Ditë - përdorimi	*1*	*1*	*1*
Cmimi (leke)	*100*	*70*	*70*
Minuta drejt rrjetit fiks kombetar	*100*	-	-
Minuta kombetare	*100*	*100*	*100*
SMS brenda rrjetit	-	*100*	*100*
SMS kombëtare	*100*	-	-
Volumi Internet	*250 MB*	*100 MB*	*100 MB*
Koha fillestare + menyra e tarifimit	*60"+60"*	*60"+60"*	*60"+60"*

TABELA III.11. PAKETA STANDARTE 28/30 DITORE 800 LEKE

	Albtelecom		Plus	Telekom Albania	Vodafone
	Kupid	Mujore 800	Plus 800	Vitamina	Club Xtreme
Ditë - përdorimi	*28*	*28*	*30*	*28*	*28*

Cmimi (leke)	*800*	*800*	*800*	*790*	*800*
Minuta on-net	-	*300*	-	*150*	-
Minuta off-net	-	*300*	-	*150*	-
Minuta drejt rrjetit fiks	*1000*	*1000*	-	-	-
Minuta kombetare	*200*	-	*500*	-	*200*
Minuta nderkombetare	-	-	*20*	-	-
SMS on-net	-	-	*600*	-	-
SMS kombëtare	*400*	*200*	*200*	*150*	*200*
Volumi Internet	*4 GB*	*1 GB*	*3 GB*	*3 GB*	*3 GB*
Koha fill. + menyra e tarif.	*60"+60"*	*60"+60"*	*60"+60"*	*60"+60"*	*60"+60"*

Tabela te tilla krahasimore jane te publikuara ne faqen web te AKEP, ku publikohet periodikisht informacion krahasues per tarifat e operatoreve celulare, dhe sic eshte theksuar me siper, tashme eshte shume me e lehte krahasimi i tarifave midis operatoreve. Nje zhvillim tjeter pozitiv eshte mundesimi nga Telekom Albania i krahasimit on-line te tarifave te paketave me parapagim qe ky operator ofron ne treg. Telekom Albania ne faqen e vet web ofron krahasimin e paketave te ndryshme tarifore me parapagim sipas kritereve te ndryshme si cmimi apo paketat me te shitura, duke mundesuar dhe nje renditje te paketave sipas shpenzimeve te zgjedhura nga perdoruesi.

FIGURA III.13. INSTRUMENT KRAHASIMI ON-LINE I TARIFAVE TE TELEKOM ALBANIA



Burimi: Faqja web e Telekom Albania.

Ndryshimet e ndodhura ne keto vite perfshijne ndryshimin nga Albtelecom, TA dhe Vodafone ne Mars 2016 te afatit te perdorimit te ofertave mujore nga 30 dite ne 28 dite. Operatoret kane zbatuar detyrimet e transparences dhe publikimit te tarifave per kete ndryshim. Ndryshimi i afatit rezulton te jete bere per shkaqe kompatibiliteti te afateve (ditore, javore dhe 4 javore) si dhe eshte ne vijim te praktikve te përdorura edhe nga operatore clulare ne vende te tjera europiane. AKEP pas sqarimeve te operatoreve ka bërë kërkime në website-et e disa operatorëve në vendet të tjera, nga ku rezulton se ata ofrojnë paketa/oferta 4 javëshe për përdoruesit e tyre në tregun me pakicë, me parapagim si dhe me kontrate.

Tarifat per sherbimet e aksesit broadband

Konsolidimi i rrjeteve 3G dhe fillimi i ofrimit te sherbimeve ne rrjetet celulare 4G ka cuar ne rritje te ndjeshme te perdorimit te aksesit ne Internet nga rrjete celulare ne Shqiperi. Ofrimi i aksesit ne Internet ne rrjet celulare mund te perfitohet nepermjet paketave te perbashketa me sherbimet standarde telefonike ose nepermjet paketave te vecanta per te dhena. Programet tarifore te kater operatoreve celulare tregojne se shumica e paketave jane te integruara: telefoni/SMS dhe akses ne Internet 3G/4G. Keto paketa jane te shumellojshme dhe mund te blihen nga perdoruesit me parapagim per konsum ditor, javor apo 4-javor/Mujor.

Tarifat e ketyre paketave variojne sipas afatit te vlefshmerise dhe njesive te komunikimit dhe/ose aksesit ne Internet te perfshira ne pagesen fikse. AKEP ne seksionet e meparshme te ketij dokukmenti ka dhene shembuj te paketave tarifore te ndryshme te operatoreve celulare ku mund te vihet re se aksesi ne Internet tashme eshte nje sherbim plotesisht i integruar ne te gjitha paketat tarifore te operatoreve celulare, pervec opsioneve ku ofrohen vetem minuta thirrje/SMS.

AKEP ne dokumentin e "Statusi i Sherbimit Universal te komunikemeve elektronike" te nxjerre ne keshillim publik ne Tetor 2016, nder te tjera ka analizuar nivelin dhe perballueshmerine e tarifave te askesit broadband ne rrjete celulare, dhe perfundimet kryesore te dokumentit te cituar jane:

- perdoruesit me parapagim celular mund te perfitojne aksesin ne Internet celular se bashku me sherbime telefonike duke filluar nga 500 lek/muaj (400 minuta dhe 1 GB) si dhe kane opsione per paketa vetem me akses ne Internet duke filluar nga 400 lek/muaj per 2GB.
- Duke marre ne konsiderate tarifat aktuale te shportave te integruara (telefoni/SMS dhe Internet) ne rrjetet celulare per perdoruesit me parapagim rezulton se me 800-1000 lek/muaj (me TVSH) nje perdorues mund te perfitoje rreth 2000 minuta kombetare, qindra SMS dhe 1-2 GB Internet 3G/4G. Ky nivel konsumi është shumë më i lartë se konsumi i referuar nga ITU si benchmark për krahasimin midis vendeve për përballueshmërinë e tarifave. Ne terma të përballueshmerisë **shpenzimi 800-1000 lek/muaj për akses në telefoni dhe Internet celular** **është 1.75-2.15% e GNI për fryme të Shqipërisë ne 2014 (4505 USD). Për nivelin mesatar të të ardhurave, ky nivel shpenzimesh (per konsumin e cituar) vlerësohet te jete i perballueshem.**

Tarifat me Parapagim v Kontrate (paspagim)

AKEP ne analizen e tregut 2014 evidentoi nder te tjera nje problematike te struktures se tarifave te perdoruesve me parapagim dhe me pas-pagim (kontrate). Normalisht tarifat e sherbimeve per perdoruesit me parapagim jane më të larta se tarifat e programeve me kontratë, pasi keta te fundit jane perdorues me te medhenj dhe nepermjet pagesave fikse mujore perfitojne tarifa per njesi komunikimi me te lira se perdoruesit me parapagim. Megjithate orientimi i përdoruesve me parapagim nga operatoret celulare drejt konsumit te sherbimeve nepermjet ofertave dhe shportave te konsumit (pagese fikse me perfshirje minutash, SMS, MB etj) ne vend te perdorimit te tarifave standarde per njesi komunikimi, ka rezultuar edhe ne keto dy vite ne tarifa me te lira per perdoruesit me parapagim se ata me kontrate, duke cuar edhe ne rritje te proporcionit te perdoruesve me parapagim ne totalin e perdoruesve celulare. Me poshte jepen disa shembuj te ofertave/paketave tarifore te dy operatoreve me te medhenj ne treg per perdoruesit me parapagim dhe ata me kontrate.

TABELA III.12. TARIFA ME PARAPAGIM V KONTRATE VODAFONE

	Me parapagesë		Me kontratë	
	Club Superiore	**Club Extra**	**Mini Red**	**VF Red**
Pajtimi mujor	*1,200*	*1,600*	*2,400*	*4,800*
Minuta kombetare	*2000*	*2500*	*2000*	*4000*
Minuta ndërkombëtare	*20*	*60*	*100*	*200*
SMS on-net	*2000*		*pa limit*	*pa limit*
SMS kombetare	*300*	*1000*	*200*	*300*
Internet i perfshirë (ne GB)	*2 GB*	*3 GB*	*pa limit**	*pa limit”*

* Pas konsumit prej 3GB perdoruesi vazhdon të kete internet pa limit, por me shpejtësi të reduktuar deri në **256 kbps**.

Nga krahasimi i mesiperm vihet re se ofertat Vodafone Club, për një sasi pothuajse të njëjtë të minutave kombëtare, kanë tarifë mujore 50% më të ulët. Club Superiore dhe Mini Red ofrojnë nga 2000 minuta kombëtare, por e para kushton 1200 lekë në muaj, kurse e dyta që është me kontratë kushton 2400 lekë në muaj.

TABELA III.13. TARIFA ME PARAPAGIM V KONTRATE TELEKOM ALBANIA

	Me parapagesë		Me kontratë	
	Paketa Medium	**Paketa Large**	**Smart Medium**	**Smart Large**
Pajtimi mujor	990	1190	1390	1,990
Minuta kombëtare	*2000*	*2000*	*2000*	*2000*
Minuta ndërkombëtare	*0*	*20*	*50*	*150*
SMS brënda rrjetit	*1000*	*2000*	*1000*	*1000*
SMS kombëtare	*300*	*500*	*40*	*40*
Internet i përfshirë në MB	*Pa limit**	*Pa limit**	*3GB*	*3GB*

* Pas konsumit prej 2GB perdoruesi vazhdon të kete internet pa limit, por me shpejtësi të reduktuar deri në 128kbps.

Siç verehet nga tabela e mësipërme, ku janë vendosur paralel dy paketa me parapagesë dhe dy plane me kontratë, shikohet se për sasi të njëjtë minuta kombëtare, planet me parapagesë kanë tarifë mujore shumë më të ulët se planet me kontratë. Paketa Medium (me parapagesë) kushton 990 lekë në muaj dhe është 30% më e lirë se Smart Medium (me kontratë) e cila kushton 1390 lekë në muaj, dhe të dyja ofrojnë nga 2000 minuta kombëtare në muaj. Paketa Large (me parapagesë) kushton 40% më pak se Smart Large (me kontratë).

Politika tarifore te ngjashme aplikohen edhe nga Albtelecom dhe Plus te cilat mund te evidentohen nga planet dhe ofertat tarifore te ketyre operatoreve ne treg.

Tarifat standarde per njesi komunikimi (pay as you go)

Ne analize 2014 AKEP evidentoi si problematike diferencen e larte te tarifave per sherbimet e konsumuara per njesi (lek/minute, SMS) me tarifat e sherbimeve te perfshira ne pagesen fikse si pjese e ofertave. Tabelat e meposhteme paraqesin tarifat e aplikuar per njesi sherbimi per thirrjet telefonike kombetare, SMS dhe akses ne Internet per perdoruesit me parapagim dhe me kontrate. Keto tarifa aplikohen nese perdoruesi me parapagim nuk blen paketa/oferta ose pasi ka konsumuar njesite perkatese te perfshira ne cmimin e paketes/ofertes, si dhe per perdoruesit me kontrate pas konsumit te njesive te perfshira ne pagesen fikse mujore dhe/ose te paketave/opsioneve shtese qe mund te blejne kjo kategori perdoruesish.

TABELA III.14.TARIFAT PER NJESI TE SHËRBIMEVE PËR PERDORUESIT ME PARAPAGIM

	Albtelecom	Plus	Telekom Albania	Vodafone
Thirrje on-net	*29.00*	*25.20*	*39.00*	*39.00*
Thirrje off-net	*29.00*	*25.20*	*39.00*	*29.00*
Thirrje drejt rrjeteve fiks	*29.00*	*25.20*	*39.00*	*29.00*
SMS on-net	*16.20*	*12.00*	*12.00*	*10.00*
SMS off-net	*16.20*	*14.40*	*12.00*	*10.00*
SMS ndërkombëtare	*18.00*	*18.00*	*18.00*	*18.00*
Internet ne MB	*10.24*	*49.15*	*99.94*	*99.94*

Shenim: Tarifat ne Lek me TVSH

TABELA III.15.TARIFAT PER NJESI TE SHËRBIMEVE PËR PERDORUESIT ME KONTRATE

	Albtelecom	Plus	Telekom Albania	Vodafone
Thirrje on-net	*15.00*	*20.16*	*29.00*	*18.00*
Thirrje off-net	*15.00*	*20.16*	*29.00*	*18.00*
Thirrje drejt rrjeteve fiks	*15.00*	*20.16*	*29.00*	*18.00*
SMS on-net	*12.00*	*12.00*	*12.00*	*12.00*

SMS off-net	*12.00*	*14.40*	*12.00*	*12.00*
Internet ne MB	*10.24*	*24.58*	*99.94*	*45.06*

Shenim: Tarifat ne Lek me TVSH

Nga te dhenat e tabelave te mesiperme vihet re se:

- Per perdoruesit me parapagim, tarifat me te uleta per thirrjet kombetare aplikohen nga Plus ne nivelin 25.2 lek/minute, ndersa tarifat me te larta aplikohen nga TA per te gjitha thirrjet kombetare dhe Vodafone per thirrjet on-net ne nivelin 39 lek/minute;

- Per perdoruesit me kontrate, Albtelecom aplikon tarifat me te uleta ne nivelin 15 lek/minute, ndersa TA tarifat me te larta ne nivelin 29 lek/minute.

- Per perdorusit me kontrate te kater operatoret ofrojne tarifa qe jane 20-54% me te uleta se tarifat e thirrjeve per perdoreusit me parapagim;

- Tarifat per aksesin ne Internet variojne nga rreth 10 lek/MB per Albtelecom ne reth 100 lek/MB per TA dhe Vodafone.

Keto tarifa megjithese aplikohen per nje numer shume te kufizuar perdoruesish te cilet nuk aktiviozojne paketa/oferta apo pas perfundimit te tyre, ato jane shume here me te larta se tarifat mesatare qe aktualisht paguajne perdoruesit celulare. Sic eshte theksuar ne seksionin e ARPM, cmimi qe nje perdorues celular ka paguar mesatarisht per nje minute thirrje telefonike nga rrjete celulare eshte 2.83 lek/minute me TVSH, ndersa tarifat e mesiperme jane deri 14 here me te larta se kjo vlere mesatare e ARPM per vitin 2015.

Tarifat e mesiperme te aksesit ne internet, pa aktivizuar oferta/paketa, pervecse jane shume here me te larta se tarifat e ketij sherbimi kur ai eshte i perfshire ne paketa te dedikuara apo te integruara me telefonine, ato jane ne nivele teper te larta qe shkaktojne dhe fatura/shpenzime stratosferike per perdorusin celular. Per nje konsum 1GB shpenzimet perdoruesit me parpagim per aksesin ne Internet, pa aktivizuar oferta/paketa, mund te shkoje nga rreth 10.000 lek per Albtelecm ne rreth 100.000 lek per Vodafone dhe TA.

Krahasimet e mesiperme vene ne dukje diferencen midis cmimeve per njesi konsumi pa aktivizuar oferta/paketa dhe/ose pas konsumit te tyre dhe tarifave mesatare qe paguajne aktualisht perdorueist celulare. Sic eshte theksuar ne seksionet e meparshme dhe mund te vihet re edhe nga tabelat krahasuese te tarifave, operatoret celulare kane oferta/paketa te cilat perfshijne njesi thirrje, SMS dhe MB duke dhene opsione zgjedhjeje ne varesi te cmimit, sasive te perfshira, afatiit te konsumit etj. Njekohesisht, operatoret celulare per te shmangur fatura stratosferike, shpesh aplikojne politikat tarifore te ashtuquajtura FUP (Fair Usage policy), ku ofrohet internet 'pa limit': Pas konsumit te nje sasie te caktuar GB apo MB, perdoruesi vazhdon të kete internet pa limit, por me shpejtësi të reduktuar deri në 128/256 kbps.

Pavaresisht sa me siper, diferenca e larte e tarifave per njesi konsumi pa aktivizim oferte/pakete me tarifat e tjera, dhe sidomos per sherbimin e Internetit, cojne:

- Demtim te interave te te konsumatoreve duke cuar ne shpenzime shume te larta te pajustifikuara;

- ‘Kycje’ te perdoruesve ne perdorim te ofertave/paketave dhe ne nje fare mase edhe ne operatore te caktuar.

Tarifat e sherbimeve roaming nderkombetar

Roamingu nderkombetar eshte nje nder sherbimet qe shpesh ka impakt te konsiderueshem ne faturen mujore te perdoruesve celulare. Roamingu nderkombetar mundeson perdorimin e sherbimeve celulare jashte territorit te vendit perkates duke perdorur rrjetet dhe sherbimet e operatoreve te huaj. Tarifat e roamingut nderkombetar qe perdoruesit celulare paguajne varen ne mase te konsiderueshme nga tarifat me shumice te aplikuara nga operatoret e huaj dhe keto tarifa jane shpesh te larta duke cuar ne tarifa shume te larta me pakice per keto sherbime. Per shkak te problematikes se tarifave te larta te ketyre sherbimeve dhe marrdhenieve midis operatoreve vendas dhe te huaj, qe nuk mund te adresohen plotesisht nga rregullatoret vendas, Komisioni Europian ka nderhyre ne nivel komunitar qe prej vitit 20017 e ne vijim per rregullimin e tarifave me pakice dhe me shumice te roamingut nderkombetar te aplikuara midis operatoreve te vendeve anetare te BE. Keto rregullime kane cuar ne ulje te ndjeshme te tarifave te roamingut nderkombetar ne vendet anetare te BE, por ato nuk jane detyruese per tu aplikuar per vendet qe nuk kane statusin e vendit anetar. Megjithate edhe ne Shqiperi jane vene re reduktime te tarifave te ketyre sherbimeve dhe operatoret celulare ofrojne paketa te ndryshme tarifore per roamingun nderkombetar qe perfshijne minuta, SMS dhe Internet. Tabelat e meposhteme paraqesin disa nga ofertat/paketat per roaming nderkombetar te ofruara nga opertaoret celulare per perdorues me parapagim dhe me kontrate.

TABELA III.16. TARIFA TE ROAMINGUT NDERKOMBETARE

	Vodafone				Telekom Albania			Albtelecom		Plus	
paketa roaming me parapagese	1 ditore Paketa Europe	4 ditore Paketa Europe	10 ditore Paketa Europe	4 Ditore World	Travel & mix 1 ditore	Travel & mix 4 ditore	Travel & mix 10 ditore	Roaming 1	Roaming 4	Roaming 1	Roaming 2
Afati i perdorimit (Dite)	**1**	**4**	**10**	**4**	1	4	10	**1**	4	30	30
Cmimi	100	300	1000	2000	100	300	1000	**99**	299	2000	3000
Minuta dalëse drejt operotorit ku je pajtuar	10	30	100	50*	10	30	100	**10**	30	10	10
Minuta hyrëse	10	30	100	50	10	30	100	**10**	30	50	100
SMS dalëse	10	30	100	50	10	20	50	**10**	30	10	30
MB Internet	10	30	100	50	10	20	50	**10**	30		

	Passport vodafone kontrate	Telekom Albania travel me kontrate
thirrje dalese	Tarifa për thirrje dalëse +**120** lekë vlerë fikse për çdo telefonatë	Tarifa për thirrje dalëse + **120-180** lekë vlerë fikse për çdo telefonatë
Thirrje hyrese	120**	108-180

MB Internet	300 Lekë vlerë fikse për çdo 50MB të konsumuar + Tarifa kombëtare e Internetit sipas planit tënd tarifor.	50 MB - 300 lekë 150 MB - 750 lekë 500 MB - 2,000 lekë

Vodafone	**Red Roaming**	
Destinacioni	**Europe**	**Jo europe**
Tarife ditore lidhjeje per te perdorur njesite e ofruara ne planin perkates Red si ne Shqiperi(leke/min)	500	1000
Per Planet Prenium & Elite	falas	falas

Ne planet perkates te Albtelecom jane pershire edhe njesite e meposhte	**Elite 3500**	**Elite 5000**	**Elite 8500**	**Elite 18000**
Minuta në Roaming	20	30	60	100
SMS në Roaming	20	30	60	100
Internet në Roaming	50	100	200	1024

Nga keto paketa vihet re se operatoret ofrojne paketa te ndryshme per konsum ditor si dhe opsione per perdorim te sherbimeve roaming si ne Shqiperi per nje tarife shtese ditore apo per minute ose MB. Operatoret ofrojne dhe skonto per perdorim te sherbimeve roaming ne rrjete te operatoreve te huaj me te cilet operatoret vendas kane marrveshje te vecanta, sidomos Vodafone dhe TA gjate roamingut ne rrjetet operatoreve te huaj qe jane pjese e grupeve nderkombetare perkatese Vodafone Group dhe Deutche Telekom.

Opsionet e mesiperme pervec tarifave me te lira te roamingut nderkombetar mundesojne perdoruesit te kontrollojne me mire shpenzimet gajte roamingut nderkombetar, per te shmangur faturat shume te larta sidmos per perdoruesit me kontrate. Rritja e perdorimit te Internetit ne aparate celulare smart dhe shpejtesite e larta 3G/4G kane cuar edhe rritje te perdorimit te internetit ne roaming nderkombetar, dhe nepermjet perdorimit te aplikacioneve OTT perdoruesit kane mundesine te shmangin tarifat e larta per thirrje apo SMS ne roaming nderkombetar. Megjithate shpesh tarifat e internetit ne roaming nderkomabetar jane te larta dhe mundesia e kontrollit te shpenzimeve per perdorim te internetit eshte shume me ulet se kontrolli i perdorimit et thirrjeve apo SMS-ve. Kjo ka cuar qe shkaku kryesor i faturave teper te larta te roamingut nderkombetar te jete perdorimi i Internetit dhe jo me i thirrjeve apo SMS-ve. Megjithese operatoret ofrojne paketa te vecanta edhe per internet ne roaming nderkombetar apo perfshirjen e sasive te caktuara te perdorimit te internetit ne pagesat fikse, vihet re se tarifat standarde te perdorimit te Internetit ne roaming nderkombetar jashte ketyre paketave/opsioneve jane teper te larta. Tabela e meposhteme paraqet nje permbledhje te tarifave te internetit ne roaming nderkombetar te aplikuara jashte paketave/opsioneve per keto sherbime.

TABELA III.18. TARIFA TE ROAMINGUT NDERKOMBETARE JASHTE OFERTAVE/PAKETAVE

Operatori	Tarifat Roaming sipas zonave (Euro/MB)
Vodafone	2.6 Euro/MB per Rrjete Vodafone Group
	5.6/7.1 Euro/MB per rrjete te tjera Europiane/ dhe Jo Europe
TA	2.1 Euro/MB parapagim
	0.9 Euro/MB Rrjete te Deutche Telekom Group
	5.2-7.1 Euro Rrjete te tjera
Albtelecom	0.1 Euro/MB per rrjete te Zonave Promo 1 dhe 2
	5.4-14.3 Euro/MB per Zona te tjera
Plus	13.4 Euro/MB per te gjitha zonat

Sic mund te vihet re tarifat kane variacione te medha midis operatoreve dhe operatoret aplikojne tarifa me te lira per roaming ne operatore te te njejtit grup nderkombetar (Vodafone dhe TA) si dhe Albtelecom i cili megjithese nuk eshte pjese e ndonje grupi nderkombetar aplikon tarifa shume me te lira per roaming ne shume operatore te huaj me te cilet ka marrveshje te vecanta.

Perfundim per tarifat me pakice:

Niveli i tarifave/shpenzimeve mesatere per sherbimet celulare i matur nepermjet treguesve te ARPM dhe ARPU tregon se ato kane vijuar tendencë rënëse te vieteve te fundit, dhe për vitin 2015 vlerat e tyre janë reduktuar me 10% dhe 6% respektivisht. Në vitin 2015 një përdorues celular ka paguar mesatarisht 2.83 lek/minutë (me TVSH) për thirrjet telefonike dhe ka shpenzuar mesatarisht 513 lek/muaj (me TVSH) për shërbime celulare (thirrje, SMS dhe Internet). Vlerat e ketyre treguesve jane me te uleta se ne te gjitha vendet Europiane dhe disa here me te uleta se mesatarja ne vendet e BE.

Zbatimi i detyrimeve te mos-diskriminimit ne tarifat e thirrjeve on-net/off-net solli ndryshime të rëndësishme në planet tarifore të operatorëve celularë:

- përfshirjen e sasive të barabarta të minutave brenda rrjetit dhe drejt rrjeteve celulare apo të thirrjeve brenda dhe jashtë rrjetit (pa dallim destinacioni) në pagesat fikse të planeve tarifore me kontratë dhe me parapagim,

- reduktim të ndjeshëm të numrit të ofertave të përkohshme promocionale dhe rritje të numrit të paketave standarde me përfitime më të mëdha për përdoruesit celularë.

Këto ndryshime nga të katër operatorët celularë kanë çuar në rritje të përfitimeve të përdoruesve fundorë, pasi sasia e minutave të përfshira në pagesat fikse është e mjaftueshme dhe duke filluar nga pagesa shumë të ulëta fikse. Ofertat/paketat tarifore mund të mos kenë më thirrje 'pa limit' brenda rrjetit/grupit, por ato kanë sasi të konsiderueshme thirrjesh (qindra deri në mijëra minuta brenda dhe jashtë rrjetit) sa që praktisht në shumë raste mund të konsiderohen pa limit. Pra përdorusit celularë me të njëjtën kosto (pagesë) kanë përfituar sasi të konsiderueshme thirrjesh jashtë rrjetit celular (drejt rrjeteve të tjera celulare). Efektet e këtyre ndryshimeve janë vënë re në sasinë e thirrjeve dhe strukturën e thirrjeve të përdoruesve të katër operatorëve celularë.

Planet tarifore te operatoreve celulare kane vazhduar tendencen e shitjes se produkteve nepermjet paketave tarifore me sherbime te integruara, dhe shumica e paketave tarifore permbajne minuta thirrje telefonike, SMS dhe kapacitet download ne Internet. Ofrimi i sherbimeve me paketa te integruara eshte nje tendence e viteve te fundit te rrjeteve celulare dhe fikse ne Shqiperi dhe ndjek tendencen edhe te vendeve te tjera Europiane.

Tarifat e aksesit ne internet si per paketat e integruara dhe per paketa vetem me akses ne Internet rezultojne te jene ne nivele te uleta, duke cuar ne rritje te ndjeshme te perdorimit te ketij sherbimi ne rrjetet 3G/4G ne vitet e fundit. Keto tarifa jane te ulet krahasuar edhe me ato te vendeve te tjera, sic evidentohet dhe nga krahasimet e ITU.

Zhvillime pozitive jane vene re dhe ne tarifat e sherbimeve te roamingut nderkombetar, ku operatoret celulare nepermjet paketave/opsioneve te vecanta per keto sherbimeve mundesojne perdorimin e tyre me tarifa mesatare me te uleta dhe per perdruesit fundore dhe kontroll me te larte te shpenzimeve nga keta te fundit, per te shmangur faturat teper te larta. Vodafone Albania dhe Telekom Albania duke qene pjese e grupeve te medha nderkombetare (Vodafone Group dhe Deutche Telekom) kane avantazhe te ofrimit te skontove per roaming nderkombetare ne operatoret e tjere pjese e grupve perkatese. Megjithate edhe Albtelecom qe nuk eshte pjese e ndonje grupi te madh nderkombetar vihet re se ofron skonto/tarifa atraktive per roaming nderkombetar, madje per internetin ne roaming ofron tarifa per njesi (MB jashte paketave/ofertave) shume me te lira se dy operatoret e tjere celulare.

Ndryshimet e planeve/paketave tarifore kane cuar dhe ne rritje te transparences dhe krahasueshmerise se tarifave midis operatoreve te cilat cojne ne rritje te konkurrences midis operatoreve dhe perfitimeve te perdorusve fundore. Ofrimi i paketave te ngjashme dhe te krahasueshme nga te kater operatoret si ne cmime, sasi minutash, Interneti, sherbime te integruara (minuta, SMS dhe internet), afate kohore te konsumit etj, tregojne per sjellje te ngjashme te operatoreve ne tregun me pakice dhe perceptim nga perdoruesit per produkte/sherbime te ngjashme jo te diferencuara midis operatoreve celulare.

Megjithe ndryshimet e kryera ne planet tarifore te operatoreve celulare, segmenti me parapagim rezulton te kete shpesh paketa/opsione me tarifa me te lira se segmenti me kontrate si dhe tarifat standarde per njesi komunikimi jane shume me te larta se tarifat mesatare qe paguhen nepermjet shportave te komunikimit. Kjo diference e madhe midis tarifave mesatare te paguara me paketat/shportat dhe tarifave nominale standarde per njesi konsumi (minuta, SMS, MB) eshte shume e theksuar sidomos per sherbimet e aksesit ne Internet (ne Shqiperi dhe gjate roamingut

nderkombetar), sherbim i cili ka nje tarife teper te larte per konsumin per MB/GB. Keto diferenca dhe tarifa teper te larta per konsum per njesi rrisin ne menyre te pajustifikuar shpenzimet per perdoruesit celulare qe nuk perdorin apo aktivizojne paketat/ofertat operatoreve celulare.

III.6. Performanca financiare e kompanive celulare

Të ardhurat

Të ardhurat e operatorëve celularë në vitin 2015 ishin 33.1miliard lek qe perben një rritje të moderuar prej 1%, krahasuar me vitin 2014. Rritjen më të madhe e pati Plus me rreth 20%, ndersa Telekom Albania kishte një rritje të moderuar prej 1%. Te ardhurat e Vodafone u reduktuan me 1%, ndersa te ardhurat e Albtelecom ishin pothuajse te pandryshuara ne krahasim me nje vit me pare. Pjesët e tregut në të ardhura kanë pësuar ndryshime të vogla, Vodafone ka pësuar një rënie prej 1 pikë përqindje dhe Plus ka rritje me po 1 pikë përqindje. Sic mund te vihet re nga figura e meposhtme te ardhurat totale te sektorit kane pasur tendence renese qe prej vitit 2009, ku perjashtim ben rritja e ndjeshme ne vitin 2012 dhe rritja e vogel e vitit 2015.

FIGURA III.14: TE ARDHURAT TOTALE TE OPERATOREVE CELULARE 2004-2015



	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Plus							10	751	1,835	2,167	1,814	2,175
Albtelecom(Eagle)					600	4,362	5,166	4,865	4,342	4,199	3,956	3,975
Vodafone	17007	19605	21785	23075	24,919	22,877	20,165	20,347	23,520	18,515	15,680	15,582
Telekom	17106	18326	19811	21785	23,471	19,975	16,552	13,214	12,315	12,086	11,230	11,339

Shënim: Të ardhurat në milion Lek dhe janë sipas deklarimeve te operatoreve

Të ardhurat nga shërbimet me pakice (retail) u reduktuan me 9% në krahasim me një vit më parë. Reduktimi varion nga 16% për Telekom Albania, në 8% për Vodafone dhe 1 % për Plus, ndërsa Albtelecom pati rritje më 1%. Figura më poshtë paraqet ecurine e të ardhurave me pakicë për secilin operator ne periudhen 2011-2015, ku vihet re tendenca renese per te gjithe tregun dhe secilin operator gjate gjithe periudhes.

FIGURA III.15: TE ARDHURAT NGA SHERBIMET ME PAKICE 2011-2015



	2011	2012	2013	2014	2015
Plus	473	1,134	1,167	962	948
Albtelecom	3,406	2,885	2,402	2,150	2,161
Vodafone	12,796	11,686	10,902	10,268	9,406
Telekom	9,385	7,665	6,703	5,839	4,915

Shënim: Të ardhurat janë sipas deklarimeve te operatoreve

Te ardhura nga sherbimet me shumice te operatoreve celulare ne 2015 u rriten me rreth 16% ne krahasim me 2014. Operatori Plus pati rritjen me te madhe vjetore me 44%, ndersa te ardhurat me shumice te Telekom Albania dhe Vodafone u rriten me më 19% dhe 14% përkatësisht. Te ardhurat me shumice te Albtelecom nuk pesuan ndryshim te ndjeshem si edhe te ardhurat me pakice.

Ne kete rritje te te ardhurave me shumice ka ndikuar rritja e ndjeshme e trafikut off-net gjate vitit 2015 duke cuar ne rritje te te ardhurave nga terminimi i thirrjeve kombetare, pavaresisht tarifave me te uleta te terminimit te ketyre thirrjeve ne krahasim me vitin 2014. Ne rritjen e ndjeshme te ardhurave me shumice te Plus ka ndikuar rritja e të ardhurave nga terminimi i thirrjeve kombetare me 37% dhe rritja e të ardhurave nga terminimi i thirrjeve hyrese ndërkombëtare me 72%.

FIGURA III.16: TE ARDHURAT NGA SHERBIMET ME SHUMICE 2011-2015



	2011	2012	2013	2014	2015
Plus	278	701	999	852	1,227
Albtelecom	1,459	1,457	1,797	1,806	1,814
Vodafone	7,551	11,834	7,613	5,411	6,176
Telekom	3,829	4,650	5,384	5,390	6,424

Burimi: Të ardhurat sipas deklarimeve te operatoreve ne formularet perkates

Fitimet

Figura e meposhtme paraqet ecurine e fitimit neto te secilit prej sipermarrsve te rrjeteve te operatoreve celulare dhe toatlin per te kater sipermarresit se bashku, per periudhen 2010-2015

FIGURA III.17: ECURIA E FITIMEVE NETO TE SIPERMARRESVE TE RRJETEVE CELULARE (2010-2015)



	2010	2011	2012	2013	2014	2015
TA	6,250	4,069	3,047	4,124	2,443	541
Vodafone	5,877	4,199	5,019	3,293	1,425	226
Albtelecom	-302	-1,043	-1,045	-1,048	-2,006	-2,207
Plus	-918	-2,256	-1,969	-1,263	-1,377	88
Total	10,908	4,968	5,052	5,106	485	-1,352

Shenime:

- *Fitimi neto i Telekom Albania perfshin te ardhura neto nga interesat qe zene nje peshe te rendesishme ne te ardhurat dhe fitimin e Telekom Albania.*
- *Fitimi (humbja) neto e Albtelecom per vitet 2014-2015 eshte rezultati neto i te gjithe kompanise (sherbime celulare dhe fikse)*

Nga figura mund te vihet re se fitimet neto totale te te kater sipermaresve kane pesuar reduktime te ndjeshme ne vitet 2011, 2013-2015. Ne vitin 2015 rezultati neto total i te kater sipermarrsve te komunikimeve elektronike eshte negativ, dhe kjo eshte ndikuar nga renia e ndjeshme e fitimeve te Vodafone dhe Telekom Albania ne 2015 me 84% dhe 78% respektivisht. Plus eshte i vetmi sipermarres qe pati nje ndryshim pozitiv, nga humbje neto prej 1.4 miliard lek ne 2014 ne fitim neto prej 88 milion lek ne 2015. Albtelecom dhe Plus kane rezultate negative neto gjate gjithe periudhes se hyrjes ne treg si operatore celulare (pervec vitit 2015 per Plus), ndersa Vodafone dhe TA kane pasur fitime neto te larta por qe jane reduktuar ndjeshem ne 2014-2015. Renia e ndjeshme e fitimeve te Vodafone dhe TA eshte shoqeruar edhe me renie te normave te fitimit te ketyre dy sipermarresve.

Investimet

Figura e meposhtme paraqet ecurine e investimeve te kater sipermarrseve ne infrastrukture te rrjeteve celulare (nuk perfshihen shpenzimet per licenca/autorizime) ne periudhen 2010-2015.

FIGURA III.18: ECURIA E INVESTIMEVE TE SIPERMARRESVE NE RRJETE CELULARE (2010-2015)



	2010	2011	2012	2013	2014	2015
TA	2,559	2,027	1,450	1,397	1,255	1,994
Vodafone	2,749	3,850	2,735	3,086	3,542	1,446
Albtelecom	1,530	455	627	730	676	1,214
Plus	2,779	498	623	49	122	121
Total	9,617	6,831	5,435	5,262	5,594	4,774

Ecuria e investimeve ne rrjete celulare e te kater sipermarresve se bashku ka pasur renie te ndjeshme ne 2011 dhe 2012 por duket se eshte me e stabilizuar ne 2013-2015. Megjithate vlerat e investimeve sipas sipermarrsve kane luhatje te konsiderueshme ne kohe dhe midis njeri tjetrit. Nga te kater operatoret celulare, Vodafone ka pasur nivelin me te larte te investimeve ne periudhen 2010-2015, duke arritur ne 3.8 miliard lek ne vitin 2011, qe perkon me fillimin e ofrimit te sherbimeve 3G nga ky operator, ndersa nivelin me te ulet ne vitin 2015 me 1.4 miliard lek. Telekom Albania dhe Albtelecom kane pasur rritje te ndjeshme te investimeve ne vitin 2015 krahasur me tre dhe kater vitet e meparshme. Plus ka pasur nivelin me te larte te investimeve ne vitin 2010, qe perkon me fillimin e ofrimit te sherbimeve nga ky operator, ndersa ka pasur nivel shume te reduktuar ne vitet 2013-2015.

ARPU

Ndersa ne seksionin e tarifave treguesi i ARPU u perdor si tregues perafrues (proxy) i shpenzimeve mesatare te perdoruesve, ne kete seksion ai paraqitet si tregues i te ardhurave mesatare te operatoreve. Figurat e meposhteme paraqesin ARPU sipas operatoreve ne periudhen 2011-2015. ARPU eshte paraqitur ne dy menyra matjeje, nga te ardhurat me pakice si dhe nga te ardhurat totale te sipermarresit. ARPU totale eshte nje tregues me vlere pasi tregon te ardhurat qe nje operator perfiton mesatarisht nga nje perdorues i rrjetit te vet, si nga sherbimet me pakice per te cilat paguan vet perdoruesi edhe nga te ardhurat me shumice (kryesisht terminimi i thirrjeve) per te cilat perdoruesi i rrjetit perkates nuk paguan, por qe per operatorin perbejne nje burim te rendesishem te ardhurash.

FIGURA III.19: ARPU RETAIL SIPAS OPERATOREVE 2011-2015



FIGURA III.20: ARPU TOTAL SIPAS OPERATOREVE 2011-2015



Nga ecuria e treguesve vihet re se:

- ARPU retail ka pasur tendence renese per te kater operatoret ne 2015 dhe ne te gjithe perioudhen 2011-2015, pervec rritjes per Albtelecom dhe Plus ne vitin 2012;
- ARPU Totale pati rritje ne vitin 2015 duke reflektuar rritjen e te ardhurave nga sherbimet e shumice, kryesisht nga rritja e te ardhuare te terminimit te thirrjeve kombetare. Plus dhe Telekom Albania paten rritjen me te madhe me 20% dhe 15% respektivisht, Vodafone pati nje rritje te vogel me 1% ndersa Albtelecom pati nje renie me 6% te ketij treguesi. Ky tregues ka tendenca te ndryshme renese dhe rritese sipas operatoreve ne periudhen 2011-2015;

- Vodafone ka perdoruesit me ARPU me te madhe ne retail dhe total, pervec ARPU totale ne vitin 2015, ku Telekom Albania pati ARPU Totale me te larte. Ne periudhen 2011-2012 ARPU totale e Vodafone kishte diferencen me te madhe nga operatoret e tjere, duke pesuar renie te ndjeshme ne 2013 dhe konvergim me operatoret e tjere ne 2014-2015.

Perfundim

Te ardhurat totale te operatoreve celulare ne vitin 2015 paten nje rritje te vogel qe perben nje ndryshim nga tendenca renese e tyre ne vitet e fundit. Te ardhurat nga sherbimet me pakice vijuan tendencen renese qe prej vitit 2011 dhe e shoqeruar me rritje te ndjeshme te konsumit mesatar te sherbimeve celulare, sidomos akses ne internet, ka cuar ne renie te ARPU retail te operatoreve celulare.

Megjithe reduktimet e ndjeshme ne tarifat e terminimit, te ardhurat nga sherbimet me shumice ne vitin 2015 paten rritje te konsiderueshme, e ndikuar nga rritja e ndjeshme e trafikut off-net midis operatoreve celulare per shkak te masave te imponuara nga AKEP per mosdikriminim ne tarifat e thirrjeve on-net dhe off-net. Rritja e te ardhurave me shumice ka cuar edhe ne rritje te ARPU totale per operatoret celulare.

Ne vitet 2014 dhe 2015 eshte vene re nje renie e madhe e fitimeve neto totale e kater sipermarresve te sektorit celular, sidmos per dy operatoret me te medhenj, Vodafone dhe TA. Ne vitin 2015 per here te pare rezultati neto total i te kater sipermarresve ishte negativ.

Megjithe renien e madhe te fitimeve neto, niveli total i investimeve ne infrastructure rrjeti celular ne kete periudhe nuk ka pasur renie te ndjeshme, madje sipermarresit kane kryer investime te larta ne assete jo-te prekshme si pagesat one-off per rinovime frekuencash 900/1800 MHz (TA dhe Vodafone) dhe blerje te brezave te rinj te frekuencave ne keto vite per ofrim te sherbimeve ne rrjete 3G/4G.

Tendenca renese e fitimeve te operatoreve me te medhenj dhe me te hershem ne treg eshte ne linje me rritjen e konkurrences ne treg, pasi hyrjet e reja dhe rritja e konkurrences reduktojne deri eliminojne fitimet e teperta te operatoreve me te medhenj. Megjithate, rezultatet neto negative te dy operatoreve me te vegjel celulare per shume vite si dhe per Albtelecom si kompania incumbent ne tregun fiks si dhe rezultati total negativ ne vitin 2015 i kater kompanive me te medha te sektorit (qe perbejne mbi 90% te qarkullimit monetar te gjithe sektorit) eshte tregues i konkurrences agresive ne cmime (ARPU dhe ARPM shume te uleta), por qe mund te ndikoje ne konkurrencen afatgjate dhe aftesite per investime te operatoreve ne nje sektor qe karakterizohet nga zhvillime dinamike ne teknologji dhe kerkesa te larta per investime.

III.7. Pjeset e Tregut

Në tabelën mëposhtëme jane dhene pjesët e tregut te operatoreve celulare për treguesit kryesore në periudhën 2010-2015 si dhe tremujorin e trete 2016 së bashku me indeksin HHI[27] të përqëndimit.

TABELA III.19. PJESET E TREGUT TE OPERATOREVE CELULARE 2010-QIII_2016

	Viti	Telekom Albania	Vodafone	Albtelecom	Plus	HHI
Përdorues Aktivë	QIII_2016	33.2%	49.9%	12.7%	4.1%	3,770
	2015	31.9%	47.4%	14.2%	6.5%	3,508
	2014	33.2%	46.1%	12.9%	7.8%	3,455
	2013	37.5%	45.0%	11.5%	6.0%	3,600
	2012	39.8%	42.2%	12.3%	5.7%	3,549
	2011	37.0%	43.7%	13.4%	5.9%	3,493
	2010	44.2%	35.8%	19.1%	0.9%	3,601
Përdorues (Karta SIM)	QIII_2016	32.5%	48.8%	14.3%	4.5%	3,662
	2015	32.6%	42.5%	16.4%	8.5%	3,210
	2014	38.8%	40.3%	13.8%	7.1%	3,370
	2013	39.0%	42.4%	12.8%	5.8%	3,516
	2012	33.4%	35.9%	25.3%	5.4%	3,074
	2011	36.7%	34.6%	21.2%	7.6%	3,051
	2010	44.5%	36.8%	18.1%	0.6%	3,662
Përdorues me Kontratë	QIII_2016	28.5%	37.3%	29.6%	4.5%	3,100
	2015	24.7%	34.8%	31.5%	9.0%	2,894
	2014	19.5%	36.8%	33.6%	10.0%	2,963
	2013	37.4%	22.2%	20.6%	19.8%	2,708
	2012	30.5%	18.2%	35.9%	15.3%	2,784
	2011	35.0%	24.2%	34.3%	6.5%	3,029
	2010	42.9%	30.0%	26.8%	0.4%	3,459
Thirrje dalëse	QIII_2016	34.1%	51.2%	10.9%	3.8%	3,918
	2015	31.7%	49.3%	13.1%	5.9%	3,642
	2014	33.6%	50.2%	11.0%	5.2%	3,797
	2013	39.0%	51.0%	7.0%	3.0%	4,180
	2012	39.0%	50.0%	8.0%	3.0%	4,094
	2011	37.0%	51.0%	10.0%	2.0%	4,074
	2010	46.0%	45.0%	9.0%	0.0%	4,222
SMS dalëse	QIII_2016	21.7%	65.8%	8.9%	3.5%	4,892
	2015	18.1%	65.8%	8.1%	8.0%	4,787

[27] HHI (Herfindahl–Hirschman Index), i matur si shuma e katroreve te pjeseve te tregut te gjithe lojtareve te tregut.

	2014	19.4%	66.4%	4.7%	9.5%	4,898
	2013	21.0%	73.0%	5.0%	1.0%	5,796
	2012	20.0%	73.0%	6.0%	1.0%	5,766
	2011	27.0%	64.0%	8.0%	1.0%	4,890
	2010	34.0%	57.0%	9.0%	0.0%	4,486
Te ardhura totale nga komunikimet	2015	34.3%	47.1%	12.0%	6.6%	3,582
	2014[28]	34.4%	48.0%	12.1%	5.6%	3,665
	2013	32.7%	50.1%	11.4%	5.9%	3,744
	2012	29.3%	56.0%	10.3%	4.4%	4,120
	2011	33.7%	51.9%	12.4%	1.9%	3,987
	2010	39.5%	48.1%	12.3%	0.0%	4,025
Të ardhura në pakicë	2015	28.2%	54.0%	12.4%	5.4%	3,894
	2014	30.4%	53.4%	11.2%	5.0%	3,926
	2013	31.7%	51.5%	11.3%	5.5%	3,815
	2012	32.8%	50.0%	12.3%	4.9%	3,751
	2011	36.0%	49.1%	13.1%	1.8%	3,882

Nga të dhënat per vitin 2015 vihet re se:

- Për treguesit e numrit të përdoruesve:
  - Vodafone ka pasur rritje me 1-3 pikë përqindje në pjesën e tregut të numrit total të përdoruesve dhe reduktim me 2 pikë përqindje në përdoruesit me kontratë;
  - Telekom Albania ka humbur 1-6 pikë përqindje në pjesën e tregut të numrit total të përdoruesve dhe rritje me 5 pikë përqindje në përdoruesit me kontratë;
  - Albtelecom (EM) dhe Plus kanë fituar ose kanë humbur 1-2 pikë përqindje pjesë tregu të numrit total të përdoruesve dhe përdoruesit me kontratë;
- Albtelecom dhe Plus kanë fituar 1-2 pikë përqindje pjesë tregu në thirrjet dalëse ndërsa Vodafone dhe Telekom Albania kanë humbur 1-2 pikë përqindje pjesë tregu për këtë tregues;
- Pjesa e tregut e Vodafone për SMS vazhdon të jetë e lartë me 66% pa ndryshim nga viti 2014. Telekom Albania dhe Plus kanë humbur pjesë tregu me 1 pikë përqindje secila, ndërsa Albtelecom ka fituar 2 pikë përqindje pjesë tregu;
- Pjesa e tregut në të ardhura e Vodafone për 2015 rezulton të jetë 47% që përbën rënie nga niveli 48% në 2014 dhe 50 % në 2013. Telekom Albania nuk ka ndryshime nga 2014, por ka një rritje nga 2013 me rreth 2 pikë përqindje. Albtelecom si edhe Telekom Albania

[28] *Treguesi është rishikuar pasi sipërmarresi Vodafone Albania bëri saktësime në lidhje me vlerën e të ardhurave për vitin 2014 Mund të ekzistojë një mospërputhje e vogël ndërmjet shumës së përbërësve dhe totalit të paraqitur në tabela, për shkak të rrumbullakimeve*

nuk ka ndryshim nga 2014, por nga 2013 ka një rritje më 0.6 pikë përqindje. Plus në 2015 nga 5.6% pjesë tregu në të ardhura që kishtë në 2015, shkoi në 6.6%;

- Pjesët e Telekom Albania në të ardhura më pakicë edhe këtë vit kanë pësuar rënie më rreth 2 % në krahasim më një vit më parë, ndërsa Vodafone, Albtelecom dhe Plus kanë rritje që varion në intervalin 0.4-1.2 pikë përqindje.

- Indeksi HHI ka pasur ulje si në të ardhurat totale ashtu edhe në ato më pakice, përkatësisht ulje më 77 dhe 37 pikë. Gjithashtu indeksi HHI matur sipas të gjithe treguesve pa pësuar rënië më 37-159 pikë, përvec rastit kur matet sipas përdoruesvë aktivë për të cilin ka pësur një rritje prej 49 pikësh. Uljen më të madhe e ka për thirrjet dalëse ku dallohet së dy operatorët e medhenj kanë humbur pjesë tregu më 1-2 pikë përqindje. Vihet re se HHI per numrin perdoruesve dhe te ardhura ka reduktim te ndjeshem pas hyrjes ne treg te dy operatoreve me te rinj Altelecom dhe Plus: nga nivele rreth 5000 ne nivele 3500-3700.

Nga krahasimi i pjeseve te tregut ne Tremujorin e III 2016 me vitin 2015 vihet re se ndryshimet kryesore jane:

- Vodafone ka rritje te pjeseve te tregut te perdoruesve aktive dhe me kontrate me 2.5 pike perqindje, me 6.5 pike perqindje per karta SIM dhe me 1.9 pike perqindje per thirrje dalese;

- Telekom Albania ka rritje te pjeses se tregut per perdorues me kontrate me 3.8 pike perqindje (pp) dhe me 2.4 pp dhe 3.6 pp per SMS dhe thirrje;

- Albtelecom ka renie te pjeseve te tregut per perdorues me 1.5-2.1 pp, dhe me 2.2 pp per thirrje dalese;

- Plus ka renie te pjeseve te tregut per perdorues me 2.4-4.5 pp per perdorues dhe 2.1 pp dhe 4.1 pp per thirrje dhe SMS;

- Treguesi HHI ka pasur rritje me 206-452 pike per pjeset e tregut per perdorues, rritje me 276 pike per thirrje dalese dhe 106 pike per SMS

Pjeset e tregut deri ne vitin 2015 kryesisht kane pasur tendence per reduktim te pjeseve te tregut te operatoreve me te medhenj dhe rritje te pjeseve te tregut per operatore me te vegjel, duke cuar ne reduktim te perqendrimit te tregut. Ndersa ne vitin 2016, deri ne tremujorin e trete, vihet re tendenca e kundert ku Vodafone dhe TA kane pasur rritje te pjeseve te tregut dhe Albtelecom dhe Plus kane pasur reduktim te tyre, duke cuar ne rritje te HHI.

III.8. Tendenca nderkombetare te tregjeve celulare

AKEP pasi ka dhene nje panorame te zhvillimeve ne tregun celular me pakice ne Shqiperi ne vitet e fundit duke bere disa krahasime me vendet e tjera per disa tregues, ne kete seksion paraqet disa tendenca te tregjeve celuare ne vendet e BE dhe rajonit, bazuar ne dokumenta te KE dhe BEREC.

Propozimi i KE per ndryshimin e kuadrit rregullator

KE ne vijim te zhvillimeve te ndodhur dhe te pritshme te sektorit te komunikimeve elektronike si dhe me qellim konsolidimin e metejshem te tregut te perbashket te BE (single market), më datë 14.09.2016, publikoi propozimet për rishikimin e kuadrit aktual rregullator të komunikimeve elektronike. Ndër elementët kryesorë të propozimeve të KE, janë:

- Përcaktimin e objektivave jo-detyruese për Shoqërinë Gigabit (Gigabit Society) për vitin 2025 (të gjitha familjet të kenë akses broadband me shpejtësi 100 Mbps, që mund të rritet në shpejtësi me Gigabps;
- Plan veprimi për mbulimin me rrjete celulare 5G;
- Ndërmarja e masave për stimulimin e instalimit të rrjeteve me fibra optike;
- Përcaktimin e afatit minimal prej 25 vitesh për autorizimet e reja individuale për përdorimin e radiofrekuencave;
- Përfshirjen në fushën e SHU të aksesit bazik broadband me cmime të përballueshme;
- Vendosje të tavaneve për tarifat e terminimit në rrjetet fikse dhe celulare;
- Zgjerimi i rolit dhe reformimi i BEREC.

Propozimet e KE për rishikimin e kuadrit rregullator do të jenë objekt i këshillimit me palët e interesuara dhe parashikohet që të miratohen nga Paralmenti dhe Këshilli Europian fundi i vitit 2017. Ne lidhje me rrjetet celulare porpozimet kryesore jane:

- Plan veprimi për mbulimin me rrjete celulare 5G:
  - frekuencat ne brezin 700 MHz te jene te disponueshem per operatoret celulare ne vitin 2020
  - te gjitha zonat urbane dhe rruget kryesore te kene mbulim %g deri ne 2025;
  - ofrimi komercial i 5G te filloje ne 2018 dhe deri ne fund te 2020 te kete cdo vend anetar i BE te kete nje qytet kryesor me mbulim 5G;
- OTT qe perdorin numeracion te kene detyrime si operatoret e k.elektronike
- Mos-perjashtim i rrjeteve celulare ne ofrimin e SHU
- Vendosje tavanesh ne nivel BE per tarifat e terminimit te thirrjeve ne rrjetet celulare (1.23 eurocent/minute)

Efekti i OTT dhe sherbimet e integruara ne paketa (bundles)

Rritja e perdorimit dhe cilesise se sherbimit te aksesit broadband ne rrjetet celulare 3G/4G ka cuar ne rritjen e perdorimit te sherbimeve te aplikacioneve OTT (Over The Top). Aplikacione te tilla si WhatsUp, Viber, Skype etj, ofrojne sherbime qe kane efekte zevendesuese dhe konkurrojne direkt apo indirekt me sherbimet tradicionale te ofruara nga operatoret e rrjeteve celulare si thirrje telefonike dhe SMS. Megjithe veshtiresine ne matjen e perdorimit te ketyre aplikacionave, efekti i zvendesimit te thirrjeve telefonike (rrjete celulare dhe fikse) me thirrje nga Skype, se fundmi dhe nga WhatsUp dhe Viber, si dhe i mesazheve SMS nga rrjetet celulare me mesazhe WhatsUp apo Viber, eshte i njohur dhe pranuar tashme ne shume vende, perfshire edhe nga BEREC, i cili ka publikuar nje sere dokumentash per OTT dhe marredheniet midis ofruesve OTT dhe operatoreve te rrjeteve celulare.. Rritja e perdorimit te sherbimeve te aksesit broadband con ne rritjen e perdormit te aplikacioaneve OTT duke cuar edhe ne rritjen e presionit konkurrues te ketyre te fuindit ndaj sherbimeve tradicionale te ofruar nga operatoret celulare. Gjithsesi duhet theksuar se rritja e perdorimit te aplikacioneve OTT con ne rritje te kerkeses per trafik data dhe askes broadband nga rrjete celulare.

BEREC ne dokumentin "*Report on OTT services", January 2016 (BoR (16) 35)*, ka bere nje kategorizim te sherbimeve OTT ne tre grupe:

- OTT-0: nje sherbim OTT qe permbush kushtet si sherbim i komunikimeve elektronike (ECS-Electronic Communication Service)
- OTT-1: nje sherbim OTT qe nuk eshte ECS por potencialisht konkurron me ECS
- OTT-2: sherbime te tjera OTT

Sherbimet OTT-0 jane sherbime qe mundesojne komunikim zanor jo vetem me perdorues qe te njetin aplikacion por edhe perdoruesit e sherbimeve te komunikimeve elektronike publike si Skype Out/Viver Out etj. Ndersa sherbimet e palikacioneve te tilla si ËhatsApp, Viver etj qe mundesojne komunikim vetem me perdorues te tjere te te njetit aplikacion nuk jane sherbime ECS, megjithate ato krijojne presion konkurrues ne sherbimet tradicionale si thirrje, SMS etj.

Megjithese sherbimet OTT-0 dhe OTT-1 kane efekt direkt dhe potencial ne konkurrence me operatoret e rrjeteve celulare, keta te fundit perfshihen ne ofrimin e sherbimeve OTT edhe nepermjet marrveshjeve me ofruesit e sherbimeve OTT-2 te permbajtjes si transmetim permbatje TV, video/audio streaming dhe rrjete sociale. Dokumenti i BEREC "Report on new bundles trends" (BoR (16) 173), tregon se operatoret celulare gjithmone e me shume per perdorin sherbimet e reja te OTT si pjese te sherbimeve te reja qe ata ofrojne. Kjo tendence eshte vene re keto vite edhe ne Shqiperi si psh. nepermjet ofrimit nga operatoret te akses ne internet falas per sherbime te rrjeteve sociale, ofrim kapaciteti ne Cloud, Mobile Tv etj.

Matja e perdorimit te ketyre aplikacioneve dhe efektit ne konkurrence eshte e veshtire, megjithate ajo qe tashme pranohet si nga industria dhe autoritete rregullatore eshte fakti se zhvillimet e aksesit broadband ne rrjete celulare, telefonave smart, OTT kane cuar ne rritje te zevendesueshmerise se sherbimeve zanore dhe SMS nga rrjete celulare me sherbime nga keto aplikacione si dhe kerkese me te larte per kapaciette transmetimi te dhenash ne rrjetet celulare dhe rrjedhimisht ne invetsime me te medha nga operatoret e rrjeteve celulare ne 4G dhe me vone dhe ne 5G. Efektet zevendesuese kane filluar te ndihen keto vite te fundit edhe ne Shqiperi per shkak te rritjes se ndjeshme te perdorimit dhe cilesise se aksesit broadband te mundesuar nga rrjetet 3G dhe sidomos 4G dhe nga rritja e perdorimit te aparateve celulare smart.

Per sa me siper, AKEP vlereson se ky faktor con ne rritje te konkurrences potenciale ne tregun celulare me pakice si dhe ne nevoje per investime me te medha ne rrjete broadband celular per te perballuar kerkesen ne rritje per keto sherbime.

Struktura e tregut ne vende te BE dhe rajonit SEE

Tregu celular eshte treg oligopol dhe ne vende te ndryshme ka pasur kohe te ndryshme te hyrjes se operatoreve ne treg. Zakonisht operatoret qe kane hyre me shpejt ne treg kane pjese tregu me te madhe, megjithate vihet re se niveli i pjeses se tregut te operatorit me te madh apo me te vegjel varet nga shume faktore, nder te cilet koha e hyrjes ne treg eshte shume e rendesishme. Tabela e meposhtme paraqet pjeset e tregut ne pajtimtare te operatoreve celulare ne vendet e BE, per operatorin me te madh (leader), operatorin e dyte me te madh dhe te gjithe operatoret e tjere se bashku.

TABELA III.16: PJESET E TREGUT NE PAJTIMTARE NE VENDET E BE (2015/2016)

	Operatori me i madh	Operatori i dyte	Operatoret e tjere
AT	40.42%	28.98%	30.60%
BG	39.64%	32.25%	28.11%
CH	60.88%	22.18%	16.94%
CY	62.59%	31.99%	5.42%
CZ	39.15%	31.41%	29.44%
DK	36.77%	23.65%	39.58%
EE	39.55%	33.79%	26.66%
ES	31.05%	25.04%	43.91%
FI	39.00%	35.00%	26.00%
IE	38.30%	32.00%	29.70%
IS	35.00%	33.00%	32.00%
IT	32.20%	26.50%	41.30%
LT	42.91%	30.73%	26.36%
LU	52.13%	32.80%	15.07%
LV	35.85%	35.53%	28.62%
ME	38.75%	32.73%	28.52%
FYROM	46.86%	27.11%	26.03%
MT	44.74%	37.94%	17.32%
NL	31.72%	24.82%	43.46%
NO	50.90%	37.99%	11.11%
PT	46.48%	30.35%	23.17%
SE	37.14%	27.47%	35.39%
SK	38.07%	31.33%	30.60%
TR	46.76%	30.06%	23.18%

Burimi: BEREC[29]

[29] http://berec.europa.eu/eng/document_register/subject_matter/berec/reports/6086-termination-rates-at-european-level-january-2016

Sic mund te vihet re nga tabela, në vitin 2015/2016 nga 25 vendet e BEREC qe publikojne pjeset e tregut, në 10 vende operatori lider celular kishte pjesë tregu per pajtimtare ne nivel 40% ose me te larte. Madje edhe ne kater vende te tjera operatori kryesor ka 39% pjese tregu. Ecuria kohore tregon se pjesa e tregut e operatorit kryesor celular ne vendet e BE mesatarisht ka qene ne reduktim, per te arritur ne 36% ne 2012.

Nderkohe nga te dhenat e KE ne Digital Agenda rezulton se tendenca e pjeses se tregut te operatorit lider celular (Mesatarja) ka tendence renese nga 37.9% ne vitin 2009 ne 34.3% ne vitin 2015. Megjithate vihet re se renia eshte vogel (3.6 pike perqindje) si dhe ne vitin 2015 nga 24 vende te BE ne 14 prej tyre pjesa e tregut e operatorit lider celulare varion nga 40% ne 62%.

Ne vendet e BE numri i operatoreve te rrjeteve celulare (MNO) te gjenerates se dyte (2G) zakonisht eshte 3 dhe ne disa vende jane 4 operatore 2G. Hyrjet e reja te operatoreve 2G ne vendet e BE kane qene shume te hershme, nderkohe qe dhenia e autorizimeve/licensave per 3G dhe LTE se fundmi, ka cuar ne rritje te numrit te operatoreve te rrjeteve ne vendet e BE duke cuar ne zakonisht 4 operatore dhe ne disa raste dhe 5-6. Ne 13 vende te BE ka dhe operatore rrjetesh virtuale (MVNO), pjeset e tregut te te cileve kane variacion shume te madh nga 0.8% ne 15%.

Nje tendence e viteve te fundit qe ka lidhje me strukturen e tregjeve celulare ne vendet e BE-se eshte konsolidimi i ketyre tregjeve nepermjet bashkimit apo blerjeve me perthithje (Mergeres and acquisitions) te operatoreve te rrjeteve celulare te cilet kane cuar ne reduktim te numrit te operatoreve te rrjeteve celulare ne disa vende nga 4 ne 3. Rastet me te rendesishme ne bashkim te operatoreve kane qene ne Gjermani, Austri dhe Irlande. Ne vendet e rajonit permendim FYROM, ku operatori nr.2 dhe 3 u bashkuan duke kaluar nga nje structure tregu me 3 operatore rrjetesh ne 2 operatore rrjetesh celulare. Gjithashtu propozime per bashkime te MNO-ve ka pasur dhe ne vend te tjera si UK, Danimarke per kalim nga 4 ne 3 operatore, propozime qe jane ende duke u shqyrtuar nga institucionet perkatese. Ne rastet e miratimit te bashkimeve te MNO-ve, ato jane shoqeruar me masa rregulluese nga autoritetet perkatetese, kryesisht per dhenie aksesi per MVNO dhe hyresve te rinj te mundshem si operator rrjeti celular.

Tendenca e ARPU ne vende te BE dhe Shqiperi

Figura e meposhtme paraqet ecurine e ARPU retail ne vendet e BE dhe ne Shqiperi. Nga figura mund te vihet re se tendencat jane te ngjashme, megjithate:

- Ne nivel absolut ARPU ne Shqiperi eshte shume me ulet se mesatarja ne vendet e BE
- Ne periudhen 2010-2014, ARPU ne vendet e EB eshte reduktuar 23%, ndersa ne Shqiperi norma e reduktimit ne keto 5 vjet eshte 37%

FIGURA III.21: TENDENCA E ARPU NE BE DHE SHQIPERI 2010-2015



III.9. Perfundim per tregun me pakice te sherbimeve celulare

Numri i përdoruesve celularë aktivë në fund të vitit 2015 arriti në 3.4 milion, krahasuar me 3.36 milionë në fund të vitit 2014, një rritje vjetore kjo e moderuar prej 1.2%. Kjo normë ndryshon sipas operatorëve dhe ka vlera pozitive dhe negative, për Telekom Albania dhe Plus është rënëse me 2.8% dhe 15.8 % dhe për Vodafone dhe Albtelecom është rritëse me 4 % dhe 12.2%.

Struktura e perdoruesve celulare sipas menyres se pagimit per sherbimet, me parapagim dhe me paspagim) eshte e fokusuar ne perdoruesit me parapagim. Pas nje reduktimi te ketij proporcioni ne vitet 2011-2012, ne dy vitet e fundit ky raport eshte rritur perseri duke arritur ne 93% ne vitin 2015, dhe ne 95% ne T-III 2016. Ndryshimi i strukturës së përdoruesve celularë vlersohet të ketë ardhur nga politikat tarifore të operatorëve celularë. Prezenca e ofertave tarifore shumë atraktive për përdoruesit me parapagim si dhe eliminimi i grupeve të mbyllura për përdoruesit me kontratë kanë ndikuar në reduktimin e peshës së përdoruesve me paspagim.

Të dhenat periodike sipas tremujorëve tregojnë se ne Tremujorin III 2015 pati nje rritje te ndjeshme te përdoruesve të aksesit broadband në rrjete celulare qe perkon me fillimin ofrimit te shërbimeve me rrjete 4G. Megjithate edhe Tremujori III 2016 paraqet nje rritje te ndjeshme krahasuar me periudhat e meparshme, duke evidentuar efektin sezonal te ketij tremujori qe perkon me sezonin turistik dhe kthimin e perkohshem te emigranteve ne Shqiperi.

ARPM dhe ARPU kanë vazhduar tendencë rënëse dhe për vitin 2015 vlerat e tyre janë reduktuar me 10% dhe 6% respektivisht. Në vitin 2015 një përdorues celular ka paguar mesatarisht 2.83 lek/minutë (me TVSH) për thirrjet telefonike dhe ka shpenzuar mesatarisht 513 lek/muaj (me TVSH) për shërbime celulare.

Niveli i këtyre treguesve në Shqipëri është shumë më i ulët se niveli mesatar në vendet e BE dhe ndër më të ulëtit në rajon. ARPM për Shqipërine ishte në nivelin rreth 1.9 eurocent në 2014 dhe rreth 1.7 eurocent në 2015. ARPU në vitin 2015 në Shqiperi ishte 36.7 euro/vit, që është 23% më e ulët se Letonia me nivelin më të ulët në BE me 47 euro. Niveli mesatar i ARPU në BE në 2013 ishte 162.6 euro apo rreth 4.4 herë më e lartë se ARPU e Shqipërisë në 2015.

Zbatimi i detyrimeve te mos-diskriminimit në tarifat e thirrjeve on-net/off-net të përcaktuara me Vendimet e Analizës së tregut 2014 sollën ndrsyhime të rëndësishme në planet tarifore të operatorëve celularë:

- përfshirjen e sasive të barabarta të minutave brenda rrjetit dhe drejt rrjeteve celulare apo të thirrjeve brenda dhe jashtë rrjetit (pa dallim destinacioni) në pagesat fikse të planeve tarifore me kontratë dhe me parapagim,
- reduktim të ndjeshëm të numrit të ofertave të përkohshme promocionale dhe rritje të numrit të paketave standarde me përfitime më të mëdha për përdoruesit celularë.

Këto ndryshime nga të katër operatorët celularë kanë çuar në rritje të përfitimeve të përdoruesve fundorë, pasi sasia e minutave të përfshira në pagesat fikse është e mjaftueshme dhe duke filluar nga pagesa shumë të ulëta fikse. Ofertat/paketat tarifore mund të mos kenë më thirrje 'pa limit' brenda rrjetit/grupit, por ato kanë sasi të konsiderueshme thirrjesh (qindra deri në mijëra minuta brenda dhe jashtë rrjetit) sa që praktisht në shumë raste mund të konsiderohen pa limit. Pra përdorusit celularë me të njëjtën kosto (pagesë) kanë përfituar sasi të konsiderueshme thirrjesh jashtë rrjetit celular (drejt rrjeteve të tjera celulare). Efektet e këtyre ndryshimeve janë vënë re në sasinë e thirrjeve dhe strukturën e thirrjeve të përdoruesve të katër operatorëve celularë.

Tarifat e aksesit ne internet si per paketat e integruara dhe per paketa vetem me akses ne Internet rezultojne te jene ne nivele te uleta, duke cuar ne rritje te ndjeshme te perdorimit te ketij sherbimi ne rrjetet 3G/4G ne vitet e fundit. Keto tarifa jane te uleta krahasuar edhe me ato te vendeve te tjera, sic evidentohet dhe nga krahasimet e ITU. Zhvillime pozitive jane vene re dhe ne tarifat e sherbimeve te roamingut nderkombetar, ku operatoret celulare nepermjet paketave/opsioneve te vecanta per keto sherbimeve mundesojne perdorimin e tyre me tarifa mesatare me te uleta dhe per perdruesit fundore dhe kontroll me te larte te shpenzimeve nga keta te fundit, per te shmangur faturat teper te larta.

Ndryshimet e planeve/paketave tarifore kane cuar dhe ne rritje te transparences dhe krahasueshmerise se tarifave midis operatoreve te cilat cojne ne rritje te konkurrences midis operatoreve dhe perfitimeve te perdorusve fundore. Ofrimi i paketave te ngjashme dhe te krahasueshme nga te kater operatoret si ne cmime, sasi minutash, Interneti, sherbime te integruara (minuta, SMSdhe internet), afate kohore te konsumit etj, tregojne per sjellje te ngjashme te operatoreve ne tregun me pakice dhe perceptim nga perdoruesit per produkte/sherbime te ngjashme jo te diferencuara midis operatoreve celulare.

Nga te dhenat e ecurisë se strukturës së thirrjeve të përdoruesve celularë sipas destinacionit të thirrjeve në periudhën Janar 2014-Shtator 2016 vihen re ndryshime te mëdha në strukturën e thirrjeve dhe tendencat e rritjes së peshës së thirrjeve off-net (drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare) dhe reduktimin e peshës së thirrjeve brenda rrjetit (on-net). Pesha e thirrjeve off-net është rritur nga 5% në Janar 2014 në 39% në Shtator 2016. Në të njëtën periudhë pesha e thirrjeve on-net është reduktuar nga 90% në Janar 2014 në 58% në Shtator 2016. Ndryshimet më të ndjeshme të strukturës së thirrjeve janë vënë re në Korrik 2015 e në vijim, që përkon me afatin e fillimit të aplikimit të detyrimit të mos-diskriminimit në rrjetet e katër operatorëve celularë.

Të katër operatorët celularë kanë pasur ndryshime të ndjeshme në strukturën e thirrjeve dalëse të përdoruesve të tyre. Raporti i thirrjeve on-net/off-net të operatorit më të madh celular, Vodafone

Albania, ka ndryshuar nga 97%v3% në Janar 2014 në 70% v 30% në Shtator 2016. Për Telekom Albania ky raport ka pësuar ndryshime edhe më të mëdha: nga 96%v 4% në Janar 2014 në 59% v 41% në Shtator 2016.

Të ardhurat e operatorëve celularë në 2015 patën një rritje të moderuar prej 1%, nga 32.7 miliard lek në 2014 në 33.1miliard lek në 2015. Rritjen më të madhe e pati Plus me rreth 20%, dhe një rritje të moderuar prej 1% e pati Telekom Albania. Albtelecom ka qëndruar në nivelin e një viti më parë, ndersa Vodafone pati një renie me 1%. Pjesët e tregut në të ardhura kanë pësuar ndryshime të vogla, Vodafone ka pësuar një rënie prej 1 pikë përqindje dhe Plus ka rritje me po 1 pikë përqindje.

Megjithe ndryshimet e ndjeshme ne tarifat dhe trafikun off-net dhe on-net, si dhe reduktimet e ndjeshme te tarifave te terminimit, te imponuara nga masat rregulluese te AKEP, pjeset e tregut te operatoreve nuk kane pesuar ndryshime te ndjeshme ne keto dy vite. Plus vihet re se ka humbur pjese tregu ne disa tregues si numer perdoruesish dhe Vodafone vazhdon te kete pjesen me te madhe te tregut per shumicen e treguesve. Pjeset e tregut te Vodafone jane rreth nivelit 50% per shume tregues, pervec segmentit te perdoruesve me kontrate, qe ka nje perqendrim me te ulet se te gjithe treguesit e tjere.

Axhenda digitale e KE dhe propozimet e fundit vene ne dukje nevojen per investime shtese ne rrjete fikse me fibra optike si dhe ne rrjetet celulare duke mundesuar akses ne brezin 700 MHz per keto rrjete, per te mdundesuar zhvillimin e rrjeteve celulare 5G, te cilat do te rrisin mbulimin dhe shpejtesine e aksesit ne rrjete broadband.

Rritja e perdorimit dhe cilesise se sherbimit te aksesit broadband ne rrjetet celulare 3G/4G ka cuar ne rritjen e perdorimit te sherbimeve te aplikacioneve OTT (Over The Top). Zhvillimet e aksesit broadband ne rrjete celulare, telefonave smart, OTT kane cuar ne rritje te zevendesueshmerise se sherbimeve zanore dhe SMS nga rrjete celulare me sherbime nga keto aplikacione si dhe kerkese me te larte per kapaciette transmetimi te dhenash ne rrjetet celulare dhe rrjedhimisht ne invetsime me te medha nga operatoret e rrjeteve celulare ne 4G dhe me vone dhe ne 5G. Efektet zevendesuese kane filluar te ndihen keto vite te fundit edhe ne Shqiperi per shkak te rritjes se ndjeshme te perdorimit dhe cilesise se aksesit broadband te mundesuar nga rrjetet 3G dhe sidomos 4G dhe nga rritja e perdorimit te aparateve celulare smart. AKEP vlereson se ky faktor con ne rritje te konkurrences potenciale ne tregun celulare me pakice si dhe njekohesiht ne nevoje per investime me te medha ne rrjete broadband celular per te perballuar kerkesen ne rritje per keto sherbime, perfshire mundesimin e aksesit ne brezat 800 MHz per 4G dhe me vone dhe 700 MHz per 5G.

Ecuria e tregut me pakice ne keto dy vite tregon per rritje te konkurrences dhe perfitimeve te perdoruesve nga sherbimet celulare. AKEP pret qe keto perfitime te vijojne te rriten edhe ne vitet ne vijim dhe te rritet perdorimi i sherbimeve te reja te aksesit broadband nepermjet 4G. Keto vleresime te AKEP per tregun celulare me pakice jane mbi bazen e zbatimit te detyrimeve per FNT ne tregun e terminimit te thirrjeve. Ne mungese te ketyre detyrimeve ecuria dhe vleresimi per tregun me pakice te sherbimeve celulare do te ishte i ndryshem. Perfundimet e AKEP per tregun me pakice jane rivleresuar ne kapitullin V, pas propozimeve per FNT dhe masat rregulluese per terminimin e thirrjeve ne kapitullin IV.

IV. TERMINIMI I THIRRJEVE NË RRJETET CELULARE

Ne raundin e fundit te analizes se tregut celular per terminimin e thirrjeve te kryer ne vitin 2014. AKEP me Vendimet nr.2522-2526, date 06.11.2014, ka shpallur me FNT kater operatoret celulare: Telekom Albania, Vodafone Albania, Albtelecom dhe Plus Communication. Pervec analizes se tregut dhe vendimeve ne 2014, terminimi i thirrjeve ne rrjetet celulare eshte analizuar nga AKEP edhe ne raundin e analizave te mbajtura ne vitin 2006, 2007, 2010 dhe 2012 dhe si i tille edhe ne kete analize dokumenti mbart me vete aspekte teorike dhe arsyetime te trajtuara edhe me pare ne dokumentet e analizave te sipercituara. Ne te gjitha analizat e deritanishme, terminimi i thirrjeve ne rrjete celulare eshte perkufizuar si nje treg perkates per secilin rrjet celular dhe te gjithe operatoret celulare aktive ne treg jane percaktuar me FNT ne ofrimin e terminimit ne rrjetet e tyre celulare.

Komisioni Europian (KE) ne vijim te direktivave te vitit 2002, nxjerr ne menyre periodike rekomandime me listen e tregjeve perkates te dyshuar/justifikuar per nderhyrje dhe rregullim ex-nate nga ana e autoriteteve rregullatore te komunikimeve elektronike ne vendeve anetare te BE. Tregu perkates i terminimit te thirrjeve ne rrjet individual celular, eshte perfshire ne listen e tregjeve perkatese te justifikuar/dyshuar per nderhyrje ex-ante te te gjitha Rekomandimeve te KE, 2003, 2007 dhe se fundmi edhe ne rekomandimin e vitit 2014. Tregjet qe jane pjese e listes se rekomandimeve te KE, indentifikohen si tregje te justifikuar/dyshuar per nderhyrje ex-ante në bazë të aplikimit të testit të tre kritereve. Ky treg perkates eshte njekoheisht pjese e listes se tregjeve perkates te Rregullore se Analizes se Tregut te AKEP, numri 7, dhe i njejte me perkufizimin e tregut perkates ne Rekomandimet e KE, perfshire ate te vitit 2014 (tregu numer 2). Sic eshte theksuar ne kapitullin e pare te ketij dokumenti, bazuar ne percaktimet e Rregullores se Analizes se Tregut, meqenese tregu perkates i terminimit te thirrjeve eshte pjese e listes se Rregullores dhe njekohesiht edhe rekomandimit ne fuqi te KE per tregjet perkates (Rekomandimi i vitit 2014), AKEP nuk k anevoje te kryeje testin e tre kritereve per kete treg.

Ne seksionet ne vijim, AKEP ka analizuar faktoret dhe ndryshimet e ndodhura apo qe priten te ndodhin dhe qe mund te kene ndikim ne perfundimet per perkufizmin e tregut perkates dhe FNT ne treg per terminimin e thirrjeve ne rrjetete celulare.

IV.1. Perkufizimi i tregut te terminimit te thirrjeve ne rrjetet celulare

Sherbimi i terminimit te thirrjeve zanore ne nje rrjet celular eshte nje sherbim interkoneksioni i percaktuar edhe ne oferten reference te operatoreve celulare, si dhe ne Marreveshjet e Interkoneksionit (MI) te lidhura me operatoret celulare, i cili eshte perkufizuar si me poshte:

"Sherbimi i Terminimit ne rjetin e operatorit celular X"

Sherbimi nepermjet te cilit operatori celular X, ne emer te Operatorit Perfitues percjell Thirrjet nga Pika e Interkoneksionit per ne nje Pike fundore te Rrjetit te tij ne Republiken e Shqiperise, te identifikuar nepermjet numrave te abonenteve/pajtimtareve te operatorit celular X.

"Abonent/pajtimtar i rrjetit operatori celular X"*: Abonentet/pajtimtaret qe:*

- *Kane numer celular qe i perket serive numerike 06X[30] xx xxxxx të alokuar nga AKEP operatorit celular X, numer i cili nuk eshte portuar ne rrjetin e nje operatori tjeter, ose*
- *Kane numer qe nuk i perket serive numerike 06YX xx xxxxx te alokuar nga AKEP operatorit celular X, por qe eshte portuar ne rrjetin e operatorit celular X.*

Terminimi i thirrjeve ne rrjetet celulare eshte nje sherbim me shumice, i cili perben nje input te domosdoshem per operatoret e rrjeteve te tjere (fikse dhe celulare) qe t'u ofrojne thirrje perdoruesve te rrjetit te vet drejt perdoruesve te nje rrjeti celular.

Terminimi i thirrjeve ne rrjetet e operatoreve celulare ne Shqiperi eshte kryer dhe kryhet nepermjet interkoneksionit direkt midis operatoreve (Albtelecom-celulare, celular-celular, Nderkombetare-celulare apo celular-operatore alternative), ose nepermjet interkoneksionit indirekt, duke bere tranzitim nepermjet rrjeteve te tjera te cilat mundesojne sherbimin e tranzitimit drejt rrjeteve celulare.

Ne te gjitha raundet e analizave te tregut celular per terminimin e thirrjeve, AKEP ka percaktuar tregje perkatese te vecanta per terminimin e thirrjeve ne secilin rrjet celular te operatoreve aktive ne treg: Telekom Albania, Vodafone Albania, Albtelecom (viti 2010 e ne vijim), dhe Plus Communication (viti 2012 e ne vijim).

Ne analizen e tregut 2012 dhe ne vitin 2014, AKEP ka perfshire ne tregun e terminimit te thirrjeve ne rrjetet celulare vetem thirrjet e origjinuara ne Republiken e Shqiperise, pra terminimi i thirrjeve hyrese nderkombetare nuk perfshihet si pjese e ketij tregu perkates. AKEP vlereson se ne lidhje me kete ceshtje nuk eshte e nevojshme te kryhen ndryshime, pasi kjo zgjidhje eshte analizuar nga AKEP dhe pranuar tashme nga tregu dhe njekohesisht edhe ne vendet e BE tendenca dy viteve te fundit tregon se shume vende anetare te BE kane filluar te trajtojne ne menyre te ndryshme terminimin e thirrjeve hyrese nderkombetare te origjinuara nga vendet anetare te BE dhe EEA (European Economic Area) dhe thirrjet hyrese nderkombetare te origjinuara nag vendet e tjera.

Nder ndryshimet e ndodhura ne tregun e telefonise se levizshme, ne periudhen 2 vjecare pas analizes 2014, dhe qe mund te ndodhin ne periudhe 2-3 vjecare pas kesaj analize tregu dhe qe mund te konsiderohen me ndikim ne perkufizimin e tregut te terminimit te thirrjeve ne rrjetet celulare:

- Proceset e re-farming te brezave te frekuencave 900 dhe 1800 MHz, dhe heqja e kufizimeve teknologjike te perdorimit te ketyre brezave;
- Procese alokimi te frekuencave ne brezat e frekuencave 900, 1800 dhe 2600 MHz gjatë viteve 2015 dhe 2016 dhe procese te tjera qe mund te kryhen ne te ardhmen;
- Fillimi i ofrimit të shërbimeve ne rrjetet LTE-4G ne vitin 2015 dhe mundesia ne te ardhmen e ndertimit e rrjeteve 5G.

Te gjitha keto ndryshime jane te lidhura me brezat e frekuencave dhe standardet te rrjeteve celulare 3G-UMTS, 4G-LTE apo edhe 5G ne te ardhmen, por duke iu referuar dhe rekomandimeve te KE, tregu me shumice i terminimit te thirrjeve zanore ne nje rrjet celular perfshin te gjitha llojet e topologjive te rrjeteve celulare: 2G/GSM, 3G-UMTS edhe 4G-LTE, dhe nuk ndikojne ne perkufizimine tregut perkates.

[30] X=6, 7, 8 ose 9.

AKEP gjykon se gjate kesaj periudhe 2014-2016 dhe ne 2-3 vitet e ardhshme (deri ne nje analize tjeter) nuk kane ndodhur ndryshime apo do te ndodhin ndryshime te tilla qe te ndikojne ne konkluzionet e arritura ne analizen e 2014 ne lidhje me perkufizimin e tregut te terminimit te thirrjeve ne rrjetet celulare, perfshire parimin *Pala Thirrese Paguan (CPP-Calling Party Pays).* Per keto arsye AKEP nuk e konsideron te nevojshme te beje nje analize te testit te tre kritereve apo te produkeve/sherbimeve te perfshira ne kete treg, duke permbledhur sa me poshte:

- Sherbimi i terminimit te thirrjeve zanore ne rrjet celular eshte nje treg i vecante per secilin operator rrjeti celular aktiv ne treg.
- Tregu me shumice i terminimit te thirrjeve zanore ne nje rrjet celular perfshin te gjitha llojet e topologjive/teknologjive/standardeve te rrjeteve celulare: GSM, UMTS dhe LTE, pra perfshire cdo lloj topologjie/teknologjie apo rrjeti celular te mundshem.
- Terminimi i SMS-ve nuk eshte pjese e tregut perkates te terminimit te thirrjeve ne rrjet celular.
- Tregun i terminimit te thirrjeve ne rrjetet celulare perfshin vetem thirrjet e origjinuara ne Republiken e Shqiperise;
- Dimensioni gjeografik i sherbimit te terminimit ne secilin nga rrjetet celulare eshte kombetar, d.m.th territori i Republikes se Shqiperise.

Si perfundim, tregjet perkates te terminimit te thirrjeve ne rrjet individual celulare jane:

- **Tregu i terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetin celular Telekom Albania, sherbim i ofruar nga sipermarresi Telekom Albania sh.a.**
- **Tregu i terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetin celular Vodafone Albania, sherbim i ofruar nga sipermarresi Vodafone Albania sh.a.**
- **Tregu i terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetin celular Albtelecom, sherbim i ofruar nga sipermarresi Albtelecom sh.a.**
- **Tregu i terminimit te thirrjeve ne rrjetin celular Plus Communication, sherbim i ofruar nga sipermarresi Plus Communication sh.a.**

IV.2. Analiza per Fuqi te Ndjeshme ne Treg

Sipas perkufizimit te tregjeve perkates te terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetet individuale celulare, terminimi i thirrjeve eshte monopol natyror dhe çdo operator celular eshte monopolist ne ofrimin e sherbimit te terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetin e vet. AKEP ne dokumentet e meparshme te analizave te zhvilluara per kete treg, duke i'u referuar edhe dokumentave shpjegues te KE per Rekomandimin e tregjeve perkates SWD(2014) 298, Commission Staff Working Document Explanatory Note[31]), ka analizuar si faktore te rendesishem per FNT ne tregjet e terminimit:

[31]A market definition for call termination on each network ëould imply that currently each network operator is a single supplier on its respective termination market, which suggests that each operator has a 100% market share. While a 100% market share provides a very strong presumption of SMP, in accordance with competition law principles, a finding that there is no SMP may occur if there is sufficient countervailing buyer power, which would render any non-transitory price increase unprofitable.

- pjeset e tregut;
- konkurrenca e mundshme;
- fuqia kundervepruese e bleresve te sherbimit;
- tarifimi i sherbimit te terminimit.

Tre faktoret e pare nuk kane pasur ndryshime dhe nuk pritet te kene ndryshime deri ne nje analize tjeter te ketij tregu, pasi:

- secili operator celular ka 100% pjese tregu ne ofrimin e sherbimit te terminimit ne rrjetin e vet, qe vjen nga perkufizimi i tregut perkatese te terminimit, dhe kjo nuk pritet te ndryshoje ne te pakten 2-3 vitet e ardhshme, pavaresisht ndryshimeve te ndodhur dhe te pritshme teknologjike;
- Asnje operator celular, nuk kercenohet nga operatore te tjere te mundshem qe te hyjne ne tregun individual te secilit prej tyre dhe te ofrojne sherbimin e terminimit te thirrjeve ne rrjetin e nje operatori tjeter celulare, pasi ky sherbim mund te ofrohet vetem nga operatori i rrjetit perkates;
- Asnje nga kater operatoret celulare nuk ndeshet dhe nuk pritet te ndeshet me fuqi kundervepruese nga operatore te tjere qe te kufizoje fuqine e ndjeshme te secilit prej tyre ne percaktimin e tarifes se terminimit te rrjeteve respektive celulare, ne mungese te rregullimit te tarifave te terminimit nga AKEP (me vendime te vecanta sipas statusit se FNT apo nepermjet procedurave te zgjidhjeve te mosmarreveshjeve).

Ecuria e tarifave te terminimit ne rrjetet celulare

Niveli i tarifave të terminimit në rrjetet celulare ka qene objekt rregullimi nga AKEP (më parë ERT) që nga viti 2006. Rregullimi i këtyre tarifave nga AKEP deri në vitin 2010 është kryer duke përdorur nivelin mesatar të tarifave të terminimit në vendet e BE, dhe duke filluar nga viti 2010, ky rregullim është kryer bazuar në reduktimin e përshkallëzuar për orientimin në kosto drejt vlerës së nxjerrë nga modeli BU-LRAIC[32] i ndërtuar në vitin 2010 nga AKEP me konsulencë ndërkombëtare.

AKEP me Vendimin nr.1505, datë 10.02.2011, miratoi dokumentin për orientimin e tarifave të terminimit në kostot BULRAIC, duke përcaktuar një grafik për reduktimin e përshkallëzuar (glide path) të tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet e katër operatorëve celulare (tarifat për Plus ishin rekomanduese, pasi Plus nuk kishte status me FNT në kohën e vendim-marrjes). Vendimet 1506-1508, përcaktuan tarifat e terminimit të thirrjeve në mënyrë individuale për Telekom Albania, Vodafone Albania dhe Albtelecom.

Në dokumentin e Analizes së tregut celular, miratuar më 4.07.2012, dhe me vendimet përkatëse të FNT, AKEP ka miratuar nivelin e tarifave të terminimit të katër operatorëve celularë deri në vitin 2015 apo deri në një vendim-marrje tjetër. Tarifat e përcaktuara me vendimet 2118-2122, datë 4.07.2012 ishin të njëjta me Vendimet 1505-1508, duke konfirmuar reduktimin e përshkallëzuar të vendosur në Shkurt 2011, me disa ndryshime për operatorin Plus Communication.

[32] Bottom-Up Long Run Average Incremental Cost (Model Poshtë-Lart i Kostos Mesatare Inkrementale Afatgjatë)

Sipas vendimeve të mësipërme tarifat e terminimit të Telekom Albania, Vodafone dhe Albtelecom janë reduktuar dhe më 1.09.2013 kanë arritur nivelin e kostos 4.57 lek/minutë, ndërsa për Plus me vendimet e dates 4.07.2012 u vendos qe tarifa e terminimit te arrijë nivelin 4.57 lek/minutë më 1.09.2015.

AKEP me vendimet nr.2431-2435, date 13.03.2014, vendosi qe tarifat e terminimit te kater operatoreve te reduktoheshin gradualisht duke filluar nga 1.04.2014 per te arritur ne nivelin 1.48 lek/minute ne 1.01.2016, e cila eshte sa vlera mesatare e tarifave te terminimit ne vendet Evropiane qe kane aplikuar LRIC te paster ne vitin 2013.

Bazuar në gjetjet e analizes se tregut 2014, AKEP me Vendimet nr.2522-2526, datë 06.11.2014, percaktoi qe tarifa 1.48 lek/minute te fillonte te aplikohej qe prej dates 1.12.2014 per Vodafone, Telekom Albania dhe Albtelecom, ndersa tarifa e terminimit ne rrjetin Plus te qendronte ne vleren 6.52 lek/minute deri ne nje vendim tjeter te AKEP.

Bazuar ne procesin e shqyrtimit te ankimeve administrative te kater operatoreve celulare per vendimet e dates 6.11.2014, AKEP me Vendimin nr.2542, datë 13.03.2015, ndryshoi tarifen e terminimit ne rrjetin Plus (te percaktuar me vendimet e dates 6.11.2014), duke percaktuar nje glidepath (reduktim te pershkallezuar) ne menyre qe tarifa e terminimit ne rrjetin Plus te arrinte nivelin 1.48 lek/minute me date 1.01.2016. Reduktimi u percaktua te kryhej me dy faza te ndermjetme qe fillonin me 1.04.2015 dhe 1.07.2015.

AKEP në vijim të Vendimeve për monitorim të situates ne treg, bazuar në vlerësimin e rrethanave konkrete në treg, me VKD nr.2664, datë 14.01.2016, njoftoi operatoret për një pezullim 90 ditor në lidhje me fillimin e aplikimit të simetrisë me datë 1.01.2016.

AKEP me Vendim nr.2676, datë 14.04.2016, miratoi mbylljen e procesit te filluar me VKD 2664 dhe miratimin e rezultateve, duke vendosur datën 1 Prill 2016 si datë për vendosjen e simetrisë së MTR-ve për të gjithë operatorët.

Proceset gjyqesore

Sipermarresi Plus Communication sh.a ankimoi ne rruge gjyqesore Vendimin nr.2542, date 13.03.2015 duke kerkuar shfuqizimin e ndryshimeve te kryera nepermjet ketij vendimeve per tarifen e terminimit te thirrjeve ne rrjetin Plus dhe afatin e fillimit te aplikimit te detyrimit te mos-diskriminimit ne tarifat e thirjeve on-net dhe off-net.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr.1567 datë 1.04.2016 ka pranuar kërkesë padine e Plus Communication. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me Vendimin Nr.2459 datë 9.09.2016, ka lene ne fuqi vendimin të Gjykates Administrative të Shkallës së Parë, Tirane.

AKEP ka depozituar në Gjykatën e Lartë recurs në lidhje me Vendimin Nr.2459 datë 9.09.2016 të Gjykatës Administrative e Apelit Tiranë dhe është në pritje të sqarimeve nga Gjykata e Lartë.

Vodafone, Telekom Albania dhe Albtelecom ankimuan Vendimin 2664/2016 dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin Nr.80-2016-4342, datë 26.09.2016, pranoi kerkese padine e tre operatoreve. AKEP ka apeluar kete vendim ne Gjykaten Administrative te Apelit Tiranë dhe eshte ne pritje te vendimit te kesaj gjykate.

Plus Communication ankimoi ne rruge gjyqesore Vendimin 2676/2016 dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr. 80-2016-5079, datë 31/10/2016, pranoi kerkese padine e Plus. AKEP ka apeluar kete vendim ne Gjykaten Administrative te Apelit Tiranë dhe eshte ne pritje te vendimit te kesaj gjykate.

Sic mund te vihet re proceset gjyqesore kane krijuar dhe nje konfuzion ne lidhje me tarifat qe duhet te aplikohen per terminimin e thirrjeve ne rrjetin Plus, nga data 1.04.2015 e ne vijim. AKEP nuk ka te drejte te kryeje interpretim te vendimeve te gjyqesorit dhe ka orientuar palet ne gjetjen e zgjidhjeve sipas percaktimeve te ligjeve perkatese.

Ecuria dhe krahasimi i tarifave te terminimit celular me vendet e BE/BEREC

Figura e meposhtme paraqet ecurine e tarifave te terminimit ne rrjetet celulare te kater operatoreve per periudhen Mars 2008 deri ne vitin 2016, sipas vendimeve te AKEP deri me 14.04.2016, si dhe krahasimin e ketyre tarifave në Shqipëri me tarifat mestare ne vendet e BE dhe BEREC per periudhen 2008-2016.

FIGURA IV.1: TARIFAT Ë TERMINIMIT NË VENDET E BE DHE RAJONIT DHE SHQIPËRI (2008-2016)



	Mars 2008	1.09.2008	1.09.2009	Nentor 2010	1.03.2011	1.09.2011	1.09.2012	1.09.2013	1.04.2014	1.12.2014	1.04.2015	1.07.2015	1.04.2016
Telekom, Vodafone	15.25	11.95	10.5	10.5	8.85	7.57	6.10	4.57	2.66	1.48	1.48	1.48	1.48
Albtelecom (EM)	17	13.32	12.92	12.92	10.89	8.85	6.52	4.57	4.00	1.48	1.48	1.48	1.48
Plus Communications				18.9	18.9	18.9	12.92	8.85	6.52	6.52	4.00	2.66	1.48
BEREC 34 avg. (s)	12.63	12.18	10.96	8.50	6.87	6.23	5.00	3.09	2.76	2.37	2.17	2.13	1.97
BEREC 34 avg. (w)	12.33	12.24	11.09	7.91	6.24	5.24	3.86	2.04	1.85	1.72	1.72	1.71	1.64
EC EU28 (s)												1.59	1.48
EC EU28 (W)												1.60	1.55

Burimi: AKEP, BEREC, Kursi I kembimit i perdorur: 1 Euro=140 lek

Sic mund të vihet re, tarifat e terminimit te thirrjeve ne rrjetet celulare te dy operatoreve me te medhenj ne Shqiperi kane qene afër nivelit mesatar të vendeve te BE ne vitet 2008 deri sa barazohen ne vitin 2014, duke pasur nje diference me te madhe ne 2013 me vendet e BE dhe BEREC. Diferenca me e larte me vendet e BEREC dhe BE ne 2013 ka ardhur per shkak të reduktimeve të mëdha në vendet e BE dhe rajonit, në 2013, per orientimin ne kostot LRIC te paster. Reduktimet e AKEP te përcaktuara me Vendimet e datës 13.03.2014 e në vijim, per orientimin ne kostot LRIC te paster, duke perdorur te dhena benchmark, cojnë:

- Në Prill 2014 dhe Prill 2015 tarifat e terminimit të Vodafone dhe Telekom Albania barazohen me tarifat mesatare në 34 vendet e raportuara nga BEREC në Janar dhe Korrik 2013 (tarifa e terminimit ne Prill 2014 per keta dy operatore eshte pothuajse e njejte me tarifen mesatare ne vendet e BE ne Janar 2014);

- Në Prill 2016 tarifat e të katër operatorëve celularë barazohen me tarifën mesatare në vendet e BE dhe rajonit (të referuara nga BEREC) që kanë aplikuar LRIC të pastër në 2013.

Duke iu referuar ecurise se tarifave ne periudhen 2012 deri aktualisht si edhe ne periudhen para vitit 2012, vihet re se reduktimet ne vite te tarifes se terminimit ne rrjetet celulare, perafrimi i tarifes se terminimit me nivelet mesatare te BE, dhe percaktimet per orientim ne kosto te tyre(BULRAIC dhe benchmark sipas mesatares se vendeve Evropiane me LRIC te paster) nuk kane ardhur si pasoje e presionit konkurrues ne tregjet perkatese te terminimit te thirrjeve ne rrjetet celulare, por per shkak te nderhyrjes se AKEP nepermjet procedurave te zgjidhjeve te mos-marreveshjeve, implementimit te metodologjive te rregullimit te tarifave si edhe orientimit ne kosto. Ne mungese te nderhyrjes rregullatore, operatoret celulare do te ishin dhe do jene ne gjendje t'u impononinoperatoreve vendas tarifa me te larta per terminimin e thirrjeve ne rrjetet e tyre celulare. AKEP ka percaktuar nivelin maksimal te tarifave dhe asnje operator nuk ka aplikuar tarife me te ulet se vlera maksimale e imponuar nga AKEP.

Referuar dokumentave rregullatore te KE-se, dhe se fundmi edhe dokumentit te BEREC *BoR (16) 159, 'BEREC Report Regulatory Accounting in Practice 2016' 6 October 2016* rezulton se te te gjithe operatoret e rrjeteve celulare aktive ne treg jane percaktuar si operatore me FNT per terminimin e thirjeve zanore ne rrjetet e tyre., dhe ne disa vende edhe MVNO-te jane percaktuar me FNT per kete sherbim.

Perfundim mbi FNT

Ne analizen e faktoreve te marre ne konsiderate per fuqine e ndjeshme ne tregjet perkatese, rezulton se nuk ka ndryshime nga analiza e meparshme 2014:

- Secili prej operatoreve Telekom Albania, Vodafone Albania, Albtelecom (Eagle Mobile) dhe Plus Communication zoteron 100 % te tregut te terminimit te thirrjeve ne rrjetet e tyre;
- Operatoret celulare nuk perballen me kercenimin e hyrjes ne tregjet e tyre te terminimit te operatoreve te tjere, qe do te ishin te afte te kryenin edhe terminimin e thirrjeve ne keto rrjete;
- Operatoret celulare ndeshen me fuqi te ulet kundervepruese nga operatoret e tjere te telefonise se levizshme dhe te telefonise fikse;

- Ne mungese te nderhyrjes rregullatore, cdo operator celular do te jete ne gjendje t'ju impononte operatoreve vendas tarifa te larta per terminimin e thirrjeve ne rrjetin celular qe zoteron.
- Kriteret e marra ne shqyrtim nuk kane ndryshuar dhe nuk pritet te ndryshojne te pakten ne nje periudhe afatmesme 2-3 vjecare, ne menyre qe te eliminojne aftesine ndikuese te operatoreve ne tregjet perkates te terminimit te thirrjeve.

Duke marre ne konsiderate faktoret (argumentat) e mesiperm, AKEP vlereson se kater operatoret celulare permbushin kriteret per fuqi te ndjeshme ne tregjet perkatese te terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetet e tyre celulare:

- **Sipermarresi Telekom Albania sh.a permbush kriteret per FNT ne tregun e terminimit te thirrjeve ne rrjetin celular Telekom Albania.**
- **Sipermarresi Vodafone Albania sh.a permbush kriteret perFNT ne tregun e terminimit te thirrjeve ne rrjetin celular Vodafone Albania.**
- **Sipermarresi Albtelecom sh.a permbush kriteret perFNT ne tregun e terminimit te thirrjeve ne rrjetin celular Albtelecom.**
- **Sipermarresi Plus Communication sh.a permbush kriteret per FNT ne tregun e terminimit te thirrjeve ne rrjetin celular Plus Communication.**

IV.3. MASAT RREGULLUESE

Nga analiza per FNT ne tregun e terminimit te thirrjeve ne rrjetet e telefonise celulare ne kapitullin IV te ketij dokumenti, rezulton se permbushen kriteret per FNT (dominance individuale) ne tregun perkates te secilit nga rrjetet celulare aktive ne Shqiperi, Telekom Albania, Vodafone Albania, Albtelecom (Eagle Mobile) dhe Plus Communication.

Ne baze te parashikimeve te ligjit, **neni 34**: *Nëse AKEP-i përcakton se një ose disa sipërmarrës kanë fuqi të ndjeshme në treg, në tregun përkatës, pra nuk ka konkurrencë efektive, atëherë ajo vendos ndaj tyre një, disa ose të gjitha detyrimet e veçanta të nevojshme, të cilësuara në nenet 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45 e 56 të këtij ligji*.

Detyrimet qe mund te vendosen ne lidhje me sherbimin e terminimit te thirrjeve ne rrjetin celular te Telekom Albania, Vodafone Albania, Eagle Mobile dhe Plus Communication, jane :

- Mosdiskriminimi (neni 39),
- Transparenca (neni 40),
- Dhenie Akses dhe Interkoneksion dhe perdorimi i perbashket i faciliteteve te rrjetit (neni 42),
- Kontrolli i tarifave dhe sistemi i mbajtjes se llogarive(neni 45)
- Ndarja e llogarive (neni 41)

Nderkohe nenet 55-59, permbajne percaktime ne lidhje me detyrimet per kontrollin dhe rregullimin e tarifave dhe zbatimin e tyre.

Ne vendosjen e detyrimeve, AKEP duhet te mbaje parasysh objektivat rregullatore dhe detyrimet ndaj operatoreve me FNT, duhet te jene proporcionale me masen e problemit dhe te mos jene barre e tepert per operatorin.

AKEP bazuar ne gjetjet e analizes se vitit 2014 nepermjet Vendimeve 2522-2526, date 14.11.2014, te ndryshuara me Vendimin 2542, date 13.03.2015, ka percaktuar masat rregullatore ndaj operatoreve me FNT ne tregun e terminimit te thirrjeve, ne reference te Ligjit 9918 dhe kuadrit rregullator, qe ne permbledhje jane:

1. Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 39)
2. Detyrimi i transparencës (Neni 40)
3. Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42)
4. Detyrimi për kontroll të tarifave (Neni 45)

AKEP kapitujt III dhe IV ka analizuar efektet ne tregun me pakice te masave rregulluese te vendosura sipas analize 2014 dhe me pare. AKEP vlereson se te kater operatoret te vazhdojne te kene te njejtat detyrime per FNT ne terminimin e thirrjeve si edhe masat rreguluese te percaktuara ne Vendimet e dates 6.11.2016, te ndryshuara.

Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 39)

Ky detyrim i percaktuar dhe pershkruar ne nenin 39 te Ligjit, per FNT ne terminimin e thirrjeve, do te vijoje te zbatohet sipas percaktimeve te kryera ne analizat e meparshme, si dhe ne analizen e vitit 2014, dhe perfshin edhe detyrimin e mos-diskriminimit ne tarifat me pakice te thirrjeve on-net/off-net. AKEP gjykon se vazhdimi i zbatimit te kesaj mase eshte i nevojshem, pasi pavaresisht ndryshimeve te ndjeshme ne strukturen e thirrjeve celulare, te evidentuara ne kete dokument, ne mungese te ketij detyrimi operatoret celulare do te kishin stimulin e rikthimit ne praktikat tarifore te meparshme. Kjo theksohet akoma me shume nga fakti se megjithe ndryshimet e vena re ne strukturen e thirrjeve dhe rritjen e ndjeshme te thirrjeve off-net, pjeset e tregut ne treguesit kryesore nuk kane pesuar ndryshime te ndjeshme. Sic eshte theksuar ne vendimet e meparshme kjo mase rregulluese perfshin detyrimet e meposhtme:

Sipermarrësi X ndalohet të aplikojë tarifa në nivel me pakicë që kanë efekt diskriminues për sipërmarësit e rrjeteve të tjera celulare kombëtare:

(1) tarifat e thirrjeve drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare nuk duhet të jenë më të larta se tarifat e thirrjeve brenda rrjetit;
(2) Sasia e minutave brenda rrjetit të përfshira në oferta/pagesë fikse të paketave tarifore nuk duhet të jetë më e madhe se sasia e minutave drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare;
(3) Përcaktimet e pikave 1 dhe 2 më sipër aplikohen për të gjitha paketat tarifore standarte, ofertat, shportat, opsionet dhe skontot të ofruara për pajtimtarët;

Detyrimi per aplikim te tarifave te njejta me pakice on-net/off-net nenkupton qe edhe ofertat/shportat/opsionet apo skontot ne teresi duhet te kene nivel te njejte on-net/off-net: tarifa dhe/ose sasi minutash te perfshira ne oferte/pagese fikse.

Njekohesisht AKEP propozon qe te vijoje edhe aplikimi i masave te tjera rregulluese per kohezgjatjen e ofertave sipas percaktimeve ne analizen e vitit 2014, pasi edhe kjo mase ka dhene efekt ne reduktimin e numrit teper te madh te ofertave te operatoreve celuare qe krijonin konfuzion dhe pasiguri tek perdoruesit fundore.

Aplikimi i detyrimit te mesiperm eshte i drejtperdrejte, i thjeshte dhe me efikas dhe me proporcional se lidhja e tarifes se terminimit me tarifen mesatare on-net.

Detyrimi për kontroll i tarifave (Neni 45)

AKEP në analizën e fundit te tregut celular ka dhene detaje per procesin e rregullimit te tarifave te terminimit dhe metoden e rregullimit te tyre, perfshire zbatimin e Rekomandimit te Komisionit Europian të datës 7 Maj 2009 (2009/396/EC),[33] nepermjet metodes benchmark me tarifen mesatare te vendeve qe kane aplikuar metodën e kostove BU-LRIC e pastër.

AKEP gjykon se masa rregulluese e kontrollit te tarifave te terminimit te kater operatoreve me FNT eshte e nevojshme, pasi ne mungese te saj secili operator, qe eshte monopolist ne ofrimin e terminimit te thirrjeve ne rrjetin e vet, do kishte stimujt per te aplikuar tarifa te larta terminimi ne dem te konkurrences dhe interesave te konsumatoreve. Vlen te theksohet se ne gjithe proceset e analizave te tregut celulare, vendosja e kesaj mase rregulluese nuk ka pasur kundershtime nga operatoret. Operatoret kane kundershtuar nepermjet komenteve, ankimeve administrative apo ne rruge gjyqesore kryesisht nivelin e tarifes se terminimit te percaktuar nga AKEP, por jo vete masen rregulluese te kontrollit/rregullimit te kesaj tarife.

Sic eshte theksuar ne hyrje te dokumentit te analizes, ky dokument nxirret ne keshillim publik ne lidhje me perfundimet e AKEP per perkufizimin e tregjeve, FNT dhe masat rregulluese te propozuara per FNT. Ne lidhje me metoden e kontrollit te tarifave te terminimit te sipermarresve te propozuar per status me FNT, AKEP do te zhvilloje nje proces te vecante keshillimi publik, ne perputhje me percaktimet e nenit 57 e ne vijim te Ligjit 9918. Ky proces do te kryhet se shpejti dhe paralelisht me keshimin publik te ketij dokumenti ne javet ne vijim.

[33] *COMMISSION RECOMMENDATION of 7 May 2009 on the Regulatory Treatment of Fixed and Mobile Termination Rates in the EU (2009/396/EC)*

V. Perfundim

AKEP nepermjet ketij dokumenti te analizes se tregut celular per keshillim publik ka evidentuar zhvillimet ne tregun celular me pakice ne Shqiperi dhe tendencat per te ardhmen si dhe ka analizuar tregun perkates me shumice te thirrjeve ne rrjetet individuale celulare.

Zhvillimet ne tregun celular me pakice ne Shqiperi ne keto vite te fundit jane analizuar ne terma te ecurises se perdorimit te sherbimeve, struktures se thirrjeve celulare, tarifave te perdorusve fundore, tregues financiare te kompanive celulare si dhe pjeset e tregut te tyre. Gjithashtu AKEP ka shqyrtuar efektet e masave rregulluese te percaktuara ne analizen e meparshme te tregut per terminimin e thirrjeve ne tregun me pakice celular.

Zbatimi i detyrimeve te mos-diskriminimit në tarifat e thirrjeve on-net/off-net të përcaktuara me Vendimet e Analizës së tregut 2014 sollën ndryshime të rëndësishme në planet tarifore të operatorëve celularë:

- përfshirjen e sasive të barabarta të minutave brenda rrjetit dhe drejt rrjeteve celulare apo të thirrjeve brenda dhe jashtë rrjetit (pa dallim destinacioni) në pagesat fikse të planeve tarifore me kontratë dhe me parapagim,
- reduktim të ndjeshëm të numrit të ofertave të përkohshme promocionale dhe rritje të numrit të paketave standarde me përfitime më të mëdha për përdoruesit celularë.

Këto ndryshime nga të katër operatorët celularë kanë çuar në rritje të përfitimeve të përdoruesve fundorë, pasi sasia e minutave të përfshira në pagesat fikse është e mjaftueshme dhe duke filluar nga pagesa shumë të ulëta fikse. Ofertat/paketat tarifore mund të mos kenë më thirrje 'pa limit' brenda rrjetit/grupit, por ato kanë sasi të konsiderueshme thirrjesh (qindra deri në mijëra minuta brenda dhe jashtë rrjetit) sa që praktisht në shumë raste mund të konsiderohen pa limit. Pra përdorusit celularë me të njëjtën kosto (pagesë) kanë përfituar sasi të konsiderueshme thirrjesh jashtë rrjetit celular (drejt rrjeteve të tjera celulare). Efektet e këtyre ndryshimeve janë vënë re në sasinë e thirrjeve dhe strukturën e thirrjeve të përdoruesve të katër operatorëve celularë.

Nga te dhenat e ecurisë se strukturës së thirrjeve të përdoruesve celularë jane vene re ndryshime te mëdha në strukturën e thirrjeve dalese: rritje e peshës së thirrjeve off-net (drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare) dhe reduktimi i peshës së thirrjeve brenda rrjetit (on-net). Pesha e thirrjeve off-net ne totalin e thirrjeve dalese është rritur nga 5% në Janar 2014 në 39% në Shtator 2016. Në të njëjtën periudhë pesha e thirrjeve on-net është reduktuar nga 90% në në 58%. Raporti i thirrjeve on-net/off-net të operatorit më të madh celular, Vodafone Albania, ka ndryshuar nga 97% v 3% në Janar 2014 në 70% v 30% në Shtator 2016.

ARPM dhe ARPU kanë vazhduar tendencën rënëse dhe për vitin 2015 vlerat e tyre janë reduktuar me 10% dhe 6% respektivisht. Në vitin 2015 një përdorues celular ka paguar mesatarisht 2.83 lek/minutë (me TVSH) për thirrjet telefonike dhe ka shpenzuar mesatarisht 513 lek/muaj (me TVSH) për shërbime celulare.

Niveli i këtyre treguesve në Shqipëri është shumë më i ulët se niveli mesatar në vendet e BE dhe ndër më të ulëtit në rajon. ARPM për Shqipërine ishte në nivelin rreth 1.9 eurocent në 2014 dhe

rreth 1.7 eurocent në 2015. ARPU në vitin 2015 në Shqiperi ishte 36.7 euro/vit, që është 23% më e ulët se Letonia me nivelin më të ulët në BE me 47 euro. Niveli mesatar i ARPU në BE në 2013 ishte 162.6 euro apo rreth 4.4 herë më e lartë se ARPU e Shqipërisë në 2015.

Të ardhurat e operatorëve celularë në 2015 patën një rritje të moderuar prej 1%, nga 32.7 miliard lek në 2014 në 33.1miliard lek në 2015. Rritjen më të madhe e pati Plus me rreth 20%, dhe një rritje të moderuar prej 1% e pati Telekom Albania. Albtelecom ka qëndruar në nivelin e një viti më parë, ndersa Vodafone pati një renie me 1%. Pjesët e tregut në të ardhura kanë pësuar ndryshime të vogla, Vodafone ka pësuar një rënie prej 1 pikë përqindje dhe Plus ka rritje me po 1 pikë përqindje.

Megjithe ndryshimet e ndjeshme ne tarifat dhe trafikun off-net dhe on-net, si dhe reduktimet e ndjeshme te tarifave te terminimit, te imponuara nga masat rregulluese te AKEP, pjeset e tregut te operatoreve nuk kane pesuar ndryshime te ndjeshme ne keto dy vite. Plus vihet re se ka humbur pjese tregu ne disa tregues si numer perdoruesish dhe Vodafone vazhdon te kete pjesen me te madhe te tregut per shumicen e treguesve. Pjeset e tregut te Vodafone jane rreth nivelit 50% per shume tregues, pervec segmentit te perdoruesve me kontrate, qe ka nje perqendrim me te ulet se te gjithe treguesit e tjere.

Axhenda digitale e KE dhe propozimet e fundit vene ne dukje nevojen per investime shtese ne rrjete fikse me fibra optike si dhe ne rrjetet celulare duke alokuar frekuenca ne brezin 700 MHz per keto rrjete, per te mundesuar zhvillimin e rrjeteve celulare 5G, te cilat do te rrisin mbulimin dhe shpejtesine e aksesit ne rrjete broadband.

Rritja e perdorimit dhe cilesise se sherbimit te aksesit broadband ne rrjetet celulare 3G/4G ka cuar ne rritjen e perdorimit te sherbimeve te aplikacioneve OTT (Over The Top). Zhvillimet e aksesit broadband ne rrjete celulare, telefonave smart, OTT kane cuar ne rritje te zevendesueshmerise se sherbimeve zanore dhe SMS nga rrjete celulare me sherbime nga keto aplikacione si dhe kerkese me te larte per kapaciette transmetimi te dhenash ne rrjetet celulare dhe rrjedhimisht ne invetsime me te medha nga operatoret e rrjeteve celulare ne 4G dhe me vone dhe ne 5G. Efektet zevendesuese kane filluar te ndihen keto vite te fundit edhe ne Shqiperi per shkak te rritjes se ndjeshme te perdorimit dhe cilesise se aksesit broadband te mundesuar nga rrjetet 3G dhe sidomos 4G dhe nga rritja e perdorimit te aparateve celulare smart.

AKEP vlereson se ky faktor con ne rritje te konkurrences potenciale ne tregun celulare me pakice si dhe njekohesiht ne nevoje per investime me te medha ne rrjete broadband celular per te perballuar kerkesen ne rritje per keto sherbime, perfshire mundesimin e aksesit ne brezat 800 MHz per 4G dhe me vone dhe 700 MHz per 5G.

Perfundime te analizes se terminimit te thirrjeve ne rrjetet celulare:

Duke marre ne konsiderate faktoret (argumentat) per FNT ne tregun perkates te terminimit thirrjeve, AKEP vlereson se kater operatoret celulare permbushin kriteret per fuqi te ndjeshme ne tregjet perkatese te terminimit te thirrjeve zanore ne rrjetet e tyre celulare:

- **Sipermarresi Telekom Albania sh.a permbush kriteret per FNT ne tregun e terminimit te thirrjeve ne rrjetin celular Telekom Albania.**

- **Sipermarresi Vodafone Albania sh.a permbush kriteret perFNT ne tregun e terminimit te thirrjeve ne rrjetin celular Vodafone Albania.**
- **Sipermarresi Albtelecom sh.a permbush kriteret perFNT ne tregun e terminimit te thirrjeve ne rrjetin celular Albtelecom.**
- **Sipermarresi Plus Communication sh.a permbush kriteret per FNT ne tregun e terminimit te thirrjeve ne rrjetin celular Plus Communication.**

Kriteret e marra ne shqyrtim per FNT pwr terminimin e thirrjeve nuk kane ndryshuar dhe nuk pritet te ndryshojne te pakten ne nje periudhe afatmesme 2-3 vjecare, ne menyre qe te eliminojne aftesine ndikuese te operatoreve ne tregjet perkates te terminimit te thirrjeve ne rrjetet e tyre individuale.

AKEP propozon qe operatoret celulare te vijojne zbatimin e masave rregulluese te percaktuara nga analiza e meparshme, perfshire detyrimin e mos-diskriminimit ne tarifat e thirrjeve on-net/off-net. Ky detyrim i fundit ka pasur efekt te dukshem ne treg duke rritur edhe aftesisne konkurruse te operatoreve me te vegjel celulare ne tregun me pakice per shkak te eleminimit te efekteve 'club' te krijuara nga diferencat e medha ne tarifat e thirrjeve on-net dhe off-net.

AKEP propozon qe masa rregulluese e kontrollit te tarifave te terminimit te kater operatoreve me FNT eshte e nevojshme per tu zbatuar edhe ne vitet ne vijim, pasi masat e tjera rregulluese nuk jane te mjaftueshme per te eliminuar FNT ne terminimin e thirrjeve si dhe ne mungese te kesaj mase rregulluese, secili operator, qe eshte monopolist ne ofrimin e terminimit te thirrjeve ne rrjetin e vet, do kishte stimujt per te aplikuar tarifa te larta terminimi ne dem te konkurrences dhe interesave te konsumatoreve.

Perfundim per Tregun me Pakice

Nga analiza rezulton se tregu me pakice celular ka sjelle rritje te perfitimeve te perdoruesve fundore nga konsumi i sherbimeve celulare ne terma te rritjes se perdorimit te sherbimeve celulare sidomos te dhena (Internet) ne rrjetet 4G, tarifa me te lira dhe pa diskriminim ne thirrjet brenda dhe jashte rrjetit, rritje te krahasueshmerise/transparences se tarifave, si dhe me shume zgjedhje ne paketa sipas cmimit, sasise dhe afatit te perdorimit te paketave ne sektorin me parapagim. Ecuria e tregut me pakice ne keto dy vite tregon per rritje te konkurrences dhe perfitimeve te perdoruesve nga sherbimet celulare. AKEP pret qe keto perfitime te vijojne te rriten edhe ne vitet ne vijim dhe te rritet perdorimi i sherbimeve te reja te aksesit broadband nepermjet rrjeteve 4G.

Masat e marra ne nivel me shumice per terminimin e thirrjeve vleresohet se kane pasur efekt pozitiv ne treg dhe vazhdimi i zbatimnit te tyre, se bashku me masat e tjera rregulluese per operatoret celulare si dhe nderhyrjet e mundshme ex-post te AK, vleresohet te jene te mjaftueshme per te adresuar problematikat e mundshme qe mund te shfaqen ne tregun me pakice.

Ne lidhje me problematiken e diferencave te medha ne tarifat per njesi komunikimi dhe paketave/ofertave, AKEP vlereson se megjithese tarifimi per njesi komunikimi pa aktivizuar ofertat/paketat aplikohet per sasi te vogla komunikimi, ai ka nevoje per adresim. Ne analizen e vitit 2014, AKEP evidentoi si problematike keto diferenca, por megjithe ndryshimet positive te vena re ne tarifat e sherbimeve celulare, ky problem vijon te jete i qendrueshem. AKEP nepermjet masave te mos-diskriminimit ne tarifat on-net/off-net adresoi problematiken e diferencave te medha te ketyre tarifave nepermjet masave rregulluese per terminimin e thirrjeve (mos-diskriminim). Nderhyrja ne nivelin e tarifave te cituara (pa aktivizuar ofertat/paketat) perben rregullim te tarifave ne nivel me pakice qe mund te kryhet sipas nenit 55 te ligjit 9918, vetem per sherbimet qe jane pjese e SHU dhe/ose te operatorit me FNT ne tregun perkates me pakice.

AKEP eshte duke vleresuar menyrat e mundshme te adresimit te ketij problemi jashte statusit se FNT, pasi tregu me pakice celular nuk eshte treg i justifikueshem per nderhyrje ex-ante. Njekohesisht edhe nese ky treg do te konsiderohej te ishte i justfikueshem per nderhyrje ex-ante, FNT ne tregun me pakice celulare me kater operatore dhe perfitimet e medha per perdoruesin fundor, do te ishte shume e veshtire per t'u provuar (perfshire domincane e bashkuar). Prolematika ekziston te te kater operatoret celulare dhe rezulton se kjo menyre tarifimi nuk vjen si rezultat i sjelljes koluzive me interes te perbashket te kater operatoreve, por secili vepron ne kete menyre ne interesin e vet per shkak te preferencave konsumatore drejt paketave, qe jane tendence edhe ne vende te tjera.

Dokumenti i BEREC "*Report on Oligopoly analysis and regulation*" (BoR (15) 195) analizon mungesen e instrumentave per nderhyrje ex-ante ne tregjet 'oligopol i ngushte' (tight oligopoly)[34] duke propozuar KE per perditesim te Udhezimit per analizen e tregut dhe FNT duke pergatitur kritere per te vleresuar si dominancen (FNT) e bashkuar dhe nderhyrje te mundshme ex-ante per rastet e oligopoleve te ngushta. BEREC vlereson se keto instrumenta te rinj jane te nevojshme ne kushtet kur tregjet e komunikimeve elektronike po tentojne ne tregje oligopol me disa operatore dominues si dhe ne kushtet e zvogelimit te numrit te operatoreve per shkak te tendences se bashkimeve dhe blerjeve me perthithje (mergers and acquisitions) gjate viteve te fundit.

Nje alternative per adresimin e ketij problemi mund te jete rregullimi i tarifave per njesi komunikimi (thirrje/SMS kombetare, Internet) qe jane jashte paketave/ofertave, duke percaktuar cmime tavan (maksimale) si pjese e Sherbimit Universal. AKEP ne dokumentin e "Statusi i Sherbimit Universal te komunikimeve elektronike" te nxjerre ne keshillim publik ne Tetor 2016, ka propozuar paketa sherbimesh celulare (thirrje, SMS dhe Internet) si pjese e SHU, dhe ne kete kuader mund te percaktoje nivele maksimale te tarifave per sherbimet e cituara, si edhe per paketat/shportat qe jane propozuar si pjese SHU.

[34] Tight oligopolies are oligopolistic market structures that cause inefficient market outcomes without explicit collaboration or tacit collusion. Faqe 61 BoR (15) 195

ANEKS 1. Pyetjet e Keshillimit Publik

Me poshte eshte nje permbledhje e pyetjeve per te cilat AKEP eshte i interesuar te marre komente nga palet e intersuara. Ne pergjigjet e dhena per pyetjet, palet jane te lutura te perfshijne edhe argumentim per pergjigjet/komentet. Palet mund te japin komente edhe per pjese te tjera te dokumentit te analizes dhe perfundimeve te AKEP, apo dhe sugjerime shtese per nje rregullim sa me te mire te tregut te analizuar.

1. **A ka pasqyruar drejt AKEP zhvillimet ne tregun me pakice te sherbimeve celulare?**

2. **Cfare mendoni per konkluzionin e AKEP per rritjen e perfitimeve te perdoruesve celulare ne tregun me pakice te sherbimeve celulare si thirrje telefonike, SMS, Internet?**

3. **Cili eshte opinioni juaj ne lidhje me efektet e masave rregulluese te mos-diskriminimit ne tarifat e thirrjeve on-net/off-net?**

4. **Cfare mendoni ne lidhje me ecurine e pjeseve te tregut dhe treguesve financiare te operatoreve celulare?**

5. **A jeni dakort me perfundimet e AKEP per perkufizimin e tregut perkates te terminimit te thirrjeve ne rrjet individual celular?**

6. **A mendoni se te kater operatoret celulare aktiv ne treg, permbushin kriteret per FNT ne terminimin e thirrjeve ne rrjetet e tyre individuale?**

7. **Cfare mendoni per masat rregullatore per terminimin ne rrjetet celulare?**

8. **A jeni dakort me propozimin e AKEP se masa rregulluese e mos-diskriminimit ne tarifat on-net/off-net e vendosur ne analizen e tregut 2014 duhet te vijoje te aplikohet edhe per statusin me FNT te propozuar me kete analize?**

9. **Cila do te ishte alternativa me e mire per adresimin e problematikes se tarifave teper te larta te komunikimit (thirrje/SMS/Internet) pa aktivizuar paketat/ofertat e sherbimeve celulare?**